

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN

ue.eu.int/de/summ.htm

Roli Juaj si ministër i një vendi anëtar

Procesi i vendimmarrjes në Bashkimin Evropian është i ndarë në mënyrë ekzakte mes institucioneve të komunitetit (Parlamenti Evropian dhe Komisioni Evropian) dhe qeverive të shteteve anëtare.

Këshilli i Bashkimit Evropian përbëhet nga ministrat e shteteve anëtare dhe vepron si organ legjislativ (pushtet ligjvënës) dhe si organ ekzekutiv (pushtet zbatues).

Në varësi të procedurave të aplikuara për vendimmarrje Parlamenti Evropian ka pak a shumë të drejtë bashkëvendosjeje në ligjvënien evropiane. Në rastin e zgjerimit të Bashkimit Evropian është i nevojshëm miratimi i Parlamentit Evropian.

Për këtë arsye Këshilli i Bashkimit Evropian nuk mund ta anashkalojë Parlamentin Evropian në një rast vendimmarrjeje, por duhet që gjithmonë të mbajë në konsideratë pozicionin e Parlamentit Evropian.

Këshilli i Bashkimit Evropian është, krahas Parlamentit Evropian, ligjvënësi kryesor në BE. Ai përbëhet nga ministra të vendeve anëtare, ku çdo vend dërgon një anëtar në Këshill. Këshilli mbledhet një herë ose dy herë në javë. Këshilli ka përbërje të ndryshme në varësi të fushës politike (p.sh. Këshilli i Ministrave të Mjedisit, Këshilli i Ministrave të Bujqësisë, Këshilli i Ministrave të Jashtëm). Në lidhje me çështje të zgjerimit të BE-së mbledhet dhe diskuton Këshilli i Ministrave të Jashtëm.

Këshilli ka gjashtë detyra qendrore:

1. Ai miraton ligje dhe akte ligjore evropiane – në shumë fusha bashkarisht me Parlamentin Evropian.
2. Ai kujdeset për harmonizimin e linjave kryesore të politikave ekonomike të vendeve anëtare.
3. Ai lidh marrëveshje ndërkombëtare mes BE-së dhe shteteve apo organizatave të tjera ndërkombëtare.
4. Së bashku me Parlamentin Evropian miraton projekt-buxhetin e BE-së.
5. Duke u bazuar mbi direktivat e përgjithshme të përcaktuara nga Këshilli i Evropës ai zhvillon Politikën e Përbashkët të BE-së në Punët e Jashtme dhe Çështje të Sigurisë (për hollësi të mëtejshme shihni paragrafin mbi Politikën e Përbashkët të BE-së në Punët e Jashtme dhe Çështje të Sigurisë).
6. Ai koordinon bashkëpunimin mes gjykatave kombëtare dhe forcave të policisë në çështje penale (sih paragrafin mbi lirinë, sigurinë dhe ligjin).

Veprimtaria e Këshillit do të trajtohet hollësisht në vijim.

1. Aktet ligjore

Një pjesë e mirë e akteve ligjore evropiane miratohet bashkarisht nga Këshilli dhe Parlamenti (shih paragrafin mbi vendimmarrjen e BE-së).

Zakonisht Këshilli vihet në lëvizje më propozim të Komisionit. Pas pranimit të akteve ligjore evropiane normlisht është Komisioni përgjegjës, që ato të aplikohen në mënyrë korrekte.

2. Koordinimi i politikës së shteteve anëtare

Shtetet e Bashkimit Evropian janë deklaruar për një politikë ekonomie të përbashkët, që mbështetet në një koordinim të mirë të politikës ekonomike kombëtare. Ky koordinim realizohet nga ministra e ekonomisë dhe financës, të cilët së bashku formojnë Këshillin për Ekonominë dhe Financën (ECOFIN).

Objektiva të tjera janë krijimi i vendeve të punës dhe përmirësimi i sistemeve të arsimit, shëndetësisë dhe atyre sociale. Megjithëse çdo shtet anëtar i Bashkimit Evropian është përgjegjës për politikën e vet në këta sektorë, ata mund të merren vesh për qëllime që i kanë të përbashkëta si dhe të mësojnë nga përvoja e të tjerëve. Ky proces quhet „Metoda e koordinimit të hapur“ dhe zhvillohet brenda Këshillit.

3. Lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare

Këshilli nënshkruan çdo vit disa marrëveshje mes bashkimit Evropian dhe vendeve të treta dhe organizatave ndërkombëtare. Këto marrëveshje mund t'u referohen sektorëve të mëdhenj si tregtia, bashkëpunimi dhe zhvillimi apo të trajtojnë tema specifike si tekstilet, peshkimin, shkencën dhe teknologjinë, transportin etj.

Krahas kësaj Këshilli mund të lidhë marrëveshje mes shteteve anëtare të BE-së në sektorë të tillë si tatimet, kuadri ligjor mbi shoqatat apo mbrojtjen konsullore. Përveç kësaj objekt i marrëveshjeve mund të jenë bashkëpunimi në fushën e lirisë, sigurisë dhe ligjit.

4. Miratimi i buxhetit të BE-së

Buxheti i Bashkimit Evropian miratohet çdo vit bashkarisht nga Këshilli dhe nga Parlamenti Evropian.

5. Politika e Përbashkët në Punët e Jashtme dhe Çështjet e Sigurisë

Shtetet anëtare të BE-së punojnë për zhvillimin e Politikës së Përbashkët në Punët e Jashtme dhe Çështjet e Sigurisë. Gjithsesi kontrollin mbi politikën e jashtme, sigurinë dhe mbrojtjen e kanë qeveritë e vendeve të veçanta. Ato nuk i kanë dorëzuar të drejtat e tyre kombëtare në këto fusha, ndaj Parlamenti dhe Komisioni Evropian mund të luajnë në këtë kontekst vetëm një rol të kufizuar. Por shtetet e BE-së mund të përfitojnë shumë nga bashkëpunimi në këto çështje, dhe Këshilli përbën këtu forumin më të rëndësishëm, ku zhvillohet ky „bashkëpunim ndërshtetëror“.

Në mënyrë që BE të mund të reagojë më me efikasitet ndaj krizave ndërkombëtare, Bashkimi Evropian ka krijuar „Trupat e ndërhyrjes së shpejtë“. Këtu është fjala për një ushtri ndërkombëtare, ushtarakët e të cilës mbeten pjesë e ushtrive kombëtare dhe janë nën komandon kombëtare. Funkzioni i tyre kufizohet në detyra humanitare dhe misione shpëtimi, masa paqeruajtëse dhe detyra të tjera për zgjidhjen e krizave. Kështu p.sh. në vitin 2003 BE realizoi një operacion ushtarak me emrin Artemis në Republikën Demokratike të Kongos si dhe në vitin 2004 filloi një mision paqeruajtës nën emrin Althea Bosnje-Hercegovinë.

Në misione të tilla Këshilli mbështetet nga:

- Komiteti për Politikën dhe Sigurinë (KPS),
- Komisioni Ushtarak i Bashkimit Evropian (EUMC) dhe
- Shtabi Ushtarak i Bashkimit Evropian (EUMS), i cili përbëhet nga ekspertë ushtarakë, të deleguar nga shtetet anëtare në Sekretariatit e Këshillit.

6. Liria, Siguria dhe Ligji

Qytetarët e BE-së mund të jetojnë dhe punojnë në çdo vend të BE-së. Për këtë arsye ata duhet të kenë në të gjithë Bashkimin Evropian akses të njëjtë në gjykatat civile. Gjykatat kombëtare duhet të bashkëpunojnë, që të garantojnë për shembull që një vendim divorci apo e drejta e kujdesjes për një fëmijë dhënë në një vend të BE-së të njihet nga të gjitha vendet e tjera anëtare.

Lëvizja e lirë brenda BE-së është një avantazh i madh për qytetarët, që respektojnë ligjin, por shfrytëzohet edhe nga kriminelë dhe terroristë që veprojnë në nivel ndërkombëtar. Lufta kundër kriminalitetit ndërkufitar e bën të domosdoshëm bashkëpunimin ndërkufitar mes gjykatave kombëtare, forcave policore, punonjësve të doganave dhe zyrave të migracionit në të gjitha shtetet e BE-së.

Kështu për shembull ato duhet të garantojnë që

- kufinj të jashtëm të BE-së të jenë të siguruar në mënyrë të plotë;
- Nëpunësit e doganës dhe policët të shkëmbejnë informacione në lidhje me lëvizjet e kontrabandistëve të mundshëm të drogës apo trafikantëve të ndryshëm;
- Azil-kërkuesit në të gjithë BE-në të gjykohen dhe trajtohen njësoj, në mënyrë që të ndalohet fenomeni „Asylshopping“.

Këto i çështje trajtohen nga Këshilli për „Drejtësinë dhe Punët e Brendshme“, pra nga ministrat e drejtësisë dhe ata të punëve të brendshme. Qëllimi është krijimi i një „Zone të lirisë, sigurisë dhe ligjit“ brenda kufijve të BE-së.

7. Detyrat e Këshillit

Në përputhje me Marrëveshjen mbi Bashkimin Evropian (*shih fragmentin shpikëputur nga preambula*) Këshilli si institucion i Bashkimit Evropian është i detyruar të mbajë në konsideratë të vazhdueshme interesat e BE-së si një të tërë. E megjithatë nuk është e rrallë, që ministrat e shteteve anëtare të vlerësojnë temat që diskutohen apo të marrin vendime nisur nga perspektivat e tyre kombëtare. Shtetet kanë interesa të shumta kombëtare, ku integrimi evropian dhe zgjerimi i BE-së janë vetëm dy nga objektivat e shumta. Në kuadër të çështjeve të zgjerimit të BE Këshilli duhet të marrë vendime unanime, Ju duhet të debatonit me kolegët aq gjatë deri sa të arrihet unanimiteti. Letonia pra duhet të jape miratimin e vet njësoj si Gjermania. Edhe pse sigurisht që ka dallime në ndikimin faktik të secilit prej vendeve duke u nisur nga numri i banorëve dhe potenciali ekonomik, në fund të fundit në rastin e votimeve për zgjerimet e mundshme çdo votë ka të njëjtën peshë.

Është pra e rëndësishme që gjatë simulimit të kërkontë dhe të gjeni konsensusin!

Ndonjëherë mund të ndodhë që ministrat të përpiqen të pengojnë marrjen e një vendimi, që do të sillte një dizavantazh për vendin e tyre. Të marrësh një vendim të nevojshëm në mënyrë të përbashkët duke ruajtur njëkohësisht interesat Tuaja nuk është gjithmonë e lehtë. Pasojë e këtyre rrethanave shpeshherë është lidhja e kompromiseve „të holluara“.

Për Ju si ministër kjo do të thotë që, ndërsa jeni duke kërkuar për një pozicion të përbashkët brenda unionit, duhet gjithmonë të mbani në konsideratë interesat e vendit Tuaj. Ju duhet të gjeni një strategji që të mund të realizoni qëndrimin Tuaj pa qenë nevoja të shkelni rregulloren e brendshme të Këshillit ose rregullat e diplomacisë. Për këtë arsye rekomandohet shumë që

Fragment nga Preambula e Marrëveshjes mbi BE-në:

(...) Të VENDOSUR, të ngrenë në një nivel të ri procesin e integritit evropian iniciuar me themelimin e Komunitetit Evropian, DUKE U NISUR nga rëndësia historike e kapërcimit të ndarjes së kontinentit evropian dhe domosdoshmëria e krijimit të bazave të forta për trajtën e Evropës në të ardhmen, DUKE KONFIRMUAR vlefshmërinë e parimeve të lirisë, demokracisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut e të lirive themelore, dhe parimit të shtetit ligjor, (...)

ME DËSHIRËN për të përforcuar më tej demokracinë dhe efikasitetin në veprimtarinë e organeve, me qëllim që këto të jenë në gjendje të realizojnë edhe më mirë detyrat e ngarkuara brenda një kuadri të njësuar institucional (...)

TË VENDOSUR për të vijuar më tej procesin e krijimit të një Unioni gjithnjë e më të ngushtë të popujve të Evropës, ku vendimet të merren sipas parimit të subsidiaritetit duke qenë mundësisht sa më afër qytetarit, DUKE PATUR PARASYSH që duhen bërë hapa të tjerë për të çuar përpara integrimin evropian, VENDOSËN të themelojnë Bashkimin Evropian; (...)

të lidhni kontakte me kolegë të tjerë ministra apo deputetë të Parlamentit Evropian, për të qartësuar pozicionin e tyre dhe të rrisni mundësitë për të bërë për vete aleatë për të realizuar qëllimet Tuaja.

Për të arritur këtë Ju keni disa mjete në dispozicion (që lihen në gjykimin Tuaj):

- Shfrytëzoni në mënyrë të veçantë bisedat informale me kolegë të tjerë pasi Ju personalisht keni një aftësi të mirë bindëse.
- Përpiquni të bëni përshtypje te përfaqësuesit e shtypit me argumentat Tuaja.
- Për të patur mbështetjen e popullit Tuaj nisni një fushatë të madhe shtypi.
- Kërcënoni se do të bllokoni propozimet e vendeve të tjera.
- Kërkoni të ashtuquajturat „paketa zgjidhjesh” (bëni lëshime të caktuara që të mund të realizoni interesat Tuaja në një aspekt tjetër), pasi brenda BE-së konsensusi është shumë i rëndësishëm!

Mbani para sysh: vetëm me anë vendimesh të përbashkëta mund të çoni përpara Evropën, edhe në interesin Tuaj!

Për kujtesë: Cili është roli i Këshillit në lidhje me zgjerimin?

Neni 49 (Ex-Artikel O) Marrëveshja mbi BE – pranimi i shteteve të tjera anëtare

„Çdo shtet evropian [...] mund të bëjë kërkesën për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Kërkesa i dorëzohet Këshillit i cili duhet të vendosë njëzëri pasi ka dëgjuar Komisionin dhe ka marrë miratimin e Parlamentit Evropian, i cili merr vendimin e vet me shumicë absolute (shënim i autorit: të paktën 50 % +1 të të gjithë deputetëve).”

Detyrat Tuaja si ministër/ministre gjatë simulimit:

1. Ju përpunoni rolin Tuaj me ndihmën e profilit të roleve; në konferencën e pranimit ekziston mundësia e realizimit të disa kontakteve të para informale.
2. Zgjidhni nga rradhët Tuaja me shumicë të thjeshtë votash (50 % + 1 e të pranishmëve) kryetarin/en, që do të drejtojë seancat e Këshillit; krahas kësaj caktoni dikë përgjegjës për mbajtjen e protokollit. Sqaroni dhe miratoni rregulloren e brendshme (kohët mbajtjes së fjalës, rrjedhën, protokollin (Kap. V-M 4.). Jepni një deklaratë personale (cdo tre minuta).
3. Pranoni kërkesat për anëtarësim dhe kërkoni një pozicionim të Komisionit (krahaso Kap. V-M 6)
4. Jepni një konferencë për shtyp.
5. Kandidatët për anëtarësim paraqiten para Këshillit.
6. Komisioni i paraqet Këshillit pozicionin e vet. Ju përcaktoni pikëpamjet e përbashkëta mbi bazën e propozimeve të Komisionit.
7. Ju ngarkoni Komisionin me realizimin e bisedimeve për anëtarësim; Kryetari i Këshillit merr pjesë në seancat e bisedimeve (krahaso. Kap. V-M 12.) Ju përpunoni kushtet e anëtarësimit.
8. Këshilli duhet të votojë dhe të arrijë në një përfundim në lidhje me marrëveshjet e anëtarësimit (vgl. Kap. V-M 13.). Vendet candidate asistojnë votimin si të ftuara.
9. Në konferencën përmbyllëse të pranimit anëtarët e Këshillit mbajnë fjalime
10. Nënshkruani Marrëveshjet e Anëtarësimit gjatë konferencës ceremoniale të pranimit (krahaso. Kap. V-M 13.) dhe qëndroni të gatshëm për intervista apo një Talkshow të mundshëm.

Austria

Kryeqyteti:	Vjena (1.606.843 mil. banorë) (shifra të 2004)
Forma shtetërore:	Republikë Federale, Demokraci parlamentare
Sipërfaqja:	83.871 km ²
Nr. i banorëve:	8,28 Mio.
PBB / banor:	39.750 US-Dollar
Rritja ekonomike :	3,1 %
Papunësia:	5,7 %
Gjuhët:	gjermanisht, sllovenisht, kroatisht, hungarisht
Besimet fetare:	katolikë rreth 74 %, protestantë rreth 5 %, muslimanë rreth 4 %, ateistë rreth 17 % etj.
Grupe etnike:	88,5 % austriakë, 10 % emigrantë (turq, boshnjakë etj), 1,5 % pakica indigjene (sllovenë, kroatë, hungarezë)
Anëtar i Kom.Evr. / BE:	1995
Presidenti Federal:	Dr. Heinz Fischer (SPÖ)
Kancelari Federal:	Dr. Alfred Gusenbauer (SPÖ)
Informacione të tjera:	www.austria.gv.at

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni përfaqësues i Austrisë. Pak pas raundit të fundit të zgjerimit me dymbëdhjetë shtete të reja anëtare të Evropës Qendrore dhe Lindore, po përballeni me kërkesa të tjera anëtarësimi dhe duhet të vendosni në lidhje me to.

Austria në BE

Austria është bërë anëtare e Bashkimit Evropian vetëm më 1 janar 1995. Ndërkohë ky vend është zhvilluar në një anëtar aktiv brenda BE-së dhe ka marrë shpeshherë profilin e zëdhënësit të shteteve të vogla të BE-së.

Thellimi i Bashkimit Evropian është objektiv i politikës evropiane austriake. Për Austrinë janë të rëndësishme marrëdhëniet e mira me Gjermaninë, por vendi identifikohet më shumë me shtetet e tjera qendrore të BE-së (Belgjikën dhe Suedinë), të cilat kanë frikë se ms humbasin ndikimin e tyre brenda një Unioni të zgjeruar. Austria bën një politikë shumë të vetëdijshme e të mirëorientuar në lidhje me BE-në, gjë që lidhet me ndikimin e madh të partive nacional-konservative, që kërkojnë të mbrojnë vendin nga „mbihuajezimi“.

Për shkak të politikës së vet neutrale dhe detyrave në rritje të BE në arenën botërore politika austriake në Punët e Jashtme dhe Çështjet e Sigurisë e gjeti veten në tensionin mes neutralitetit dhe përgjegjësisë ushtarake ndërkombëtare. Në sektorin Politikës së Përbashkët në Punët e Jashtme dhe Çështjet e Sigurisë Austria preferon bashkëpunimin mes qeverive dhe është kundër kalimit të një sovraniteti të tepruar në duart e „Brukselit“. Austria ka frikë në këtë kontekst për dominimin e shteteve të mëdha të BE-së, Gjermanisë dhe Francës.

Simbol për politikën e vetëdijshme të Austrisë në parketin evropian është ruajtja e parimit të delegimit të një komisioneri për çdo vend të BE-së në Komision deri në vitin 2014. Për të arritur këtë austria u angazhua veçanërisht fuqishëm.

Austria dhe zgjerimi i ardhshëm

Austria ishte një ndër përfituesit më të mëdhenj të shndërrimit politik të shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore në dekadën e fundit. Firmat austriake janë investitorët më të mëdhenj në shumë vende të Evropës Lindore dhe Juglindore dhe një pjesë e mirë e eksportëve austriake hidhet në tregun e këtyre shteteve. Për pothuaj një shekull që nga rënia e monarkisë austriake Austria ka përfituar nga kontaktet e qëndrueshme dhe të rritura në rajon. Për këtë arsye Austria e ka mbështetur raundin e parë të zgjerimit të vitit 2004, që ka rezultuar pozitiv për Austrinë veçanërisht në nivel ekonomik. Tregtia e Austrisë me vendet e evropianoqendrore dhe -lindore rritet në mënyrë të vazhdueshme. Në radhët e popullsisë atëherë ka patur rezerva, njësoj si në Gjermani, në lidhje me rritjen e mundshme të migracionit për qëllime punësimi. Por kjo frikë u menaxhua me vendosjen e afateve të gjata kalimtare në sektorin e lëvizjes së lirë të personave.

Referuar anëtarëve të ardhshëm të BE- së Austria mban një qëndrim shumë të rezervuar. Kryetari i qeverisë Austriake është shprehur shpeshherë kundër anëtarësimit të plotë të Turqisë. Në argumentimin kundër anëtarësimit të Turqisë janë nxjerrë në pah ndryshimet kulturore dhe një pamundësi eventuale e BE-së për të vepruar. Austria i frikësohet edhe një deficiti të mundshëm në fushën e sigurisë, pasi me anëtarësimin e Turqisë BE do të kufizohet direkt me Lindjen e Afërt dhe me rajonin e paqëndrueshëm të Kaukazit. Më tej paraqitet edhe argumenti i mbrojtjes së pamjaftueshme të të drejtave të njeriut në Turqi. Frika e austriakëve ndaj turqve mund të jetë e kushtëzuar edhe historikisht, pasi Austria ka qenë shekuj me rradhë në luftë me Perandorinë Osmane për të marrë ndikimin mbi Ballkan. E megjithatë Austria e mbështet hapjen e bisedimeve të anëtarësimit me Turqinë duke vënë kushtet e mëposhtme: Kështu për anëtarësimin e vendeve të tjera anëtare duhet vënë kushti paraprak i garantimit të kapaciteteve pranuese nga ana e BE-së si dhe trajtimi i barabartë financiar i të gjitha shteteve anëtare.

Ndërsa lidhur me kërkesën e Kroacisë për anëtarësim Austria mban një qëndrim shumë më pozitiv. Kroacia ka qenë deri në vitin 1918 pjesë e Monarkisë Austro-Hungareze. Ndaj Austria është e lidhur shumë fort me Kroacinë në pikëpamje historike; por jo vetëm kaq, Austria është shumë aktive në Kroaci edhe në nivel ekonomik. Austria ka qenë direkt e prekur nga pasojat e luftës civile në Ish-Jugosllavi dhe për këtë arsye mbështet integrimin sa më të shpejtë të mundur të Kroacisë në BE.

Austria bën pjesë në mbështetësit e fuqishëm të strategjive ambicioze për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe atyre të evropës Juglindore si Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Maqedonisë, Shqipërisë, Rumanisë dhe Bullgarisë. Austria punon në mënyrë aktive për gjetjen e një zgjidhjeje konsensuale të konfliktit të Kosovës dhe mbështet pavarësinë e Kosovës nën mbikqyrjen e faktorit ndërkombëtar.

Republika e Austrisë e ka njohur ndërkohë zyrtarisht pavarësinë e Kosovës.

Në kuadër të debatit mbi emrin mes Maqedonisë dhe Greqisë austria pozicionohet në mënyrë asnjnjëse. Austria ka garantuar se do të pranojë një zgjidhje që do të gjendet bashkarisht nga të dyja palët. Gjithashtu Austria tregon mirëkuptim të konsiderueshëm për Maqedoninë që kërkon të mbajë emërtimin e vet kushtetues, aq më tepër që ky është njohur tashmë nga pothuaj 110 shtete të Kombeve të Bashkura.

Në përdorimin brendashtetëror termi austriak „Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë” po i lë gjithnjë e më shumë vendin emërimit kushtetues maqedonas „Republika e Maqedonisë”. Që prej vitit 2007 Gjermani përdor në korespondencën e saj dypalëshe me Maqedoninë emërtimin kushtetues të kësaj të fundit.

Që zgjerimi i BE të dështojë në këtë çështje kjo Ju duket e paimagjinueshme. Ju nuk dëshironi të jeni zyrtarisht të pasjellshëm me kolegët Tuaj grekë, por pas perdes përpigëni fuqimisht për arritjen e një marrëveshjeje. Në këtë çështje Ju mbështesni indirekt kolegët Tuaj britanikë të cilët shprehen në mënyrë shumë më ofensive se sa Ju.

Duke patur parasysh kërkesat e tjera për anëtarësim Austria mbështet fuqishëm debatin brenda BE-së rreth kufijve përfundimtarë të komunitetit. Qeveria kërkon që këta kufij të përcaktohen qartë në mënyrë që procesit të zgjerimit, që duket se do të vazhdojë pafundësisht, t'i vihet një cak. Në të kundërt, një Bashkim Evropian gjithnjë në rritje do të humbiste identitetin e vet, aftësinë e vet për të vepruar dhe, para së gjithash, mbështetjen e qytetarëve dhe qytetareve të vet/a derisa më në fund, i tejzgjerruar, do të shkatërrohej.

Taktika

Ju jeni përfaqësues/e i/e një vendi të vogël të BE-së. Përpiguni t'ua shisni „çështjet” Tuaja të rëndësishme shteteve të mëdha të BE-së, meqenëse ato në vendimin e tyre duhet të marrin parasysh edhe interes Tuaja.

Prezantohuni si avokat i shteteve të vogla të BE-së, që kërkojnë një Union të aftë për të vepruar. Në këtë kontekst shprehuni për momentin kundër një anëtarësimi të plotë të Turqisë. Turqia jo vetëm do ta tejngarkonte BE-në, por në të njëjtën kohë ajo nuk është ende e gatshme të përmbushë në mënyrë të besueshme të gjitha kriteret evropiane. Një anëtarësim i plotë i Turqisë do të ishte i mundur sipas Jush – nëse do të ketë ndonjëherë anëtarësim të Turqisë – vetëm në terma shumë afatgjatë. Dhe pikërisht me kushtin që deri në atë moment të jetë realizuar procesi i thellimit të BE-së, në mënyrë që anëtarësimi i Turqisë të mos shkaktojë ndonjë paralizim të institucioneve evropiane. Zbatimi i Kushtetutës së BE-së do të ishte një hap shumë i rëndësishëm në këtë drejtim. Një alternativë më e mirë krahasuar me anëtarësimin e Turqisë do të ishte lidhja e një marrëveshjeje, që do t'i garantonte Turqisë statusin e një partneri të privilegjuar.

Krejt tjetër është pozicioni Juaj në lidhje me shtetet e tjera kandidate për anëtarësim. Një mbështetje e veçantë u duhet dhënë shteteve të Ballkanit në rrugën e tyre drejt BE-së. Ky rajon është pjesë e BE-së si për arsye kulturore ashtu edhe momente historike. Krahas kësaj anëtarësimi do t'u jepte fund raporteve jo të qëndrueshme të dekadave të fundit dhe do ta shndërronte rajonin në një kopësht të paqes dhe sigurisë.

Por kjo nuk do të thotë që Ju e mbështesni anëtarësimin e tyre pa kushte. Duke patur në konsideratë tregun Tuaj kombëtar të punës Ju kërkon vendosjen e afateve të gjata tranzitive për lëvizjen e lirë të personave duke dashur të pengoni kështu një konkurrencë të tejmadhe në tregun vendas të punës. Veç kësaj BE-ja nuk mund të realizojë më në të ardhmen të njëjtat subvencione bujare për të gjitha vendet anëtare, numri i të cilave është në rritje, kështu që asistencë për ndërtimin e strukturave përkatëse, pra mbështetja për bujqësinë dhe rajonet e prapambetura, për anëtarët e rinj do të duhet të jetë shumë më e pakët.

Angazhohuni në mënyrë masive, që pavarësisht vendimit në lidhje me kërkesa të veçanta anëtarësimi, mund të hapet një debat i përgjithshëm në lidhje me kapacitetet pranuese të BE-së dhe kufijtë e tij. Argumenti Juaj më i fuqishëm këtu është atmosfera në popullsinë evropiane, e cila i shikon me skepticizëm ekstrem raundet e ardhshme të zgjerimit dhe dëshiron më shumë orientim dhe objektiva më të qartë si nga pikëpamja gjeografike ashtu edhe nga ajo e përmbajtjes.

Belgjika (Belge/Belgique)

Kryeqyteti:	Brukseli (997.126 banorë) (shifra të 2004)
Forma shtetërore:	Monarki parlamentare, shtet federal me Sistem Dy-Dhomësh
Sipërfqja:	32.545 km ²
Banorë:	10,5 milionë
PBB/banor:	26.140 US-Dollar
Rritja ekonomike :	1,2 %
Papunësia:	8,2 %
Gjuhët:	gjuha flamande, frëngjisht, hollandisht, gjermanisht
Besimet fetare:	Katolikë 80%, protestantë 8%, muslimanë 2%
Grupet etnike:	57,0 % Flamandë, 33,0 % Valonë, 9,3 % Brukselas, 0,7 % gjermanofolës
Anëtar i Kom.Evr./BE:	Anëtar themelues
Kryetari i shtetit:	Mbreti Albert II.
Kyetari i qeverisë:	Yves Leterme
Informacione të tjera:	www.diplomatie.be

www.weltalmanach.de (2008)

Ju jeni përfaqësues/e i/e Belgjikës në Këshillin e Bashkimit Evropian. Menjëherë pas pranimit të dymbëdhjetë shteteve të reja anëtare Ju përballeni sërish me vendimmarrjen për kërkesa të tjera anëtarësimi.

Belgjika në BE

Belgjika është një ndër gjashtë anëtarët themelues të Komunitetit Evropian për Ekonominë dhe i ka kushtuar që në fillim prioritetin më të lartë Evropës së Bashkuar. Duke qenë një vend me madhësi mesatare Belgjika i sheh interesat e saj bazë dhe ndikimin e vet në nivel ndërkombëtar të realizuar më së miri në një Union të fuqishëm, të organizuar në nivel mbikombëtar. Ky këndvështrim i gjërave ka gjetur shprehje në mënyrë të vazhdueshme gjatë historisë së bashkimit në një politikë tejet konstruktive dhe në një qëndrim miqësor të vendit ndaj integritit në vazhden e hapave të ndryshëm të ndërmarrë në kuadër të reformave evropiane (Maastricht, Amsterdam, Nisa). Në të gjitha këto përpjekje për reforma dhe në mënyrë të veçantë së fundmi në lidhje me Konventën mbi Kushtetutën dhe, pas saj, në Konferencën Qeveritare, qeveritë belge të viteve të fundit janë shprehur fuqishëm pro konsolidimit të mekanizmave integruese në BE. Belgjika shikon këtu edhe një mundësi mbrojtjeje kundër ndikimit të fortë të shteteve të mëdha anëtare të BE-së, si dhe e konsideron këtë një kusht që Evropa me më shumë se 27 anëtarë të mund të mbetet në mënyrë të vazhdueshme e aftë për të vepruar.

Ndërsa qeveritë belge vazhdojnë të mbajnë këtë kurs dhe qëndrim miqësor ndaj Evropës, popullsia belge vitet e fundit ka përjetuar një debat të brendshëm intensiv rreth strukturimit të ardhshëm të Bashkimit Evropian. Nga zgjedhjet për në Parlamentin Belg dhe atë Evropian dalin të përforcuar me më shumë se dhjetë përqind të votave militantët e grupimit radikal (Vlaams Block), që mbështesin fuqizimin e rajoneve edhe brenda për brenda Belgjikës dhe që vënë në diskutim sukseset e deitanishme të procesit të bashkimit

evropian. Veç këtj grupimi radikal në Flandri dhe një pendanti të saj të parëndësishëm nga pikëpamja politike në Valoni (Front National) partitë e tjera belge janë simpatizante të procesit të bashkimit të Evropës. Edhe qeveria belge është angazhuar për vijimin e integritimit evropian dhe të zgjerimit, që lidhet me të.

Megjithë këto për pozicionin belge është me rëndësi vendimtare fuqizimi i kompetencave të Bashkimit Evropian. Kështu duhet që më në fund të vihen në lëvizje një politikë e përbashkët për punët e jashtme, që bën të mundur mbrojtjen autonome evropiane, dhe duhet krijuar një politikë e përbashkët ligjore dhe emigrimi. Duhet intensifikuar përfshirja e Unionit në fusha të tilla si mjedisi, sektori social dhe tatimet, dhe modifikimi i politikave të ekonomisë në mbështetje të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar. Pikërisht në fushën e politikave sociale Belgjika tërheq vëmendjen në lidhje me një nevojë të konsiderueshme për të vepruar. Në kuadër të politikave të përbashkëta sociale duhet të arrihet një përshtatje e caktuar, që të mundësohet dhe garantohet një shtet social si në shtetet e vjetra ashtu edhe në ato të reja anëtare.

Belgjika dhe zgjerimi i ardhshëm

Belgjika e ka mbështetur në mënyrë aktive raundin e fundit të zgjerimit me dymbëdhjetë shtete të reja anëtare dhe edhe tani nënvizon avantazhet e të gjitha palëve në rast të një raundi të ri zgjerimi, që duhet të përfshijë edhe Turqinë. Vendi shikon në një proces zgjerimi që bën përpara, treguesit e suksesit të modelit evropian të një lidhjeje politike, që bazohet në një themel të përbashkët vlerash, e cila u garanton qytetarëve të vet lirinë, demokracinë dhe mirëqenien. Atraktiviteti i kësaj ideje dhe fakti që BE-ja e ka konsideruar veten gjithnjë si një komunitet të hapur, kontribuojnë sipas Belgjikës në ancorimin e paqes, stabilitetit dhe vlerave evropiane në të gjithë kontinentin. Në këtë kuptim qeveria belge mbështet perspektivën e anëtarësimit për vendet e Ballkanit, përmes së cilës do të garantohet stabiliteti në të gjithë rajonin, e po ashtu edhe për Turqinë, hapat e mëdha të së cilës në realizimin e reformave drejt Evropës nuk duhet të mbeten pa u shpërblyer. Krahas kësaj Belgjika dëshiron ta perceptojë Evropën si një komunitet ndërkulturor të bazuar në vlera dhe jo si një rreth të mbyllur të krishterë. Anëtarësimi i Turqisë është i domosdoshëm pikërisht për dialogun aq të kërkuar mes kulturave dhe stabilizimin e Kontinentit në pikëpamje të politikave të sigurisë. Gjithsesi përpjekjet për reforma në vend duhet të vazhdojnë në mënyrë konsekuente.

Veç kësaj vendet e Ballkanit, në gjykimin e Belgjikës, janë të predestinuara për tu anëtarësuar në institucionet evropiane dhe atlantike.

Procesi i stabilizimit dhe asociimit, i cili nisi në vitin 2001 me rastin e Samitit të parë mes BE-së dhe Ballkanit, ka krijuar tashmë instrumentat politike, juridike dhe financiare për të mbështetur vendet e Ballkanit në përpjekjet e tyre për integritimin evropian. Secili prej këtyre vendeve bën përpara në procesin e përafrimit me BE-në sipas një ritmi të zgjedhur nga ai vetë dhe në përputhje me meritat e tij.

Progreset e veçanta shënuar që prej vitit 2001 në vendet e Ballkanit në kuadër të reformave politike dhe ekonomike janë për tu evidentuar. E megjithatë këta hapa përpara janë ende të brishtë, nëse shohim situatën aktuale tejet konfliktuale në rajon. Për këtë arsye për Belgjikën është shumë e rëndësishme që mbi procesin e stabilizim-asociimit të vendosen kushte, që kanë karakter të pakthyeshëm.

Këto kushte kërkojnë nga rajoni respektimin e dokumentave fillestare në lidhje me stabilitetin (Marrëveshja kuadër e Dayton/Paris, Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurisë, Marrëveshja kuadër e Ohrid dhe Marrëveshja e Beogradit), shtrirjen e bashkëpunimit

rajonat, kthimin e personave të dëbuar gjatë luftës dhe një bashkëpunim të plotë me Gjykatën Penale Ndërkombëtare për krimet në ish-Jugosllavi.

Kontributi belg në procesin e stabilizim-asociimit është i rëndësishëm dhe i larmishëm. Belgjika financon si aktivitetet e organizatave ndërkombëtare, që janë të pranishme në rajon, ashtu edhe realizimin e projekteve të ndryshme në vend. Kontributi belg përmban edhe delegimin e personelit të kualifikuar (trupa ushtarake, policë, ekspertë nga fusha të ndryshme). Dhe në mbyllje këtu bën pjesë edhe hartimi i ekspertizave.

Por këtë qëndrim të vetin miqësor ndaj zgjerimit Belgjika e lidh me kërkesa të qarta drejtuar vendeve kandidatë për anëtarësim: vetëm pas përmbushjes së pastër e të paekuivokueshme të Kriteve të Kopenhagenit dhe, në ratin e Ballkanit, të detyrimeve të marra në kuadër të Marrëveshje së Stabilizim-Asociimit mund të realizohet anëtarësimi. Zgjerimi i BE-së as nuk duhet të vërë në diskutim arritjet e BE-së në fusha të ndryshme të politikës dhe as t'i dobësojë ato. Për këtë arsye të gjitha vendet kandidatë duhet të marrin dhe bëjnë të tyrin inventarin ligjor komunitar (*acquis communautaire*). Zgjerimi duhet të rrisë më tej mirëqenien dhe sigurinë në Evropë. Për këtë qëllim shtetet e reja anëtare duhet të përshtaten patjetër me stadin aktual të BE-së.

Por çështja më me rëndësi për Belgjikën është, që zgjerimi i synuar të mos pengojë thellimin e dëshiruar federal. Sikurse është bërë tashmë e qartë Belgjika kërkon një Union të aftë për të vepruar në nivel mbikombëtar. Për këtë arsye ky vend kërkon që përpara realizimit të zgjerimit të forcohen institucionet mbikombëtare si Komisioni dhe Parlamenti Evropian si dhe të arrihet një vendimmarrje më efiçente.

Taktika:

Si vend më madhësi mesatare Ju jeni i varur nga një Evropë funksionale. Pra nëse realizohet zgjerimi duhet të garantohet, që institucionet të vazhdojnë të funksionojnë, ndoshta edhe më mirë, në të ardhmen. Ju i kushtoni rëndësi fakti, që vendet e vogla të mos jenë të nënpërfaqësuar. Përpiquni të përdorni gatishmërinë Tuaj për integrimin si subjekt bisede, dhe kërkonini që të arrini me këtë fuqizimin e pozicionit Tuaj brenda BE-së dhe zgjerimin e mundësive të veprimit në nivel mbikombëtar. Duke qenë se Ju angazhoheni për barazpeshën e institucioneve evropiane dhe për konsolidimin e Parlamentit mos druani të vendosni kontakte, të shkëmbeni mendime me parlamentarët dhe t'u bëni të ditur atyre idetë Tuaja.

Nëse garantohet thellimi i kërkuar prej Jush, atëherë mbështesni fuqishëm kërkesat për anëtarësim të vendeve kandidatë. Ju mund të paraqisni si avantazhe të përgjithshme të një raundi të ri zgjerimi këto pika: rritjen e peshës ndërkombëtare të BE-së në politikën botërore, ngritjen e cilësisë së jetesës në mbarë Evropën, avantazhet ekonomike të një tregu të brendshëm më të madh për të gjithë pjesëmarrësit, zgjerimin e zonës së lirisë, sigurisë dhe të drejtës dhe, paralel me këtë, rritjen e sigurisë së brendshme. Ju e merrni seriozisht frikën e popullsisë për një konkurrencë pagash më të ulëta nga vendet e reja anëtare potenciale të BE-së, po kështu, lidhur me të, edhe rrezikun për mungesë vendesh pune në vend. Për këtë jepni si argument përvojën e zgjerimeve të mëparshme, ku kjo frikë ka rezultuar si e pabazë.

Shteteve të reja potencialisht anëtare ju u bëni kërkesa konkrete: Ato duhet të plotësojnë kriteret dhe t'i përshtaten stadi të tanishëm të BE-së. Meqenëse në rastin e zgjerimit nuk bëhet fjalë për shfuqizimin e politikës së deritanishme komunitare, duhet rënë dakord për masa specifike kalimtare. Bisedimet e radhës duhet të realizohen me secilin kandidat më vete. Marrëveshjet tranzitive (si p.sh. në reformën e politikës agrare

dhe politikës së strukturave) duhet të vendosen në afate kohore të caktuara dhe të shfuqizohen krejtësisht në momentin e duhur në varësi të sukseseve të shënuara në realizimin e reformave.

Bullgaria [Bălgarija]

Kryeqyteti:	Sofia (1,1 Mil banorë, 2003) (shifrat të 2004)
Forma shtetërore:	Republikë me qeverisje parlamentare
Sipërfaqja:	111.000 km ²
Nr. i banorëve:	7,693 Mil.
PBB / banor:	3.990 Euro
Ritja ekonomike:	6,1 %
Papunësia:	6,9 %
Gjuhët:	bullgarisht
Besimet fetare:	ortodoksë bullgarë rreth. 6,8 Mil., muslimanë rreth 790.000, katolikë rreth 50.000, protestantë rreth 20.000, hebrenj rreth 5.000
Grupe etnike:	85 % bullgarë enikë, 10 % turq etnikë, 3,4 % rom etnikë, 1,6 % rusë, armenianë etnikë etj.
Presidenti:	Georgi Parwanow
Kryetari i qeverisë:	Sergej Stanischew

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni përfaqësues i qeverisë. Pak kohë pas anëtarësimit Ju jeni përballur me bisedimet e anëtarësimit të shteteve të tjera që aspirojnë anëtarësimin.

Historia e procesit të reformave që prej vitit 1989

Ndërrimi i sistemeve realizuar paqësisht në nëntor 1989 në Evropën Qendrore dhe Lindore përfaqësonte edhe për Bullgarinë një kthesë vendimtare në historinë e tij. Në datën 10.11.1989 u rrëzua nga pushteti kryetari i Këshillit Shtetëror Bullgar dhe njëkohësisht i Partisë Komuniste, Todor Schivkov, dhe pas kësaj nisi një proces demokratizimi. Partia komuniste bullgare e pa veten të detyruar të toleronte themelimin e partive opozitare dhe të lejonte zgjedhjet e lira. Në vitin 1991 Parlamenti bullgar miratoi një kushtetutë të re, me të cilën u garantuan sistemi shumëpartiak, zgjedhje të lira dhe të përgjithshme si dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe qytetarit.

Sistemi politik dhe situata e të drejtave të njeriut

Që prej rënies së sistemit Bullgaria është demokraci parlamentare me një sistem parlamentar një dhomësh. Presidenti është kryetari i shtetit dhe zgjidhet drejt për së drejti nga populli. Krahas kësaj Bullgaria është zhvilluar në një shtet ligjor me ndarje pushtetesh. Megjithë reformat e realizuara sistemi i drejtësisë në Bullgari ka dobësi të konsiderueshme. Veç kësaj korrupsioni relativisht i lartë vazhdon të përbëjë një problem të madh, edhe pse lufta kundër tij ndërkohë është shndërruar në një prioritet politik.

Shoqëria bullgare nuk njih konfliktet të ashpra me bazë etike. Edhe dy komunitetet më të mëdha fetare – kisha ortodoke dhe islami kanë raporte tolerante me njëra tjetrën. Minoriteti i romëve gjithsesi nuk është integruar ende mjaftueshëm në shoqëri. Shumica e romëve jetojnë në raporte të vështira ekonomiko-sociale. Me program-veprimin e ri për

integrimin me të drejta të barabarta të të romëve në shoqërinë bullgare janë duke u shënuar hapa përpara në këtë drejtim. Programi përfshin sektorët e edukimit, kulturës, banimit, punësimit dhe mbrojtjes sociale. Gjithsesi BE vazhdon të konstatojë nevojën për veprime të mëtejshme.

Zhvillimet ekonomike dhe sociale

Bullgaria zotëron ndërkohë një ekonomi tregu funksionale. Ky zhvillim bëhet edhe më i dukshëm nëse mendohet që në "dimrin e urisë" 1996-1997 ekonomia bullgare preku shprehimisht fundin.

Privatizimi në rritje, heqja e subvencioneve shtetërore dhe konsolidimi i financave të shtetit kanë kontribuar dukshëm në këtë sukses.

Lidhur me transformimet ekonomike dhe stabilitetin e arritur Bullgaria është zhvilluar në një vend ekonomik interesant për investimet e huaja. Këtu shtohet edhe sistemi i thjeshtë dhe atraktiv i tatimeve, që tërheq shumë zotërues kapitali.

Por procesi i transformimit ka sjellë me vete edhe barra të konsiderueshme sociale për popullsinë. Popullsia në fakt ka përfituar ngadalë edhe nga rritja ekonomike, e megjithatë të ardhurat mesatare janë 25 përqind më të pakta se mesatarja e BE-së, dhe plot një milion bullgarë janë krejtësisht të përjashtuar nga hovi i zhvillimit ekonomik. Kjo situatë mund të krijojë në të ardhmen ndonjë forcë sociale eksplozive. Në sektorin e energjisë përbën ende një problem të madh varësia e Bullgarisë nga energjia bërthamore, nga e cila prodhohet më shumë se 40 përqind e energjisë elektrike në vend.

Në sektorin e mjedisit vendi vazhdon të ketë nevojë të konsiderueshme për rimëkëmbje. Mbështetja para së gjithash e sektorit të industrisë së rëndë, atij të energjisë, dhe të minierave si dhe përdorimi i teknologjive të vjetra shkaktojnë pjesërisht ndotje të mëdha të ajrit, tokës dhe ujit. Megjithëse pas kthesës pati një ndryshim në mënyrën e të menduarit (ngritja e Minsitrisë së Mjedisit më 1990, përcaktimi i mbrojtjes së mjedisit si prioritet shtetëror në vitin 1991) dhe ngarkesa mjedisore ka ardhur vazhdimisht në ulje, Bullgaria ende nuk është në gjendje të konkurrojë me të gjitha standardet e BE-së.

Ekonomia është zhvilluar mirë që prej anëtarësimit. Sipas vlerësimeve të Bashkimit Evropian investimet janë rritur me një vlerë prej 400 mil euro. Fuqia blerëse e popullsisë shtohet dhe buxheti i shtetit, i cili dikur ishte shumë pranë falimentimit, tanimë shënon teprica.

Por nga zhvillimet pozitive ekonomike përfitojnë vetëm grupe të caktuara sociale, si banorët e qyteteve, më të rinjtë dhe ata me nivel arsimor të lartë. Më të moshuarit dhe popullsia në fshatra vazhdojnë të jetojnë në varfëri. Gjendja sociale e pashpresë e shumë njerëzve është arsyeja për radikalizimin dhe kriminalizimin e shoqërisë bullgare. Kështu më shumë se 10.000 femra bullgare në vit bien viktimë e rrjetit të organizuar të trafikantëve të femrave – dhe këto janë vetëm shifrat zyrtare, ato në hije mund të jenë edhe më të larta.

Kur Bullgaria u bë anëtare e BE, ajo nuk i përmbushte ende në masë të plotë Kriteret e Kopenhagen-it – shtetin ligjor dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ndaj në Marrëveshjen për Anëtarësimin janë parashikuar si masa të fundit disa klauzola sigurie: Nëse në sektorët problematikë nuk ndërmerren reforma, atëherë ekziston rreziku i shkurtimeve të subvencioneve dhe mosnjohjes së vendimeve gjyqësore. Kështu Komisioni i BE-së në raportin e tij të parë të përkohshëm mbi zhvillimin e Bullgarisë, datë 27 qershor

2007, tërhoqi vëmendjen në lidhje me këtë fakt. Edhe Transparency International kritikonte faktin, që në luftën kundër korrupsionit Bullgaria nuk kishte shënuar progresin e dëshiruar. Për periudhën 2007-2009 ishin parashikuar fonde të tjera të BE-së në vlerën e plot 4,5 miliardë euro. Por ndihmat masive në ndërtim dhe edhe pranimi i Bullgarisë dhe Rumanisë në BE janë edhe në interes të vetë Unionit, pasi në terma afatmesëm kjo mund të kishte efektin e një sinjali pozitiv në të gjithë rajonin.

Aktualisht fondet për vitin 2008 janë bllokuar nga Komisioni Evropian – një fenomen ky deri më tani unik. Komisioni Evropian reagoi me këtë masë të pazakontë ndaj rezultateve negative të Bullgarisë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në këtë mënyrë Bullgaria po luan me besimin që BE ka treguar ndaj vendit me anëtarësimin në vitin 2007. Në kuadër të strategjisë së përafrimit me BE-në që prej vitit 1994 në Bullgari kanë hyrë më tepër se 6 miliardë euro në ndihma për ndërtim strukturash dhe konversione, por një pjesë jo për tu nënvlerësuar e këtyre fondeve u zhduk në kanale të errëta.

Megjithëse anëtarësimi është realizuar tashmë Komisioni do të vazhdojë edhe për tre vjet të tjera të hartojë raportet vjetore për performancën dhe monitorimin. Në këtë mënyrë synohet që përpjekjet e premtuara, po deri më tani të munguara, për transformim të vazhdojnë të mbeten në qendër të vëmendjes.

Anëtarësia e Bullgarisë në BE analizohet në mënyrë kritike edhe në shtypin evropian. Kështu shtypi austriak shkruante: "Shumica e aktorëve politikë janë të gatshëm që të pohojnë nën zë, që anëtarësimi i Bullgarisë para një viti ishte një gabim. Faktet e provojnë këtë. Shtetet atëherë nuk kishin arritur pjekurinë për anëtarësim në BE as nga ana politike as nga ajo ekonomike dhe që atëherë – kur nuk e kanë më karrotën e anëtarësimit para hundës – e kanë ulur edhe më shumë ritmin."

Edhe brenda Bullgarisë vihet re qartë, që pëparimet më të mëdhaja janë bërë në vitet e përafrimit me BE-në dhe në periudhën direkt para anëtarësimit. Që prej pranimin në BE ka patur më pak përpjekje konkrete për të arritur standardet evropiane, edhe pse Ministri i Brendshëm Rumen Petkow pretendon, se numri i atentateve ka rënë, bandat kriminale janë shkatërruar dhe nëpunësit e korruptuar janë pushuar nga puna.

Bullgarët e ndjenë kriminalitetin real në jetën e tyre të përditshme, kësaj i shtohen kanalet spektakolare të korrupsionit rreth Ministrin të Ekonomisë dhe Energjisë Rumen Owtscharow. Që shoqëria bullgare të ketë besim në forcat e policisë dhe sistemin e drejtësi as që mund të bëhet fjalë. Pas tremujorit të parë të anëtarësimit në BE u bë e qartë: Shndërrimi i strukturave, që duhej të shkonte përtej përmbushjes së direktivave të dhëna nga BE, nuk u bë i mundur. Pasi ndarja e qartë e legjislativit, ekzekutivit dhe pushtetit gjyqësor, që do të kishte qenë e nevojshme për këtë shndërrim, ose nuk ishte në interes të vendimmarrësve të Bullgarisë ose këta nuk mundën ta realizonin atë.

Objektivat e politikës së jashtme

Nga pikëpamja e politikës së jashtme kohët e fundit Bullgaria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për intensifikimin e bashkëpunimit rajonal. Në konfliktin e Kosovës qeveria bullgare mori që në fillim një qëndrim të qartë pro-perëndimor. Bullgaria mbështeti sulmet ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë dhe lëshoi leje mbiflurimi për avionët e NATO-s. Me anëtarësimin në NATO të marsit 2004 Bullgaria arriti objektivin e parë të madh në fushën e politikës së jashtme. Bullgaria, njësoj si bënë 21 shtete të tjera

anëtare të BE-së gjatë vitit 2008, njohu pavarësinë e Kosovës duke dëmtuar kështu edhe më shumë marrëdhëniet jo domosdoshmërisht të mira me Serbinë.

Por edhe në rajonin e vet, Evropën Juglindore, Bullgaria angazhohet për një balancim paqësor interesash në kuptimin e fqinjësisë së mirë, dhe për një bashkëpunim më të mirë ekonomik në të gjitha fushat. Segmente të rëndësishme tranzit kalojnë nga Bullgaria (transport, linja të transmetimit të energjisë). Vendi ushtron një politikë të jashtme aktive dhe e konsideron veten një spirancë të stabilitetit në rajon. Nga 2002 deri më 2003 ajo ishte një „anëtar jo i përhershëm“ në Këshillin e Sigurisë së Kombeve të Bashkuara. Në vitin 2004 Bullgaria pati kryesinë e Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE) dhe merr pjesë tashmë në misione ndërkombëtare paqeruajtëse në Kosovë, Bosnjë/Hercegovinë, Afganistan dhe Etiopi / Eritrea. Që prej gushtit 2003 është stacionuar në Irak edhe një kontingjent bullgar me plot 45 ushtarë si pjesë e të ashtuquajturit "Koalicioni i të gatshmeve". Aktiviteti ndërkombëtar në rritje i këtij vendi shihet si shenjë e etablimit të Bullgarisë në sistemin ndërkombëtar dhe i marrjes përsipër të përgjegjësiave, që rrjedhin së këtejmi.

Në datën 1 janar 2007 Republika e Bullgarisë u bë anëtare e Bashkimit Evropian. Ky anëtarësim është rezultat i një procesi zhvillimi të iniciuar në vitet nëntëdhjetë në kuadër të të ashtuquajturit proces të asociimit në vitin 1993 nisi një dialog politik – mbështetur nga një Komision i Përbashkët mes BE-së dhe Bullgarisë. Në vitin 1995 Qeveria dhe Parlamenti i Bullgarisë vendosën të bëjnë kërkesën për anëtarësim. Por duke qenë se nga mesi i viteve nëntëdhjetë sistemi bullgar i ekonomisë dhe financave ra në krizë të thellë, në këtë kohë u kërkuar pothuaj me forcë anëtarësimi në NATO, i cili u konsiderua si një lloj trampoline. Më në fund në datën 25 prill 2005 u nënshkrua marrëveshja për anëtarësimin mes Bullgarisë resp. Rumanisë dhe BE. Ndërkohë Bullgaria dhe gjashtë shtete të tjera ishin pranuar në NATO më 29 mars 2004.

Në debatin për emrin mes Maqedonisë dhe Greisë, Bullgaria qëndron e vendosur krahas Maqedonisë. Bullgaria ishte shteti i parë që e njohu Maqedoninë me emërtimin e vet kushtetues „Republika e Maqedonisë“ dhe refuzoi të gjitha kërkesat e Greqisë për të zgjedhur një emërtim tjetër.

Bullgarja Meglena Kunewa mban në Komisionin Barroso prej janarit 2007 postin e komisioneres evropiane për mbrojtjen e konsumatorit. Në këtë mënyrë ajo mori një pjesë së portfolios së Komisionerit për Shëndetësinë Markos Kyprianou (Qipro).

Taktika:

Si delegat/e vendosni theksin në faktin, që Bullgaria ndihet e lidhur fuqishëm me komunitetin evropian të vlerave (shteti ligjor, demokracia, pluralizmi, ekonomia e lirë e tregut dhe të drejtat e njeriut). Referojuni mbështetjes së madhe të popullsisë për integrimin e mëtejshëm të shteteve të Ballkanit në BE. Nënvizoni marrëdhëniet e thella disavjeçare të vendit Tuaj me Ballkanin dhe vini në dukje që shtetet e Evropës Juglindore nuk mund të mbeten të përjashtuara nga Unioni politik.

Në pikëpamjen e politikave të sigurisë evidentoni impaktin pozitiv të një Bullgarie të qëndrueshme dhe në prosperitet mbi rajonin e Ballkanit të gërryer nga luftrat. Sillni në vëmendje gjithashtu, që vendi Juaj përpiket të realizojë të gjitha reformat e nevojshme, por që për këtë do të keni eventualisht nevojë për më shumë kohë se sa ishte planifikuar.

Mos harroni që qëllimi Juaj i parë është pranimi i Maqedonisë në BE, dhe kjo sa më shpejt të jetë e mundur! Zgjerimi i Bashkimit Evropian nuk duhet të vazhdojë të përjashtojë Evropën Juglindore! Duke u bazuar në afërsinë historike dhe të përbashkëtat kulturore Ju e ndjeni veten veçanërisht përgjegjës edhe nëse Maqedonia do të ndihej në njëfarë mënyre e tuteluar përmes veprimeve Tuaja.

Sillni në vëmendje dizavantazhet e mëdha ekonomike që Bullgarisë iu desh të pësonte përmes luftës në Kosovë, dhe vini theksin në mbështetjen pa kushte që qeveria bullgare i dha perëndimit gjatë krizës.

Për arsye ekonomike vendi Juaj është i interesuar për çtensionimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm në Ballkan. Theksoni gatishmërinë e Bullgarisë për të ndërmarrë edhe në të ardhmen një rol stabilizues për rindërtimin e Ballkanit në kuadër të Paktit të Stabilitetit. Por nga ana tjetër bëni të qartë edhe që masa ultimative e stabilizimit është anëtarësimi i Ballkanit në BE.

Referuar Turqisë Ju nxirrni në pah marrëdhëniet e mira mes pjesëve të krishtera dhe muslimane të popujve Tuaj. Këtë mund ta përdorni si shembull të mirë të bashkëjetesës edhe me Turqinë. Por përballë delegacionit turk Ju ngulni këmbë në realizimin rrënjësor dhe të qëndrueshëm të reformave.

Republika Çeke [Česká Republika]

Kryeqyteti:	Praga (1,3 mil banorë) (të gjitha shifrat të 2004)
Forma shtetërore:	Demokraci parlamentare
Sipërfaqja:	78.884 km ²
Nr. i banorëve:	10,3 mil
PBB / banor:	11 220 US-Dollar
Rritja ekonomike:	6,1%
Papunësia:	7,1 % (2003)
Gjuhët:	Çekisht
Grupet etnike:	90,1 % Çekë, 3,7 % me origjinë nga Mähren dhe Schlesien, 1,8 % sllovakë, 0,5 % polakë, 0,4 % gjermanë, 3,5 % të tjerë
Besimet fetare:	romako-katolikë 39 %, evangjelistë 2,5 %, Husitë çekë 1,7%, ortodoksë 0,2 %, greko-katolikë 0,07 %
Anëtar i Kom.Evr./BE:	1. Mai 2004
Kryetar shteti:	Vaclav Klaus
Kryetar qeverie:	Mirk Topolanek
Informacione të tjera:	www.mzv.cz

www.weltalmanach.de (2008)

Ju jeni përfaqësues/e i/e Republikës Çeke në Këshillin e Bashkimit Evropian. Vendi Juaj është që prej datës 1 maj 2004 anëtar i BE-së dhe në këtë funksion përballet me vendimmarrjen për një zgjerim të mëtejshëm.

Republika Çeke në BE in der EU

Republika Çeke (më parë Çekosllovakia) ka ndjekur gjithmonë një rrugë të vetën („Pranvera e Pragës“ 1968). Ajo u shkëput nga sistemi autoritar socialist që në vitet tetëdhjetë. Në vitin 1989 u zhvillua „Revolucioni i kadifentë“, që e bëri shkrimtarin Vaclav Havel në Presidentin e vendit. Që prej vitit 1989 është zhvilluar demokracia politike. Çekia ia doli të realizonte një kalim paqësor nga sistemi socialist njëpartiak në një sistem pluralist shumëpartiak. Bazat e shtetit – demokracia, shteti ligjor dhe pluralizmi – janë të ankoruara në mënyrë të palëvizshme. Po kështu edhe organet kushtetuese punojnë në mënyrë korrekte.

Territori shtetëror i Republikës Çeke ka qenë historikisht një ndër zonat më të zhvilluara të Evropës nga pikëpamja ekonomike dhe industriale. Si vendi i vetëm i Evropës Qendrore, që deri në vitin 1938 ka qenë një sistem demokratik, Çekosllovakia e atëhershme, pra para Luftës së Dytë Botërore, bënte pjesë në dhjetë shtetet industriale më të zhvilluara të botës.

Edhe pse në kuptimin e të drejtës ndërkombëtare Republika Çeke përfaqëson një vend shumë të ri evropian, ajo i detyrohet shumë trashëgimisë evropiane të strukturës së dikurshme shtetërore ndaj edhe herë pas here i referohet traditës qindrvjeçare të shoqërisë multikulturore çeke në qendër të Evropës. Për motive dhe historike dhe politike („Rikthim në Evropë“) Pranimi i Republikës Çeke në Bashkimin Evropian ka patur një rëndësi dhe vlerë të madhe, dhe anëtarësimi përfundimtar në maj 2004 është cilësuar si një sukses i madh. Për Republikën Çeke bashkimi i Evropës ka sjellë edhe përmirësimin e marrëdhënieve me vendet fqinje, para së gjithash me Gjermaninë dhe Poloninë dhe prej disa vitesh bashkëpunimi me Sllovakinë është sërish prioritet absolut.

Në të shkuarën e afërt "euforia për Evropën" në vend sikur u zbut në njëfarë mënyre nga fuqizimi i forcave skeptike për idenë evropiane. "PO"-ja e Çekisë në mbyllje të referendumit në lidhje me anëtarësimin e saj në Bashkimin Evropian nuk u dëgjua aq qartë sa ishte shpresuar.

Në nivel tematik Çekia angazhohet në mënyrë të veçantë në fushën e Politikave të Përbashkëta për Punët e Jashtme dhe Çështje të Sigurisë si dhe mbështet partneritetin e konsoliduar euro-atlantik. Ajo trajton me përparësi edhe intensifikimin e bashkëpunimit evropian në fushën e Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme – sidomos në lidhje me çështje të refugjatëve dhe luftës kundër drogës.

Republika Çeke dhe raundi i ardhshëm i zgjerimit

Megjithë fillimin e skepticizmit njerëzit në Çeki janë të vetëdijshëm për zhvillimet jashtëzakonisht pozitive të reformave në kuadër të anëtarësimin në BE dhe qeveria e konsideron si një çështje të rëndësishme, që këto përvoja t'u përcillen më tej shteteve kandidatë për anëtarësim.

Në parim Çekia e konsideron gjithashtu të rëndësishme të intensifikojë marrëdhëniet e saj bilaterale me shtetet fqinje të Evropës Qendrore dhe Lindore. Krahas mbështetjes konkrete të kandidatëve të caktuar për anëtarësim Çekia angazhohet edhe për një politikë fqinjësie aktive evropiane me ato vende që nuk kanë ende një perspektivë anëtarësimi në një të ardhme të afërt.

Me Ballkanin Çekia i ka intensifikuar marrëdhëniet kohët e fundit. Pas përfundimit të Luftës në Ballkan Republika Çeke e shfrytëzoi situatën pozitive fillestare për të rilidhur marrëdhëniet intensive të tregtisë me rajonin e Ballkanit. Edhe në nivel politik dhe të politikave të sigurisë vendi ka marrë pjesë në iniciativa shumëpalëshe sikurse është Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore dhe Trupat e SFOR-it (deri 2001). Mbështetja e rajonit është një çështje me rëndësi prioritare për politikën e jashtme çeke, por ende nuk mund të bëhet fjalë për perspektiva konkrete anëtarësimi në BE.

Në lidhje me njohjen e Kosovës qeveria çeke ka mbajur një qëndrim të tërhequr. Çekia e ka parë si urgjentisht të nevojshme, që shtetet e Bashkimit Evropian të vendosin bashkarisht, se si duhet proceduar në këtë çështje. Duhet treguar kujdes për respektimin e Rezolutës 1244 të Kombeve të Bashkuara.

Qeveria Çeke ka mirëkuptim për pozicionin e Serbisë pas respektimit të Rezolutës 1244 të Kombeve të Bashkuara, edhe pse Bashkimi Evropian në tërësinë e tij mbështet një Kosovë të pavarur.

Gjithsesi për Çekinë është me rëndësi që Serbia të mos trajtohet si e varur nga ky zhvillim. Përkundrazi, pikërisht për këtë Serbia duhet përfshirë më shumë në dialog dhe, nëse kjo do të dëshirohet nga qeveria e Serbisë, duhet mbështetur anëtarësimi i saj në BE.

Taktika:

Si përfaqësues/e i/e qeverisë Çeke Ju shpreheni në përgjithësi pro vijimit të zgjerimit evropian. Por theksoni që opsioni i anëtarësimin u duhet hapur vetëm atyre vendeve që përmbushin në mënyrë të paekzistues Kriteret e Kopenhagenit.

Ju do të vazhdoni të angazhoheni në të njëjtën masë për stabilizimin e raporteve në Ballkanin Perëndimor. Gjithsesi Ju bëni kujdes të mos përmendni një perspektivë konkrete anëtarësimi. Në rastin e Kroacisë, që në vlerësimin Tuaj është vendi që ka bërë më shumë përparime në rajon, Ju mbështesni integrimin në strukturat evropiane. Kjo mund të realizohet, në varësi të zhvillimeve të të dyja palëve, si një anëtarësim i plotë ose përtej tij.

Një pozicion të ngjashëm përfaqësoni në lidhje me kërkesën e Turqisë për anëtarësim. Nëse plotësohen të gjitha kriteret atëherë Ju nuk bëheni pengesë e hapjes së bisedimeve të anëtarësimit. Por një anëtarësim faktik të vendit në BE Ju e qani të mundshëm vetëm në një të ardhme të largët, në mbyllje të një procesi të gjatë përafrimi. Pas pavarësisë së Kosovës Ju kërkoni me çdo kusht kontakte të mira me Serbinë dhe përpiqeni t'ï mundësoni shtetit serb anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

GJERMANIA

Kryeqyteti:	Berlin (3.404.000) (shifra të 2004)
Forma shtetërore:	Republikë, Shtet Federal
Sipërfaqja :	357.000 km ²
Banorë:	82.375.000
PBB / banor:	36.800 US-Dollar
Rritja ekonomike :	2,8 %
Papunësia:	7,6 %
Gjuhët:	gjermanisht, danezçe, dialekt holandez dhe sorbisht (e sllavëve të perëndimit)
Besimet fetare:	katolikë 34 %, protestantë 34 %, muslimanë 3,7 %, të tjera dhe pa fe 28,3 %
Grupet etnike:	91,5 % Deutsche, 2,4 % Türken, 6,1 % andere
Anëtarë Kom.Evr./BE:	anëtar themelimi
Kryetar shteti:	Horst Köhler
Kryetare qeverie:	Dr. Angela Merkel
Informacione të tjera:	www.bundeskanzleramt.de

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni përfaqësues/e i/e Gjermanisë në Këshillin e Bashkimit Evropian. Në këtë funksion menjëherë pas pranimit të dymbëdhjetë shteteve të reja anëtare nga Evropa Qendrore dhe Lindore Ju përballeni sërish me vendimmarrjen për kërkesa të tjera anëtarësimi në BE.

Gjermania në BE

Gjermania është një ndër gjashtë shtetet themelues të Komunitetit Evropian për Ekonominë dhe që prej fillësive të procesit të bashkimit evropian ka bërë një politikë shumë miqësore integrimi. Evropa e bashkuar është në mënyrë absolute interes bazë i Gjermanisë, ku bashkëpunimi me Francën në kuadër të „motorrit gjermano-frances“ kishte prioritetin më të lartë.

Qeveria aktuale po e vijon më tej këtë politikë. Gjermania mbështet fuqishëm thellimin e Unionit dhe zgjerimin e tij për arsye të ndryshme:

- Procesi i bashkimit evropian siguron paqen dhe lirinë në Evropë. Në raste nga më të ndryshmet Gjermania ka sjellë në vëmendje herë pas here detyrimin historiko-moral që edhe shteteve të Evropës Juglindore t'u mundësohet përfshirja në BE.
- Pas raundit të zgjerimit në drejtim të lindjes në vitin 2004 qendra politike dhe gjeografike e Evropës u zhvendos në favor të Gjermanisë. E megjithatë nuk duhet lejuar që mbi bazën e dallimeve ekonomike dhe politike ne kufijtë e Evropës të krijohen blloqe të reja vendesh. Me qëllim që të mos lindin kufij të rinj duhen intensifikuar strukturat përkatëse të bashkëpunimit në nivel mbarëevropian si dhe marrëdhëniet mes BE-së dhe Rusisë.
- Me zgjerimin e Unionit Republika Federale e Gjermanisë shpreson në njohje dhe vlerësim më të madh ndërkombëtar.
- Pikërisht shtete eksportuese sikurse është Gjermania, kanë përfituar nga rënia e barrierave të tregtisë brenda tregut të brendshëm. Në një botë të globalizuar mbijetesa në tregjet botërore është e mundshme vetëm në një Evropë të bashkuar dhe me një monedhë të përbashkët. Për këtë arsye Gjermania mbështet procesin e rimëkëmbjes ekonomike në rajonet më të varfra, për të garantuar stabilitetin ekonomik në vendet

anëtare dhe ato kandidatë për anëtarësim dhe për t'i shndërruar ato në tregje për produktet gjermane. Që tani Gjermania është shndërruar në partnerin më të madh tregtar për shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore.

- Përveç se në çështje të zgjerimit Gjermania përpiket që të bëhet përpara edhe në thellimin e Bashkimit Evropian. Pjesë e këtij angazhimi është gatishmëria për të ratifikuar Kushtetutën Evropiane, me qëllim që vendimmarrja e 25 shteteve anëtare të lehtësohet në një masë të konsiderueshme. Krahas kësaj qeveria federale është e vetëdijshme, që në raste çështjesh sociale si psh. politikat e migrimit dhe të drejtës për azil, politikat për sigurinë dhe mjedisin, mund të kenë efekt vetëm zgjidhjet e gjetura në nivel evropian.

Gjermania dhe zgjerimi i ardhshëm

Qeveria Federale mbështet shkallën tjetër të zgjerimit të Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit dhe Turqinë. Referuar Ballkanit Gjermania luan një rol thelbësor në ruajtjen e paqes së atjeshme pas luftrave civile të përgjakshme të viteve nëntëdhjetë. Gjermania është një nga iniciatorët dhe mbështetësit e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore. Edhe bashkëpunimi ekonomik me këto vende ka bërë shumë përpara.

Gjermania dhe Shqipëria

Marrëdhëniet gjermano-shqiptare janë të ngushta dhe me karakter partneriteti. Sipas informacioneve të palës shqiptare Gjermania është donatori më i madh në nivel bilateral në ndihmën për zhvillim, para së gjithash në fusha me rëndësi qendrore si furnizimi me ujë dhe energji dhe gëzon një reputacion të lartë si mbështetëse e procesit të reformave në Shqipëri.

Në vazhden e procesit të demokratizimit që prej pranverës së vitit 1991 marrëdhëniet mes dy vendeve janë gjallëruar dukshëm. Shqipëria dëshiron të sigurojë mbështetjen e Gjermanisë në rrugën e saj drejt strukturave euroatlantike. Është në interesin gjerman që përmes mbështetjes së procesit të transformimit demokratik të kontribuohet në raporte të qëndrueshme në Shqipëri dhe në rajon. Marrëveshja e Stablizimi-Asociimit, nënshkruar me BE në qershor 2006, i ofron Shqipërisë një perspektivë të besueshme evropiane; krahas kësaj Gjermania e ka mbështetur Shqipërinë në ftesën që i është bërë asaj për tu anëtarësuar në NATO në prill 2008. Shqipëria e konsideron Gjermaninë si mbështetës të veçantë të interesave të saj jo vetëm në kuadër të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore.

Nga pikëpamja ekonomike Shqipëria orientohet qartë për nga Bashkimi Evropian (88 % e eksporteve shqiptare dhe 60 % të importeve shqiptare), me Italinë si partnerin më të madh në fushën e tregtisë, ndjekur ng Greqia. Gjermania vjen pas Turqisë dhe Kinës në vendin e pestë.

Gjermania dhe Bosnje-Hercegovina

Gjermania është një ndër partnerët më të rëndësishëm të Bosnje-Hercegovinës në politikën e jashtme. Që prej lidhjes së marrëdhënieve diplomatike në mes të vitit 1994 marrëdhëniet dypalëshe janë zhvilluar vazhdimisht në mënyrë pozitive. Gjermania ka marrë pjesë intensivisht në përpjekjet për vendosjen e paqes para dhe pas lidhjes së Marrëveshjes së Dayton-it, ndër të tjera edhe përmes angazhimit të vet në kuadër të Grupit të Kontaktit, të Komisionit Drejtues të Këshillit për Implementimin e Paqes sërish në kuadër të Dayton-it, përmes pjesëmarrjes në konferenca donatorësh si dhe përmes

kontingjentesh të mëdha trupash gjermane në misionin ushtarak EUFOR të BE si dhe në misionin e BE-së për forcat policore (EUPM).

Bosnje-Hercegovina sheh te Gjermania një ndër mbështetësit më të rëndësishëm në Evropë, në procesin e reformave lokale dhe në përafrimin e vendit me Bashkimin Evropian.

Gjermania dhe Kroacia

Marrëdhëniet mes Gjermanisë dhe Kroacisë janë të ngushta dhe pozitive. Kjo vjen nga njëra anë si pasojë e ndikimeve kulturore qindravjeçare të Gjermanisë respektivisht Austrisë dhe e numrit të madh të kroatëve, që jetojnë në mënyrë permanente në Gjermani (në vitin 2003 të regjistruar ishin 236.600 persona) si dhe e punëtorëve emigrantë të dikurshëm, ndaj edhe shumë kroatë flasin mirë gjermanisht. Nga ana tjetër turistë të shumtë gjermanë vizitojnë çdo vit Kroacinë (2006: rreth 1,6 mil). Aspekte të tjera të rëndësishme janë shkëmbimet intensive në nivel ekonomik. Marrëdhënie të ngushta mes institucioneve dhe njerëzve të të dy vendeve ekzistojnë edhe në nivel shkencor dhe teknik.

Qeveria Federale ndihmon me një sërë projektesh në forcimin e strukturave të ekonomisë së tregut, në modernizimin e administratës, në reformën në sistemin e drejtësisë dhe në përafrimin e legjislacionit kroat me kërkesat e të drejtës evropiane. Kjo realizohet para së gjithash me masa konsulence dhe kualifikimi, me hartim studimesh, me vizita dhe hospitime të nëpunësve, sipërmarrësve dhe ekspertëve kroatë të fushave të tjera në Gjermani. Me ndihmën gjermane realizohen edhe projekte humanitare, ku bëjnë pjesë riparimi i ndërtesave të shkatërruara nga lufta, modernizimi i infrastrukturës si dhe heqja e minave.

Si partner i Kroacisë në fushën e tregtisë Gjermania zë vendin e dytë. Konstatohet rritje e tregtisë në nivel bilateral. Edhe në fushën e investimeve direkte Gjermania zë vendin e dytë pas Austrisë.

Gjermania dhe Kosova

Gjermania ka prej kohësh kontakte të mira me rajonin, veçanërisht me Serbinë, të cilën gjithashtu e mbështet në rrugën e saj drejt BE-së. Por kjo afërsi me Serbinë nuk duhet të ngatërrohet me faktin që Gjermania, së bashku me Francën, ishin shtetet e para të Bashkimit Evropian që në shkurt 2008 njohën pavarësinë e Kosovës. Ndërkohë janë gjithsej 22 shtete të BE që e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur. Vetëm Spanja, Greqia, Qiproja, Rumania dhe Sllovakia nuk e kanë njohur ende Kosovën. Këto shtete anëtare duan t'i bindin këto të fundit që qasja e BE-së drejt Kosovës të jetë si një e tërë.

Gjermania dhe Maqedonia

Marrëdhëniet dypalëshe janë shumë të mira. Gjermania është partneri më i rëndësishëm i Maqedonisë në nivel ekonomik dhe politik. Referencat qendrore në lidhje me këtë janë mbështetja e hershme dhe konsekuente e Maqedonisë menjëherë pas pavarësisë së saj, roli i Gjermanisë si partner me një profil udhëheqës në fushën e bashkëpunimit si dhe rreth 62.000 shtetas maqedonas, që jetojnë në Gjermani. Po kështu edhe mbështetja e palës gjermane gjatë krizës në Kosovë dhe krizës në Maqedoni brenda të njëjtit vit 2001, si dhe mbështetja e vijuar deri në ditët e sotme kanë përforcuar emrin e Gjermanisë si një partner veçanërisht i besueshëm. Maqedonia shikon te Gjermania edhe një avokat dhe mbështetës të rëndësishëm në përafrimin me strukturat euroatlantike.

Gjermania është tradicionalisht një ndër partnerët më të rëndësishëm të Maqedonisë në fushën e tregtisë. Eksportet më të rëndësishme gjermane janë paraprodukte për industrinë tekstile si dhe automjete (vetura dhe kamionë); ndërsa në importet më të rëndësishme nga Maqedonia bëjnë pjesë veshje, enë hekuri ose çeliku si dhe prodhime të industrisë ushqimore. Vëllimi i tregtisë dypalëshe në vitin 2006 shënoi një rritje prej 20 përqind në krahasim me një vit më parë duke arritur vlerën e më shumë se 700 mil euro (importet drejt Gjermanisë rreth 370 mil euro ndërsa eksportet drejt Maqedonisë rreth 343 mil euro). Sipas informacioneve të Zyrës Federale të Statistikave vëllimi tregtar deri në nëntor 2007 ishte rritur me 18,9 përqind duke arritur vlerën e 770 mil euro.

Gjermania dhe Mali i Zi

Në politikën gjermane dhe evropiane përkundrejt Malit të Zi qëndron në plan të parë mbështetja e kursit të reformave politike dhe ekonomike për stabilizimin e mëtejshëm të vendit. Një rol të rëndësishëm në kontekstin e bashkëpunimit mes Gjermanisë dhe Republikës së Malit të Zi ka patur në të shkuarën e afërt „Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore“ financuar në një masë të konsiderueshme nga Gjermania. Krahas kësaj Gjermania angazhohet edhe në kaudër të një numri të madh projektesh në nivel të bashkëpunimit dypalësh dhe të BE-së.

Shumë projekte të mbështetura nga Gjermania synojnë mbështetjen e përpjekjeve për reforma të forcave demokratike si dhe përforcimin e vetëdijes evropiane të popullsisë së Malit të Zi.

Përveç kësaj Gjermania mbështet sektorët e reformës ligjore dhe administrative, demokratizimin dhe reformën e forcave të policisë dhe ushtrisë si dhe rolin e mediave. Sektorë qendrorë të mëtejshëm të bashkëpunimit në formë projektesh janë mbështetja e shoqërisë civile si dhe fusha e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve.

Pas ndryshimeve demokratike u rivendos bashkëpunimi në fushën e politikave për zhvillim me Serbinë dhe Malin e Zi. Me një Program të Asistencës së Mënjëhershme në vlerën e 26 mil eurove për Serbinë dhe Malin e Zi u relaizua një kontribut i rëndësishëm për stabilizimin e këtij unioni shtetesh.

Me Malin e Zi ka qenë e mundur që vitet e fundit të vendoset një bashkëpunim i mirë e i suksesshëm në fushën e politikave për zhvillim. Me një mbështetje të deritanishme në vlerën e plot 110 mil eurove vendi ka marrë nga Gjermania një kontribut mbiproporcional në kuadër të bashkëpunimit dypalësh për zhvillim.

Gjermania dhe Serbia

Në plan të parë të politikës gjermane dhe evropiane përkundrejt Serbisë është mbështetja për kursin e reformave në nivel ekonomik dhe politik për stabilizimin e mëtejshëm të vendit. Në kontekstin e bashkëpunimit mes Gjermanisë dhe Serbisë një rol të veçantë luan „Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore“ financuar në një pjesë të mirë me fonde të Gjermanisë, detyrat kryesore të të cilit i kaluan Këshillit Rajonal të Bashkëpunimit krijuar në shkurt 2008. Krahas kësaj Gjermania angazhohet në kuadër të një sërë projektesh të tjera në bashkëpunimin dypalësh.

Që përpara zgjedhjeve të vjeshtës 2000, që çuan në rënien e Milošević-it Qeveria Federale kishte mbështetur forcat reformuese të Serbisë me një numër të konsiderueshëm projektesh, që u realizuan në bashkëpunim me opozitën demokratike që qeveriste në 30 qytete dhe komuna, si dhe me përfaqësues të shoqërisë civile (furnizim me medikamente dhe teknike medicinale, vaj për ngrohje, asfaltime, riparime në rrjetin e furnizimit me ujë dhe riparime shkollash, bashkëpunim me mediat etj). Pas rënies së Milošević-it dhe revolucionit paqësor kjo mbështetje u vijua edhe më tej. Që prej asaj

kohe projektet kanë patur për qëllim mbështetjen e përpjekjeve të forcave demokratike për reforma dhe përqendrohen në fushat e reformës juridike dhe administrative, demokratizimin dhe reformimin e policisë dhe ushtrisë si dhe reformën e mediave. Një sektor tjetër kyç i bashkëpunimit në formë projektesh është fusha e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve.

Gjermania dhe Turqia

Në lidhje me Turqinë Gjermania nënvizon aspektet pozitive që do të sillte anëtarësimi i saj. Qeveria është shprehur për të disatën herë pro anëtarësimit të Turqisë, përse kohë që kriteret e këtij anëtarësimi përmbushen në masë të plotë. Përmes integritit të Turqisë Gjermania shpreson të arrihen stabilizimi i raporteve në Lindjen e Mesme dhe mundësi më të mëdha ndikimi në vendet e botës arabe, bashkëpunimi me të cilët është i një rëndësie themelore për Evropën në luftën e saj ndërkombëtare kundër tendencave fonamentaliste terroriste. Por në nivel të politikës së brendshme kjo temë është e diskutueshme, edhe për arsye të integritit në shkallë të gjerë por deri më tani të arrirë vetëm në aspekte të caktuara të pakicës turke në shoqërinë gjermane. Në mënyrë të veçantë CDU/CSU nuk është për anëtarësimin e Turqisë, dhe kërkon që në vend të kësaj të ndërtohet një raport partneriteti i privilegjuar mes BE-së dhe këtij vendi.

Turqia është me interes të madh për BE-në edhe si partner në fushën e ekonomisë dhe si treg i mundshëm. Edhe sot Gjermania dhe BE përfitojnë në një masë të konsiderueshme nga marrëdhëniet e intensifikuara prej krijimit të Bashkimit Doganor. Prej vitesh Gjermania është partneri më i rëndësishëm tregtar i Turqisë, e cila gjithashtu 50% të tregtisë së saj të jashtme e ka me BE-në. Një e treta e këtij vëllimi realizohet me Gjermaninë. Gjermania ka një pozicion udhëheqës në fushën e investimeve direkte në Turqi. Nga ana tjetër në Gjermani ekzistojnë më shumë se 40.000 biznese turke, të cilat krijojnë më shumë vende pune.

Ekonomia e Turqisë shënon zhvillime pozitive. Kështu në periudhën 1990—2002 ritmi mesatar i rritjes së saj ka qenë 3%. Madje në vitin 2003 PBB-ja reale u rrit me 5%. Edhe problemi i inflacionit vitet e fundit është mundur të zbutet.

Zhvillimet aktuale në Ballkan

Qeveria Juaj përsëritet arrestimin e Radovan Karadzic në vitin 2008. Ju e vlerësoni këtë si një tregues vëçanërisht pozitiv për Serbinë. Në të njëjtën kohë Ju theksoni me forcë faktin, që vetëm ky sukses në kërkimin dhe kapjen e kriminelëve të luftës nuk mjafton dhe që duhet të vazhdohet të kërkohet me forcë për të kapur të gjithë kriminelët e luftës në arrati. Ju kërkonit më tej prej Gjykatës Ndërkombëtare të pavarur për Ish-Jugosllavinë (ICTY) angazhim intensiv dhe vendim burgimi afatgjatë për Karadzic.

Në kontekstin e debatit për çështjen e emrit mes Maqedonisë dhe Greqisë Gjermania mban një pozicion asnjënjës. Ajo ka siguruar se do të pranojë një zgjidhje që do të gjendet me konsensusin e të dyja palëve. Në të njëjtën kohë Gjermania tregon mirëkuptim të konsiderueshëm për Maqedoninë, që kërkon të mbajë emrin e saj kushtetues, për më tepër që ky është njohur tashmë nga pothuaj 110 shtete të Kombeve të Bashkuara.

Në përdorimin brendashtetëror termi gjerman „Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë“ po i lë gjithnjë e më shumë vendin emërtimit kushtetues maqedonas „Republika e Maqedonisë“. Që prej vitit 2007 Gjermani përdor në korespondencën e saj dypalëshe me Maqedoninë emërtimin kushtetues të kësaj të fundit.

Që zgjerimi i BE-së të dështojë në këtë çështje, kjo Ju duket e paimagjinueshme. Ju nuk dëshironi të jeni zyrtarisht të pasjellshëm me kolegët Tuaj grekë, por pas perdes përpigëni

fuqimisht për arritjen e një marrëveshjeje. Në këtë çështje Ju mbështesni indirekt kolegët Tuaj britanikë, të cilët shprehen në mënyrë shumë më ofensive se sa Ju.

Nga këndvështrimi gjerman raundet e mëvonshme të zgjerimit mund të realizohen vetëm nëse BE është e gatshme të çojë përpara me vendosmëri procesin e thellimit (Kushtetutën). Për këtë arsye, përpara realizimit të një faze të re zgjerimi, Gjermania është duke u përpjekur intensivisht për fuqizimin e institucioneve mbikombëtare (Parlamentit Evropian dhe Komisionit) dhe për një vendimmarrje më eficiente (p.sh. vendimmarrje me shumicë të cilësuar në Këshill).

Taktika:

Ju nuk e fshihni që e konsideroni Gjermaninë një fuqi drejtuese në Evropë, e cila angazhohet veçanërisht në çështje të mbrojtjes së mjedistit, standardeve sociale dhe mbrojtjes së konsumatorit. Pas raundit të fundit të zgjerimit Gjermania ka zënë një pozicion qendror në BE dhe mbart një peshë të jashtëzakonshme për Unionin. Për këto arsye Ju mbështesni hapat e ardhshëm të zgjerimit të BE-së. Ballkani dhe Turqia janë njësoj të rëndësishme për Ju.

Por herë pas here Ju duhet të merrni në konsideratë efektet e vendimeve Tuaja te partnerët Tuaj më të rëndësishëm brenda BE-së, para së gjithash mbi Francën, por edhe në vende të tjera të rëndësishme evropiano-perëndimore si dhe në Poloni. Tregoni që hapat e tjera të integritit dhe zgjerimit të Bashkimit Evropian nuk bazohen mbi motive nacionaliste, por synohet të jenë në të mirë të të gjithëve.

Deklaroni se jeni për lejimin e hapave të tjerë të zgjerimit. Ju e konsideroni Ballkanin si pjesë përbërëse integrale të BE-së, por nxirrni gjithashtu në pah detyrimin e këtyre shteteve për të bashkëpunuar me komunitetin ndërkombëtar. Të drejtat e njeriut, shteti ligjor dhe demokracia duhet të respektohen pa përjashtime. E njëjta gjë vlen për çështjen e anëtarësimit të Turqisë.

Në të njëjtën kohë Ju duhet të merrni në konsideratë gjendjen dhe tendencat e elektoratit gjerman; zgjerimi lidhet me barrat e mëtejshme dhe të konsiderueshme financiare – jo rrallëherë kritikohet për këtë arsye pjesëmarrja shumë e lartë e Gjermanisë në Buxhetin e BE-së dhe kërkohet reduktimi i këtij kontributi. Ndaj Ju përpiqeni të realizoni në nivel evropian kufizimin e buxhetit për BE-në, gjë që do të reduktonte më pas kostot e zgjerimit deri në një masë të pranueshme.

Krahas kësaj shumë qytetarë shprehin frikën, se në rast pranimi të shteteve të tjera në BE dhe, për pasojë, rritjes së tregut të punës, për shkak të migrimit të fuqisë së lirë punëtore nga Evropa Lindore dhe Juglindore në Gjermani do të ketë edhe një rritje të papunësisë dhe siguria e brendshme do të vihet në rrezik nga kriminaliteti i konsoliduar ndërkombëtar. Ndaj popullsia e shtetit federal gjerman mbështet një integrim në terma afatgjatë në Bashkimin Evropian me afate tranzitore gjithashtu të gjata në lidhje me lëvizjen e lirë të personave. Ju duhet të angazhoheni për vendosjen e këtyre afateve në mbështetje të zgjedhësve Tuaj.

Skepticismi përkundrejt Bashkimit evropian dhe aftësisë së tij për të zgjidhur problematikat e grumbulluara është në rritje të vazhdueshme njësoj si dyshimet në lidhje me aftësinë vendimmarrëse të Unionit. Ndaj bëni të qartë që Gjermania është një mbrojtëse e zjarrtë e hapave të mëtejshme të thellimit dhe mbron idenë e pranimi të Kushtetutës Evropiane. Në gjykimin Tuaj thellimi i mëtejshëm i integritit është kusht paraprak për suksesin e fazave të planifikuara të zgjerimit.

Danimarka (Danmark)

Kryeqyteti:	Kopenhagen
Forma shtetërore:	Monarki konstitucionale
Sipërfaqja:	43.198 km ²
Nr. i banorëve:	5.437.000
PBB /banor:	52.100 US-Dollar
Rritja ekonomike :	3,2 %
Papunësia:	3,8 %
Gjuhët:	Danisht, Gjermanisht (rajonale)
Besimet fetare:	84 % luteranë
Grupet etnike:	95 % danezë
Anëtar i BE/Kom. Evr.:	1973
Kryetar shteti:	Mbretëresha Margarethe II.
Kryetar qeverie:	Fogh Rasmussen
Informacione të tjera:	www.daenemark.org

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni përfaqësues i Danimarkës në Këshillin e Bashkimit Evropian. Në këtë funksion, pas raundit të fundit të zgjerimit me dymbëdhjetë shtete të reja anëtare të Evropës Qendrore dhe Lindore, po përballeni me kërkesa të tjera anëtarësimi dhe duhet të vendosni në lidhje me to.

Danimarka në BE

Danimarka është një ndër shtetet anëtare të Bashkimit Evropian që i zbaton ligjet dhe rregullat në mënyrën më të shpejtë dhe të hapur krahasur me të tjerët. Ndërsa popullsia e mirëinformuar e këtij vendi vlerësohet si kritike, gjë që u bë e qartë në vitin 1992 kur Ratifikimi i Traktatit të Maastricht-it nuk u njoh në referendumin e organizuar për këtë qëllim dhe kjo bëri më pas që Traktati të hynte fuqi me një vit vonesë.

Në post-bisedime Danimarkës iu dhanë garancitë e mëposhtme:

- të mos bëhej pjesë e shkallës së tretë të Unionit Ekonomik dhe Monetar, pra nuk do të aplikonte Euron si monedhë (megjithëse i plotësonte kriteret), e megjithatë korona daneze përdoret e lidhur me euro-n.
- të hiqte dorë nga Politika Evropiane e Mbrojtjes (shembull BE Perëndimor);
- të refuzonte lëshime të tjera të sovranitetit në sektorët e drejtësisë dhe punëve të brendshme;
- të ishte në opozitë me qytetarinë e përbashkët të BE.

Pas këtyre përmirësimeve në vitin 1993 u bë i mundur miratimi i Traktati. Edhe sot shumë danezë kanë frikën e një përqendrimi shumë të fortë të pushtetit në duart e BE. Anketimet e herëpashershme tregojnë, se një pjesë e madhe e popullsisë daneze është e mendimit, që Parlamenti Evropian zotëron shumë pushtet. Në skepticizmin e pozicionimit të tyre danezët kalohen vetëm nga qëndrimi i popullsisë britanike.

Pas pranimi të Finlandës dhe Suedisë në vitin 1995 qeveria daneze ndihet e konsoliduar në angazhimin e vet për të kaluar në plan të parë të debatit evropian tematika të tilla si mbrojtja e mjedisit, transparenca, subsidiariteti dhe demokracia. Me një proces të ri votimi rreth vënies në përdorim të euros qeveria u përpoq të shfuqizonte statusin e veçantë danez duke argumentuar, që anëtarësimi në Euroland do të mund të mbronte mirëqenien dhe punësimin e shtetit danez në këtë epokë globalizimi. Por me JO-në e popullsisë në lidhje me vënien në përdorim të monedhës evropiane rruga e mëvetëshme daneze vetëm sa u përforcua edhe më tej.

Danimarka dhe zgjerimi

Danimarka e konsideron veten si ndër mbrojtësit më të flaktë të raundit të parë të zgjerimit në Lindje. Vendi e sheh si një prioritet të politikës së jashtme krijimin e një Evrope paqësore e të bashkuar si garant për stabilitetin dhe mirëqenien. Duke u nisur nga afërsia gjeografike dhe marrëdhëniet dypalëshe ekzistuese kjo mbretëri u angazhua në mënyrë të veçantë për pranimin e shpejtë të tre shteteve balltike. Bisedimet me dhjetë shtetet e reja anëtare u përmyllën në vitin 2002 nën presidencën daneze në BE.

Edhe në lidhje me raundin e ardhshëm të zgjerimit Danimarka bën pjesë në shtetet anëtare të hapura për këtë perspektivë, gjithsesi pa i mbështetur në mënyrë të verbër kërkesat për anëtarësim. Për shkak të pozicionit skeptik të popullsisë daneze qeverisë i duhet vazhdimisht të verifikojë, se deri në ç'masë mund të ruajë apo të mbështesë interesat e Danimarkës raundi i ardhshëm i zgjerimit. Në këtë kontakt arritjet në sektorin social dhe mbrojtjen e mjedisit, për të cilat Danimarka është shumë krenare, luajnë një rol të rëndësishëm. Danezët kanë frikë se mos ky „evropianizim“ në rritje do të shkojë në dëm të këtyre arritjeve. Zgjerimi i Bashkimit Evropian me shtete të reja anëtare nga Evropa Qendrore, Lindore dhe Juglindore për danimarkën është i lidhur ngushtë me kushtin për një kuadër të qartë rregullues lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe standardet sociale.

Edhe përse i përket dëshirës së Turqisë për tu anëtarësuar Danimarka tregohet qartësisht e gatshme për të negociuar. Sipas këndvështrimit të qeverisë daneze në një opsion afatgjatë anëtarësimi për Turqinë duhet të shprehet qartë se BE përcaktohet si një komunitet vlerash, i cili jeton në sajë të tolerimit të të ndryshmeve.

Qeveria daneze përshendet në mënyrë të jashtëzakonshme përpjekjet e Turqisë për normalizimin e çështjes qipriote. Vitet e fundit Turqia nuk e bllokoi më mundësinë e ribashkimit, përpjekje që gjithsesi dështoi në JO!-në e pjesës greke të popullsisë qipriote në referendumin e organizuar për këtë qëllim.

Qeveria daneze mbështet edhe Kosovën në rrugën e saj drejt një shteti funksional. Rezervat e pesë shteteve anëtare, që nuk e kanë njohur ende Kosovën, ajo nuk i pranon. Përkundrazi ajo sheh vështirësi të politikës së brendshme në këto vende, pasi këto kanë frikën e pretendimeve për pavarësi nga pakicat që jetojnë në to.

Gjithashtu Danimarka ka njohur që në fillim emrin kushtetues të Republikës së Maqedonisë dhe nxit edhe shtetet e tjera anëtare, edhe pse në një mënyrë të kujdeshme, të bëjnë të njëjtën gjë.

Ndërsa përse i përket Ballkanit Danimarka tregon më tepër kujdes për shkak të problemeve në lidhje me sigurinë dhe stabilitetin e këtij rajoni. Fillimisht duhet të

shkohet më tej sipas të gjitha mundësive me procesin e stabilizim asociimit, në mënyrë që në terma afatgjatë të krijohen kushtet për anëtarësimin.

Taktika:

Si përfaqësues/e i/e Danimarkës Ju mbështesni përgjithësisht pranimin e vendeve të tjera në BE. Në këtë kontekst ka qenë pozitiv fakti, që përfundimi historik i negociatave me dhjetë vendet e fundit të anëtarësuar në vitin 2004 është realizuar nën presidencën Tuaj. Në argumentimin Tuaj Ju u vini theksin – duke u nisur edhe nga popullsia Juaj skeptike - epërsive të shumëanshme të anëtarësimin për vendet që anëtarësohen, BE dhe në fund, por jo më pak e rëndësishme, edhe vetë Danimarkën. Demokratizimi paqësor, që synohet të arrihet përmes zgjerimit, do të thotë një avanazh shumë i madh për sigurinë dhe stabilitetin e të gjithë kontinentit.

Për Ju është e rëndësishme të nënvizoni faktin që siguria sot është shumë më tepër se thjeshtë shmangie lufte. Lufta kundër terrorizmit dhe krimit ndërkombëtar si dhe një mbrojtje efektive e mjedisit janë faktorë po aq të rëndësishëm për një siguri të përgjithshme. Ju jepni argumentin, që siguria në këtë kuptim do të ishte një detyrë mbikombëtare, që prek të gjithë Evropën, ndaj edhe ka nevojë për një zgjidhje të përbashkët në kuadrin e një BE të zgjeruar. Dhe së fundmi Ju i mëshoni idesë, që një treg i brendshëm më i madh do të mbartë avantazhe të reja ekonomike për tregtinë dhe investimet, duke ndikuar kështu pozitivisht edhe në ekonominë daneze. Por gjithsesi, vështroni në mënyrë kritike veçanërisht Shqipërinë, Kosovën dhe Malin e Zi, për shkak të ekzistencës së kriminalitetit atje. Ju u kërkon të gjitha shteteve, që janë të interesuar për anëtarësimin, të forcojnë angazhimin e tyre në këtë sektor.

Me gjithë theksin që i vini domosdoshmërisë së zgjerimit të BE, Ju mbani vazhdimisht parasysh faktin që procesi i integritimit evropian gjithsesi ka ca kufij dhe nuk duhet të shtërngohet. Edhe pozicionimi skeptik i popullsisë Suaj në vend nuk duhet t'Ju dalë krejtësisht nga mendja. Ndaj edhe punoni që zgjerimi i nevojshëm të realizohet me kujdes dhe në mënyrë graduale. Vendet që aspirojnë anëtarësimin duhet që para pranimin të kenë përmbushur me çdo kusht kriteret ekonomike, për të mos iu rënduar tregut të brendshëm të BE. Po kështu edhe standardet evropiano-perëndimore në lidhje me mjedisin dhe të drejtat e njeriut duhet të respektohen përpara anëtarësimin.

Me kolegët Tuaj të BE Ju ngulni këmbë në përcaktimin e kriterëve përse i përket mjedisit, sektorit social dhe atij të të drejtave të njeriut si parakusht i qartë për anëtarësimin. Përse i përket Turqisë Ju jeni i hapur për nisjen e bisedimeve. Në këtë kontekst ju e konsideroni të rëndësishëm faktin që BE nuk është një komunitet fetar, por në komunitet vlerash, themelet e të cilit i përbëjnë të qenët ndryshe dhe toleranca. Gjithsesi prioritet absolut ka respektimi i të drejtave të njeriut.

Në Ballkan BE duhet të vazhdojë të realizojë në mënyrë aktive politikën e tij të stabilizimit dhe asociimit. Këtu Ju shihni një mundësi të mirë që në një perspektivë afatgjatë të krijohen kushtet për anëtarësimin e rajonit. Anëtarësimin e shteteve të Ballkanit në një të ardhme të afërt e konsideroni jorealiste. Janë veçanërisht shtetet e Ballkanit Perëndimor (Kroacia dhe Serbia) që përmes mungesës së bashkëpunimit të vendeve të tyre me Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës janë përë pengesë për nisjen e bisedimeve të anëtarësimin, pasi kjo do të sillte rrënimin e kredibilitetit të BE në çështje të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe shtetit ligjor. Dhe në përfundim nuk duhet të harroni, si vend kontribues i rëndësishëm brenda BE, që anëtarësimet e reja lidhen edhe me barra të caktuara financiare.

Greqia (Ελλάδα) [Hellas]

Kryeqyteti:	Athina (rreth 4 mil banorë) (të gjitha shifrat të 2004)
Forma shtetërore:	demokraci parlamentare, sistem me nje Dhomë
Sipërfaqja:	131.957 km ²
Nr.i banorëve:	11.147 Mio.
PBB/banor:	27.390 US-Dollar
Rritja ekonomike:	4,3%
Papunësia:	8,3%
Gjuhët:	Greqishtja e re
Besimet fetare:	Greko-ortodokse kisha e shtetit, si dhe muslimanë (ca. 130.000), katolikë dhe protestantë (bashkë rreth 50.000) dhe hebrenj (6.500)
Grupe etnike:	98 % grekë
Anëtar i Kom.Evr./BE:	1981
Krytar shteti:	Karlos Papoulias
Kryetar qeverie:	Kostas Karamanilis
Informacione të tjera:	www.griechenland-botschaft.de

www.weltalmanach.de (2008)

Ju jeni përfaqësues/e i/e Greqisë në Këshillin e Bashkimit Evropian. Në këtë funksion përballeni sërish me vendimmarrjen për kërkesa të tjera anëtarësimi në BE .

Greqia në BE

Që prej vitit 1974, pas një periudhe të shkurtër diktature ushtarake të djathtë, në Greqi u ngrit sërish rendi kushtetues demokratik, dhe në vitin 1981 ajo u bë anëtare e Komunitetit Evropian. Që prej asaj kohe Greqia ka përfituar nga asistenca në struktura nga xhepat evropiane duke u zhvilluar kështu në një demokraci shumë të qëndrueshme në kufirin juglindor të BE-së.

Edhe pse sistemi politik i Greqisë parashikon ndarjen e kishës nga shteti, popullsia e Greqisë është e ndikuar shumë fuqishëm nga Kisha Ortodokse tejet e përhapur dhe me ndikim shumë të madh.

Si një vend relativisht i varfër Greqia ka përfituar shumë nga pranimi në BE dhe në të kanë rrjedhur ndihma të shumta financiare nga fodi i BE-së për strukturat. Edhe sot asistenca e BE-së përbën rreth 3,3 përqind të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Përmes një politike konsekuente reformash të ndërmarra nga qeveria greke ekonomia e vendit mundi të shënonte kohët e fundit disa hapa të rëndësishëm përpara. Si treguesit e inflacionit ashtu edhe deficitit buxhetor pësuan një rënie drastike. Megjithatë ekonomia e Greqisë vazhdon të jetë një ekonomi e prapambetur, madje për nga statistikat për të ardhurat për frymë të popullsisë është kaluar edhe nga një anëtar i ri i BE-së, Sllovenia.

Për shkak të kufijve të saj të hapur në det në drejtim të Afrikës së Veriut dhe si porta e BE-së Greqia ka qenë shpesh destinacion i shumë refugjatëve nga Afrika dhe Azia Qendrore. Për këtë arsye Greqia mbështet një politikë më strikte për çështjet e azilit brenda BE-së dhe angazhohet për një partneritet të fuqishëm të BE-së me shtetet kufizuese të Mesdheut (Procesi i Barcelonës).

Në pikëpamje institucionale Greqia mbështet thellimin e njëtrajtshëm të BE-së dhe refuzon një „Evropë të shpejtësive të ndryshme“, e cila do të sillte një përçarje të Unionit. Edhe pse Greqia i është përmbajtur për një kohë të gjatë klauzolës së unnimitetit, ajo ra dakord me Marrëveshjen mbi Kushtetutën, e cila në shumë fusha parashikon vendimmarrjen me shumicë të cilësuar dhe bën të mundur që në çështje politike Greqia të anashkalohej. Por në çështje të zgjerimit vazhdon të vlejë parimi i rëndësishëm i unanimitetit.

Më tej Greqia deklarohet për konsolidimin afatgjatë të Politikave të Përvashkëta në Punët e Jashtme dhe Çështjet e Sigurisë. Greqia ka marrë pjesë shumë aktive në stabilizimin e Ballkanit si dhe ka iniciuar krijimin e „Brigade shumëkombëshe në Evropën Juglindore“.

Greqia dhe zgjerimi i ardhshëm

Kushtëzuar nga pozita e saj gjeografike Greqia është i vetmi shtet anëtar i BE-së me kufij dhe marrëdhënie të përbashkëta me rajonin evropiano-turk dhe atë mesdhetar si dhe me shtetet e Evropës Juglindore. Në këtë mënyrë Greqia është drejtpërsëdrejti e prekur si nga çështja e zgjerimit me shtete të Evropës Juglindore dhe Turqisë ashtu edhe nga politika e ardhshme evropiane përkundrejt rajonit të Detit Mesdhe.

Raporti i Greqisë me fqinjët e saj të drejtpërdrejtë ka qenë historikisht shumë i ngarkuar me konflikte. Por në fund të viteve nëntëdhjetë këto raporte janë çtensionuar dhe zhvilluar në mënyrë miqësore. Kështu ndodhi edhe me shtetin e ri, Maqedoninë, me të cilin Greqia ka patur për një kohë të gjatë kontradikta për shkak të pretendimeve territoriale dhe emërimit zyrtar të Maqedonisë.

E hapur mbetet edhe zgjidhja e çështjes së ishullit të Qipros, i cili që prej vitit 1974 është ndarë në një pjesë turke dhe në një greke. Të dy qeveritë janë shprehur për zgjidhjen e statusit të ishullit në kuadër të një Plani Bashkimi të Kofi Annan, i cili dështoi me referendumin e qipriotëve grekë të vitit 2004. Sot është anëtare e BE-së vetëm pjesa greke e Qipros. E megjithatë Grekët në parim nuk janë kundër anëtarësimit të Turqisë në BE, pasi Greqia shpreson që me këtë të arrihet stabilizimi i marrëdhënieve të tyre, sikurse u tregon edhe historia. Me anëtarësimin mund të zgjidhen edhe çështjet e të drejtave të diskutueshme në Egje dhe konflikti mbi Qipron. Gjithsesi si kusht bazë për fillimin e bisedimeve të anëtarësimit Greqia vendos njohjen e pjesës greke të Qipros nga Turqia si shtet më vete.

E paqartë është gjithashtu edhe çështja e debatit mbi emrin e Maqedonisë. Greqia pretendon që Maqedonia të ndryshojë emrin e vet kushtetues „Republika e Maqedonisë“. Në kuadër të Kombeve të Bashkuara, për shkak të ndërhyrjes së këtyre të fundit, Maqedonia duhet të quhet „Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë“. Greqia argumenton duke thënë se *Makedonia* (greqisht Μακεδονία, *Makedonía*) është një emër me origjinë greke, që përdoret edhe sot për një zonë greke të veriut të Greqisë dhe për rajonin historik të Maqedonisë. Fiset sllave kanë ardhur në rajonin e Ballkanit vetëm në Mesjetën e hershme (nga Shek. VI pas Krishtit) – dhe banorët e ish Republikës së pjeshme Jugosllave të Maqedonisë janë sllavë. Veç kësaj terrioi shtetëror i ish Republikës së

pjesshme Jugollave në pjesën më të madhe të tij përfshin një zonë, që nuk i përket zonës fillestare historike të Maqedonisë. Në antikitet këtë zonë, ku sot ndodhet edhe kryeqyteti i Shkupit, e kanë quajtur Paionia. Pra përdorimi i emrit *Maqedoni* do të thotë përvetësim i historisë dhe kulturës së një vendi të huaj. Kjo, sipas Greqisë bëhet për motive politike, për tu kufizuar nga vendet fqinje dhe për tu afruar edhe me shume me bullgarët miq, në mënyrë që të mund të argumentohet një ndjenjë kombëtare identitet-krijuese, që duhet të jetë edhe bazë për ekzistencën e një shteti të ri. Krahas kësaj në rastin e kësaj ish Republike Jugosllave bëhet fjalë për një shtet shumëetnik (mes të tjerësh 25 % shqiptarë, 4 % turq, 3 % romë, 2 % serbë), për të cilët duhet të garantohet njësimi territorial. Një arsye tjetër për mungesën e të drejtës nga pikëpamja historike për të mbajtur një emër që i referohet maqedonasve antikë dhe shtetit të tyre qëndron në pretendimin për t'i trajtuar grupet sllave të popullsisë me përparësi politike kundrejt grupeve të tjera etnike, që për nga pikëpamja historike, sipas Greqisë, duhet argumentuar në këtë mënyrë:

Banorët sllavë të rajonit në shekujt e shkuar e kanë cilësuar veten gjithmonë si bullgarë. Kjo situatë ndryshoi me urdhrin e Titos, që rajonit më jugor të Jugosllavisë, dikur i quajtur Vardar-ban, i dha emrin zyrtar *Vardar-Maqedoni*. Në këtë mënyrë do të mund të ktheheshin mbrapsht pretendimet territoriale bullgare mbi Jugosllavinë e jugut dhe në të njëjtën kohë do të mbështeteshin pretendimet territoriale jugosllave mbi Greqinë e Veriut. Pë këtë qëllim banorëve të provincës më jugore të Jugosllavisë do t'u jepej një orientim i ri kombëtar. Gjuha e shumicës sllave të popullsisë, baza e ekzistencës së një populli, dhe që ishte jashtëzakonisht e ngjashme me bullgarishten, do të ndryshonte emrin duke u quajtur *maqedonisht*. Krahas kësaj kish nisur edhe një fushatë falsifikimi e historisë sipas modelit komunist. Kjo histori e falsifikuar nisi të mësohej në shkolla, dhe pati pasojën, sipas Greqisë, që banorët e sotëm me origjinë sllave të kenë një ide të gabuar për historinë e tyre.

Greqia është kundër emrit *Republika e Maqedonisë*, pasi ka frikë nga pretendime të mundshme territoriale maqedonase ndaj rajonit me të njëjtin emër të Veriut të Greqisë Makedonia – një frikë kjo që argumentohet me faktin që edhe bullgarët me origjinë sllave në periudhën 1941-1945 nën qeverinë fashiste kishin pushtuar zonën lindore të Makedonia-s. Në fakt Greqia për momentin nuk ka përse të ketë frikë ushtarakisht nga Maqedonia, por përmes ndikimeve propagandiste në popullsinë greke të Makedonia-s si dhe përmes interesash eventualisht të përbashkëta mes Maqedonisë dhe Turqisë politika e Maqedonisë mund të përbëjë rrezik për Greqinë.

Duke qenë se popullsia greke e Makedonias e ka quajtur veten maqedonase që në kohët e lashtësisë, pra përpara sllavëve, tani ky emër nuk mund të merret e të përdoret papritur prej një kombi të sapkrijuar, dhe nuk mjafton kjo, por edhe pa asnjë bazë historike, etnike apo gjuhësore.

Pala greke pohon që ajo nuk është kundër ekzistencës së shtetit të ri, por vetëm kundër emrit, që ky shtet pretendon të mbajë për vete dhe banorët e tij. Në thelb Greqia është e interesuar të ketë marrëdhënie të mira fqinjësie si dhe është e gatshme ta mëshesë shtetin e ri politikisht dhe ekonomikisht.

Greqia bën pjesë në pesë shtetet e Bashkimit Evropian, që nuk e kanë njohur Kosovën (bashkë me Spanjën, Qipron, Rumaninë dhe Sllovakinë). Një arsye mendohet të jetë, që Greqia nuk dëshiron që minoritetet që jetojnë në territorin grek të nxiten të kërkojnë pavarësinë, që në këndvështrimin e Greqisë do të ishte tejet e pabazë.

Taktika:

Si përfaqësues i Greqisë Ju keni marrëdhënie tradicionalisht të mira me shtetet e tjera të Evropës Jugore, si Italia, Spanja dhe Portugalia, me të cilat përfaqësoni interesa të përbashkëta. Edhe me shtete të tjera të mëdha, veçanërisht me Gjermaninë, vendi Juaj ka marrëdhënie të thella dhe miqësore.

Mbani parasysh që vendimet për anëtarësimet e mundshme në Këshill duhet të merren në mënyrë unanime. Ndaj përpiquni, edhe duke qenë offensiv, që të realizoni interesat Tuaja. Në rastin e bisedimeve të anëtarësimit vini theksin mbi potencialet pozitive që duhet të sjellë anëtarësimi i shteteve candidate. Dëshmoni që vitet e fundit janë shënuar zhvillime shumë të mira, e, që përmes anëtarësimit të Krocisë rajoni i Ballkanit do të mund të kapërcente pasojat e luftës civile dhe të varfërisë së kohëve të shkuara. Për stabilitetin e rajonit është jashtëzakonisht e rëndësishme edhe një Turqi demokratike. Për këtë arsye shprehuni pro pranimin të Turqisë në BE. Por si kusht për miratimin Tuaj kërkoni që Turqia të njohë pjesën greke të Qipros si shtet më vete. Pastaj Ju mund të pranoni edhe njohje faktike nepërmjet shtrirjes së Unionit Doganor mes BE-së dhe Turqisë mbi shtetet e reja anëtare. Në gjykimin Tuaj, për pranimin përfundimtar duhet të jenë të vlefshme rregulla të ndershme dhe të njëjta, që në rast mungesash në zbatimin e reformave nuk përjashtojnë kritikën (për shembull në fushat e lirisë së mediave, të shtetit ligjor dhe respektimit të të drejtave të njeriut). Këto çështje nuk janë vetëm në interes të Greqisë por të të gjithë BE-së.

Hapat e ardhshme të zgjerimit do të ishin shumë të dobishme edhe në pikëpamjen ekonomike. Gjithsesi projektet strukturore për zhvillimin e zonave rurale të shteteve aktuale të BE-së nuk duhen shkurtuar pasi përndryshe mund të lindin probleme ekonomike. Për këtë arsye Ju kërkoni vendosjen e afateve tranzitive.

Por zgjerimi ka nevojë edhe për thellim, në mënyrë që vendimmarrja brenda BE-së të mund të funksionojë edhe me më shumë anëtarë. Kjo është arsyeja që Ju mbështesni idenë e konsolidimit të kompetencave të institucioneve të BE-së si Parlamenti dhe Komisioni.

Spanja (España)

Kryeqyteti:	Madrid (3 mil banore) (shifrat për 2003)
Forma shtetërore:	monrki parlamentare, shtet njësi
Sipërfaqja:	504.656 km ²
Nr. i banorëve:	44.121 Mio.
PBB /banor:	27.340 US-Dollar
Rritja e konomike:	3,9 %
Papunësia:	8,3%
Gjuhët:	spanjisht (Castellano) gjuha e njohur me kushtetutë. Krahas saj: katalanishte, baske, galiciane dhe valenciane kanë rang zyrtar në komunitetin e pavarur përkatës
Besime fetare:	Romak-katolikë më shumë se 90%
Anëtar i Kom.Evr./BE:	1986
Kryetar shteti:	Mbreti Juan Carlo s I. de Burbon y Burbon
Kryetar qeverie:	Jose Luis Rodriguez Zapatero
Informacione të tjera:	www.spanischebotschaft.de

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni përfaqësues/e i/e Spanjës në Këshillin e Bashkimit Evropian. Në këtë funksion menjëherë pas pranimit të dymbëdhjetë shteteve të reja anëtare nga Evropa qendrore dhe Lindore Ju përballeni sërish me vendimmarrjen për kërkesa të tjera anëtarësimi.

Spanja në BE

Spanja është anëtarësuar në Komunitetin Evropian në vitin 1986. Që atëherë Spanja ka patur një hov të madh në zhvillimin ekonomik. Megjithë një mjedis kritik në nivel të ekonomisë botërore ekonomia e Spanjës ka shënuar vlera relativisht të larta rritjeje. Në fakt që prej vitit 1994 shifrat e papunësisë janë përgjysmuar. Ka ende rajone të pazhvilluara ekonomikisht, por në sajë të një niveli relativisht të ulët pagash Spanja është shndërruar në një vend prodhim të rëndësishëm për Evropën. Por megjithatë interesi i popullsisë spanjolle për BE-në është i vogël.

Përmes zgjerimit në drejtim të veriut relizuar më 1995 dhe zgjerimit të fundit nga lindja më 2004 ndikimi i shteteve të jugut brenda Bashkimit Evropian është reduktuar. Qeveria spanjolle dhe popullsia kanë frikë, që së bashku me shtetet e tjera „të vjetra“ evropiane pranë Mesdheut, do të zhvendosen në periferi të Bashimit Evropian jo vetëm gjeografikisht por edhe politikisht.

Si një shtet në kufi të rajonit të Mesdheut Spanja e konsideron si një detyrë të veçantë përforcimin e politikës evropiane për Mesdheun, që rregullon bashkëpunimin me vendet fqinje jugore të Bashkimit Evropian. Kështu për shembull duhet përforcuar mbështetja financiare e rajonit dhe bashkëpunimi ekonomik si dhe duhet intensifikuar dialogu politik dhe ekonomik me shtetet e Lindjes së Afërt. Spanja i vlerëson problemet në rritje në „kufirin jugor“ të BE-së (p.sh. presionin e emigracionit nga Afrika e Jugut,

fundamentalizmin islamik) si tejet rënduese për interesat e veta kombëtare, madje shumë më tepër se çështja e një zgjerimi të mëtejshëm të Bashkimit Evropian.

Lidhur me reformat eventuale institucionale brenda BE-së Spanja nuk e pranon modelin e një bashkëpunimi më të ngushtë mes një numri të caktuar shtetesh anëtare. Pëkundrazi integrimi duhet të konsolidohet në një nivel të njësuar. Qeveria spanjolle është e pikëpamjes, që rregulli i unanimitetit duhet të ruhet, nëse preken interesat kombëtare.

Spanja dhe zgjerimi i ardhshëm

Duke patur parasysh vendosjen e mëspiërme të prioriteteve nga qeveria spanjolle, atëherë zgjerimi do të jetë i mundshëm vetëm pasi të jetë arritur thellimi faktik dhe të jenë zgjidhur problemet që lidhen me zgjerimin:

Me pranimin e realizuar së fundmi të dhjetë shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe me shkurtimet e subvencioneve për Spanjën, masë që shoqëroi këto pranime, vendi e sheh veten përpara një sfide të re: lufta për shpërndarjen e fondeve të BE-së për periudhën 2007 deri 2013. Spanja po sheh para së gjithash rrezikun, që përmes një zgjerimi të ri të BE-së në Spanjë nuk do të futen më aq shumë transfertat financiare sa deri më tani, pasi për këto fonde do të konkurrojnë më shumë vende „më të varfra“ se Spanja. Veç kësaj Spanja ka frikë, që në rast anëtarësim të vendeve të tjera do të humbasë avantazhin e derimëtanshëm të kostove në prodhim, pasi në vendet kandidate potenciale mund të prodhohet edhe më lirë se në Spanjë.

Pas atentateve të 11 marsit 2004 lufta kundër terrorizmit në Spanjë ka një prioritet veçanërisht të lartë. Pranimi i shteteve me ndjeshmëri të diskutueshme ndaj çështjeve të sigurisë dhe me kufij të jashtëm të çarë mund të jetë një „portë hyrjeje“ për grupet terroriste. Afrimi gjeografik me vatrat e krizave në Lindjen e Afërt, pikërisht duke patur Turqinë në kufi me Irakun, do të fshihte gjithashtu një rrezik të ngjashëm. Spanja ka frikë, që problemet e sigurisë së anëtarëve të rinj do t'i kalojnë BE-së.

Megjithë rezervat që ka, pranimi i Kroacisë dhe i Turqisë në BE është natyrisht edhe në interes të Spanjës, pasi në këtë mënyrë mendohet të forcohet pozicioni i shteteve anëtare të jugut. Spanja shpreh në fakt disa rezerva (shih më lart), por në fund të fundit mbështet kandidatët, nëse këta deklarohen të gatshëm për tu kushtuar vëmendje të veçantë këtyre problemeve në vitet e adhsme.

Zhvillimet dhe çështja e pavarësisë së Kosovës shihen nga Spanja me shqetësim të madh. Spanja, ndryshe nga Franca dhe Gjermania, nuk e ka mbështetur për asnjë moment shkëputjen e Kosovës nga lidhje serbe e shteteve. Ajo, së bashku me Greqinë, Qipron, Rumaninë dhe Sllovakinë nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Por në të njëjtën kohë këto shtete kontribuojnë në kuadër të BE-së në misionin EULEX, i cili mendohet të mbështesë ndërtimin e shtetit ligjor në Kosovë.

Pozicionin e tyre e shpjegojnë duke thënë, se ato mund të pranojnë pavarësinë e Kosovës vetëm nëse kjo pranohet edhe nga Serbia. Por ato nuk njohin një pavarësi të shpallur në mënyrë të njëanshme.

Kështu zotëron shqetësimi se me njohjen e Kosovës do t'i duhet të përballen me kërkesa separatiste në vend. Ndaj Spanja kërkon shprehimisht përforcimin e Serbisë, në mënyrë që të mundësohet një qasje më e mirë me njëri-tjetrin. Për Spanjën vazhdon të ketë vlerë rezoluta 1244 e Kombeve të Bashkuara.

Taktika:

Ju përfaqësoni mendimin zyrtar, se bisedimet e anëtarësimit mund të happen me të gjitha shtetet, edhe pse nuk jeni vërtetë i interesuar për pranimin e shteteve të tjera. Por miratimin Tuaj Ju e lidhni me kërkesën, që asnjë zgjerim i mundshëm nuk duhet t'ju sjellë dizavantazhe anëtarëve aktualë të Bashkimit Evropian.

Si marrësi (ende) më i madh i subvencioneve financiare të BE-së Ju jeni tanimë i vetëdijshëm që arsytet për subvencionimin e mjeteve financiare pjesërisht nuk vlejnë më dhe në të ardhmen do të vazhdojnë të bien, duke qenë se Spanja falë ndihmës financiare të BE-së ka mundur të shpalojë një rritje masive ekonomike. Për këtë arsye Ju mbron idenë e afateve të gjata tranzitive, përpara se shtete të reja anëtare të përfitojnë në masë të plotë nga Politika e Përbashkët Agrare dhe nga Fondet e BE-së për Strukturat. Lidhja dhe mbështetja e fortë ekonomike dhe sociale brenda BE-së së „vjetër“ nuk duhet të vihet në rrezik.

Por në mënyrë që, me gjithë keto, të mund të pranohen anëtarë të tjerë, duhen krijuar fonde të reja dhe buxheti i BE-së duhet të rritet. Dhe në këtë pikë Ju kërkon një pjesëmarrje më të gjerë të vendeve më të mëdha e më të pasura, anëtare të BE-së.

Miratimin Tuaj për zgjerimin Ju e kushtëzoni me reforma të suksesshme institucionale, që marrin në konsideratë në masën e duhur shtetet me madhësi mesatare në aparatën evropian vendimmarrës. Mundohuni të zbuloni, nëse edhe shtete të tjera me madhësi të krahasueshme me Tuajën (p.sh. Polonia) kanë interesa të ngjashme me Ju, që do të mund t'ju përfaqësonit bashkarisht.

Në mbyllje Ju kërkon një rritje të konsiderueshme të fondeve për një intensifikim të politikës evropiane për rajonin e Mesdheut. Është një interes bazë i Juaji që ky dimension i politikës evropiane të mos dalë në plan të dytë për shkak të përqendrimit në kufirin e Lindjes. Shtete, që mund të kenë të njëjtin shqetësim me Tuajin, mund t'ju kërkon mes shteteve të tjera anëtare të BE në rajonin e Mesdheut.

Në të gjitha këto Ju nuk duhet të harroni varësinë Tuaj nga financat mbështetëse të BE-së dhe nuk duhet ta zhysni vërtetë procesin e pranimit të shteteve të reja anëtare.

Për Ju është e rëndësishme të mundësohet një balancim mes Kosovës dhe Serbisë. Përpiquni të shtyni Serbinë të bëjë lëshime në lidhje me Kosovën, në mënyrë mundësisht të arrihet njohja e pavarësisë. Një mjet i mundshëm do të ishte ofrimi i perspektivës së një anëtarësimi të shpejtë të Serbisë në BE. Por gjithsesi Serbia duhet që paraprakisht të përmbushë kriteret e rrepta të pranimit.

FINLANDA (SUOMI)

Kryeqyteti:	Helsinki (559.330 banorë) (shifra të 2003)
Forma shtetërore:	Republikë, Shtet
Sipërfaqja:	338.144 km ²
Nr. i banorëve:	5.266 Mil.
PBB / Banor:	41.360 US-Dollar
Rritja ekonomike:	5,5 %
Papunësia:	6,9 %
Gjuhët e folura:	92 % finlandisht, 6 % suedisht, 2 % të tjera (rusisht, saamisht)
Grupe etnike:	2 % rusë, estonezë dhe suedezë
Besime fetare:	Të krishterë sipas Lutherit 84,2%, të krishterë greko-ortodoksë 1,1 %, të tjerë dhe pa fe 14,7 %
Anëtar i Kom.Evr./BE:	1995
Kryetare shteti:	Tarja Halonen
Kryetar Qeverie:	Matti Vanhanen
Informacione të tjera:	www.finland.de

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni përfaqësues i Finlandës. Vendi Juaj është anëtar i BE që prej vitit 1995 dhe ka marrë pjesë tashmë në raundin e fundtit të bisedimeve të anëtarësimit. Dhe tani ndodheni përballë kërkesave të tjera të anëtarësimit nga vende të Evropës lindore dhe Juglindore dhe duhet të vendosni në lidhje me to.

Finlanda në BE

Finlanda ka mundur të grumbullojë përvojë në lidhje me realizimin e politikave të përbashkëta përtej kufijve të saj që prej vitit 1955. Së bashku me katër shtetet e tjera të Evropës së Veriut (Danimarkën, Islandën, Norvegjinë dhe Suedinë) ofron në kuadër të Këshillit të Veriut një hapësirë të madhe, ku p.sh tregu i punës dhe sigurimet shoqërore mund të rregullohen në mënyrë të përbashkët.

Pas një periudhe të gjatë kohe në pozicion asnjënjës Finlanda ka marrë përsipër detyrimet përkatëse me NATO-n që prej anëtarësimit të saj në vitin 1994 në Programin e NATO-s „Partneriteti për Paqe“. Më 1995 vijoi anëtarësimi në Bashkimin Evropian, i cili në radhë të parë motivohej nga solidariteti dhe siguria e përbashkët, që ofron BE. Brenda Bashkimit Evropian Finlanda angazhohet për të garantuar në mënyrën më efikase të mundshme mirëqenien dhe sigurinë në Evropë. Që prej anëtarësimit të vet ky vend kërkon të jetë sa më afër grupit të vendeve, që përbën thelbin e Unionit, dhe ngulmon në përmirësimin e efikasitetit dhe të aftësisë operationale të BE-së. Më 1999 Finlanda është bashkuar me shkallën e tretë të Bashkimit Monetar dhe Ekonomik, si vendi i vetëm nordik, dhe ka futur në përdorim euron. Megjithëse vendi vazhdon të jetë për lirinë nga

aleancat ushtarake, ai mbështet me forcë konsolidimin e Politikës së Përbashkët në Punët e Jashtme dhe Çështje të Sigurisë dhe aftësisë së BE për menaxhimin e krizave.

Prioriteti më i lartë për Finlandën është bashkëpunimi rajonal në të gjithë hapësirën e Detit Balltik edhe përtej kufijve të BE-së. E një rëndësie bazë për qeverinë finlandeze është në mënyrë të veçantë raporti i mirë me vendin fqinj Rusinë, jo vetëm se të dy ekonomitë kombëtare janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe Finlanda varet nga importet ruse të energjisë, por edhe për shkak të rrethanave të tyre historike dhe gjeografike. Kështu Finlanda është shteti i parë perëndimor që në vitin 1992 lidhi një marrëveshje me Rusinë për zgjerimin e marrëdhënieve të tyre. Me mbarimin e konfliktit mes Lindjes dhe Perëndimit Finlanda është shndërruar gjithnjë e më tepër në një stacion lindje-perëndim për tregtinë mes Bashkimit Evropian, Rosisë dhe Evropës Lindore.

Më iniciativë të Finlandës Bashkimi Evropian zhvilloi në vitin 1997 një „dimension nordik“ të politikës së vet, që synon të mbështesë bashkëpunimin me Rusinë dhe me partnerë të tjerë në fushën e menaxhimit të ekonomisë kombëtare, politikave të energjisë, mbrojtjes e mjedisit dhe sektorë të tjerë në rajon. Me këtë hap Rajoni i Detit Balltik ngrihet në të njëjtën vlerë sikurse rajoni i Mesdheut Evropian. Finlanda vazhdon edhe sot të bëjë pjesë në mbrojtësit më aktivë të zgjerimit të mëtejshëm të politikës rajonale dhe sheh në Dimensionin Nordik një garant për sigurinë e vet.

Finlanda dhe zgjerimi i ardhshëm

Për shkak të marrëdhënieve të saj të ngushta politike dhe ekonomike me shtetet balltike dhe shtete të tjera të Evropës Lindore Finlanda ka qenë një mbështetëse aktive e fazës së parë të zgjerimit në drejtim të Lindjes. Me realizimin e këtij rasti zgjerimi në datën 1 maj 2004 u përmbush një objektiv i rëndësishëm finlandez. Ky vend e vlerëson në mënyrë veçanërisht pozitive faktin, që me anëtarësimin e shteteve balltike Dimensionin Nordik u përforcua ndjeshëm, pasi pas kësaj numri i shteteve nordike anëtare të BE-së u trefishua. Brenda BE-së së zgjeruar Finlanda së bashku me fqinjët e saj nordikë këmbëngul për një perceptim më të fuqishëm (financiar) të kësaj zone politike.

Duke patur parasysh shtetet, që qëndrojnë ende jashtë Bashkimit Evropian, Finlanda do të jetë edhe në të ardhmen kundër mbylljes dhe kufizimit të BE vetëm në tregjet evropiane; ajo përkundrazi do të mbështesë të gjitha masat për hapjen e tregjeve botërore. Krahas kësaj ky vend mbështet zgjerimin e mëtejshëm të Unionit, pasi kjo shihet si një garanci elementare për stabilitetin dhe sigurinë e gjithë Evropës, veçanërisht Finlandës. Përfshirja e vendeve të tjera në tregun e brendshëm konsiderohet edhe nga pikëpamja ekonomike si një avantazh i madh.

Por gjithsesi një zgjerim i tillë i nevojshëm në vlerësimin e Finlandës nuk mund të ndodhë me çdo kusht, pasi në asnjë rast ai nuk duhet të dëmtojë aftësinë vendimmarrëse dhe efikasitetin e institucioneve evropiane.

Megjithatë Finlanda fton të hedhim vështrimin përtej zgjerimit të ardhshëm. Anëtarësimi i shteteve të reja anëtare do ta sjellë BE-në më pranë kufijve të rajoneve jo të qëndrueshme si Bjellorusia, Moldavia dhe Kaukazi, që do të thotë sfida të mëdha në drejtim të mbrojtjes së kufijve, sigurisë dhe ndihmës për zhvillim. BE duhet t'u bëjë ballë këtyre sfidave duke konceptuar edhe më tej një politikë efektive fqinjësie me këto rajone dhe duke mbështetur vendet në transformim përtej kufijve të saj.

Atmosfera në popullsinë finlandeze lidhur me çështje të zgjerimit është në përgjithësi pozitive, e megjithatë qeveria duhet të mbajë në konsideratë shqetësimet lidhur me

prurje më të fuqishme emigrantësh nga vendet e reja nëtare në kuadër të lëvizjes së lirë të punëmarrësve.

Taktika:

Për arsye gjeografike, politike dhe ekonomike Ju angazhoheni që në BE të pranohen edhe vende të tjera, por miratimin Tuaj e lidhni me kushte të caktuara që u adresohen si Bashkimit Evropian aktual ashtu edhe vendeve kandidate për anëtarësim.

Brenda BE-së Ju theksoni me forcë që përpara pranimeve të reja aparati insitucional të jetë reformuar deri në atë masë që pranimi i anëtarëve të rinj të mos ndikojë negativisht në transparencën dhe aftësinë operacionale në nivel të Bashkimit Evropian. Në këtë kontekst Ju mbështesni idenë për një ratifikim të shpejtë të Marrëveshjes mbi reformat dhe zbatimin e tyre. Një çështje tjetër e rëndësishme për Ju është zgjerimi i Dimensionit Nordik të politikës evropiane veçanërisht në pikëpamje financiare. Përpiquni që nga partnerët Tuaj brenda BE-së të merrni premtimin që mjetet financiare për këtë sektor të politikës do të shtohen ose të paktën nuk do të reduktohen. Argumentoni në këtë kontekst që ky lloj bashkëpunimi rajonal, dhe veçanërisht një raport i ngushtë me Rusinë është me rëndësi strategjike dhe me relevancë për sigurinë në Evropë.

Me qëllim mbrojtjen e tregut vendas të punës dhe qetësimin e popullsisë Suaj përpiquni në mënyrë të veçantë për vendosjen e një afati kalimtar në sektorin e lëvizjes së lirë për qëllime punësimi.

Duke i vënë theksin respektimit të kriterëve përcaktoni pozicionin Tuaj përkundrejt anëtarësimt të të gjitha shteteve të interesuara. Bëni të qartë që marrëdhëniet e ngushta mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor janë me rëndësi bazë për zhvillimin e mëtejshëm të rajonit. Në vlerësimin Tuaj brenda dhjetë deri pesëmbëdhjetë viteve të ardhshme në BE do të jenë anëtarësuar të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor ose do të jenë duke negociuar rreth anëtarësimit të tyre. Kjo gjithsesi mund të realizohet vetëm mbi bazën e plotësimit të kriterëve, që momentalisht ende nuk janë përmbushur nga Kroacia. Ju ndani të njëjtin gjykim me Gjykatën Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në çështje të ish-Jugosllavisë që Kroacia nuk është duke bashkëpunuar mjaftueshëm me këtë Gjykatë pasi nuk dorëzon kriminelët e kërkuar të luftës.

Përkundrejt të gjithë mbështetësve të anëtarësimit Ju argumentoni me forcë që BE do të humbiste gjithë besueshmërinë lidhur me të drejtat e njeriut dhe shtetin ligjor, nëse do të bënte lëshime në këtë pikë.

Përsa i përket Turqisë Ju mbështesni hapjen e bisedimeve të anëtarësimit sapo paketa e reformave, kërkuar prej saj nga Komisioni, të realizohet në mënyrë të kënaqëshme. Dhe në fakt Ju nuk e shihni Turqinë shumë larg pjekurisë së saj faktike për anëtarësim.

Franca (France)

Kryeqyteti:	Paris (2,1 Mil. banorë) (shifra të 2004)
Forma shtetërore:	Demokraci presidialo-parlamentare me dy dhoma
Sipërfaqja:	543.965 km ²
Nr. i popullsisë:	61,257 Mio.
PBB / banor:	36.500 US-Dollar
Rritja ekonomike:	2,0 %
Papunësia:	8,3%
Gjuhët:	Frëngjisht
Besimet fetare:	romako-katolikë 82 %, muslimanë 4-5 mil; protestantë 0,8 mil; Hebrenj 0,7 mil.
Anëtar i Kom.Evr./BE:	Anëtar themelimi
Kryetar i shtetit:	Nicolas Sarkozy
Kryetar qeverie:	Francois Fillon
Informacione të tjera:	www.französische-botschaft.de

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni pëfaqësues i Francës në Këshillin e Bashkimit Evropian. Në këtë funksion, pak pas zgjerimit me gjithsej dymbëdhjetë shtete të reja anëtare nga Evropa Qendrore dhe Lindore, po gjendeni sërish përballë vendimmarrjes për të pranuar ose jo kërkesa të tjera për anëtarësim.

Franca në BE

Franca bën pjesë në bashkëthemeluesit e integritit evropian, në kuadër të të cilit kapërcimi i amiqësisë disa vjeçare me vendin fqinjë Gjermaninë dhe ndërtimi i një marrëdhënieje mirëbesimi mes dy vendeve ka qenë gjithmonë një ndër forcat lëvizëse të procesit të integritit evropian. Që nga themelimi i Komunitetit Evropian për Qymyrin dhe Çelikut në vitin 1952 deri më sot pothuaj të gjitha hapat më vendimtare të integritit e kanë bazën në unitetin e motorit gjermano-francez. Kështu Franca e ka çuar përpara gjithmonë në mënyrë aktive zhvillimin e BE-së por ka qenë e prirur që strukturën institucionale që po krijohet ta formësonte sipas ideve të saj. Ndër premisat e Francës bën pjesë ideja e një Evrope të fortë, e aftë për të vepruar në nivel ndërkombëtar, një Evropë e pavarur, që në këtë botë shumëpolëshe duhet të kjojë një nga shumë qendra të balancuara të pushtetit duke përbërë në të njëjtën kohë edhe kundërpeshën për SHBA-të. Në realizimin e kësaj "Europe Puissance" Franca ka punuar tradicionalisht dhe gjithnjë e më shumë për bashkëpunimin ndërshtetëror dhe krijimin e besimit reciprok edhe në kuadër institucionesh mbikombëtare.

Me angazhimin e saj për një Evropë të bashkuar Franca ka qenë vazhdimisht e interesuar të luajë në një farë mënyre një rol udhëheqës në Evropë, të ushtrojë një ndikim të moderuar në aparatën vendimmarrës evropian si dhe të zhvendosë karakteristikat strukturore franceze në nivel evropian. Kështu për shembull në Evropë duhet të vazhdojë të ruhet para së gjithash diversiteti kulturor dhe gjuhësor dhe në këtë kontekst gjuhës franceze i duhet dhënë një vend i përshtatshëm në komunikimin evropian. Po kështu ruajtja dhe shtrirja e mëtejshme e modelit francez social dhe atij për shoqërinë, i cili

garanton për të gjithë popullsinë një masë të lartë sigurie shtetërore në pikëpamje sociale, është për Francën një çështje tejet e rëndësishme.

Se sa e madhe është frika e vetë popullsisë franceze për humbjen e këtyre koncepteve bazë të shoqërisë brenda një BE-je që vjen gjithnjë e në rritje, e tregon edhe rezultati negativ i referendumit për Kushtetutën Evropiane (54,8 përqind vota kundër). Kjo votë është edhe një tregues i qartë që francezët ndihen disi të mbingarkuar dhe ndjekin pa mundësi reagimi këtë ritëm të shpejtë të qeverisë së tyre.

Franca dhe zgjerimi i ardhshëm

Franca e konsideron procesin e zgjerimit si simbol për fundin e ndarjes së Evropës. Realizimi i vlerave të paqes, demokracisë dhe solidaritetit, që janë në qendër të ndërtimit evropian që prej momentit të themelimit të Komunitetit, janë një element i rëndësishëm përbërës i politikës franceze. Zgjerimi i Bashkimit Evropian është pasojë e logjikës gjeografike dhe historike të kontinentit dhe në të njëjtën kohë një sfidë historike.

Franca mbron dhe mbështet në parim përpjekjet për pranimin e Kroacisë. Parisi është i gatshëm para së gjithash për ndihmë bilaterale atje (për shembull përmes kualifikimit të nëpunësve në lidhje me çështje evropiane). Franca angazhohet së bashku me Gjermaninë edhe për anëtarësimin e Turqisë në BE. Këtë qeveria e motivon si në pikëpamje të politikave të sigurisë ashtu edhe në atë kulturore. Nga njëra anë Turqia paraqet interes strategjik për raportin me botën islamike dhe për stabilizimin e të gjithë rajonit, nga ana tjetër BE nuk duhet ta konsiderojë veten si "klub të krishterë", por përkundrazi si një komunitet vlerash, që bazohet mbi larminë dhe tolerancën e kulturave.

Por, në rast vendimmarrjeje të qeverisë, kursi i elitës politike franceze, në thelb miqësor përkundrejt procesit të zgjerimit, duhet të mendohet mirë duke marrë në konsideratë edhe faktorë të tjerë të kundërt në ndikim. Një prej këtyre faktorëve është fakti që pozicioni i qeverisë nuk gjen mbështetje në një pjesë të madhe të popullsisë. Përgjigja negative e francezëve ndaj Kushtetutës Evropiane në pjesën më të madhe motivohej nga frika e pasojave sociale dhe ato që lidhen me tregun e punës në këto raste zgjerimi që ndjekin kaq shpejt njëri-tjetrin; motiv tjetër ishte refuzimi i qartë ndaj anëtarësimit të Turqisë. Rezervat ndaj këtij anëtarësimi kanë për bazë realitetet e ndryshme fetare dhe gjeografike si dhe frikën nga një emigrim i mundshëm. Çështja është se edhe për sa kohë qeveria franceze do të jetë në gjendje të përfaqësojë një pozicion të kundërt me atë të popullsisë së vet. Hapi i parë në mbështetje të popullsisë është garancia, që populli francez vendimin e vet përfundimtar në lidhje me anëtarësimin e Turqisë do ta japë me votën e tij në kuadër të një referendumit.

Si faktor tjetër i rëndësishëm, që rëndon mbështetjen pa kushte të rasteve të reja të zgjerimit, është shqetësimi francez për humbjen e ndikimit në një BE të zgjeruar. Këtu luajnë rol elementet e mëposhtme analitike:

- Përmes anëtarësimit me shtete të tjera të Evropës Lindore tregu i brendshëm do të zhvendoset gjeografikisht në të mirë të Gjermanisë.
- Përqendrimi i vëmendjes në anëtarësimin e shteteve të tjera të Evropës Lindore do të çonte në lënien pas dore të vatrës së rrezikut në Mesdhe resp. në Afrikën e Veriut. Por pikërisht këtu Franca ka marrëdhënie shumë të ngushta, kushtëzuar edhe tradicionalisht, ndaj ajo konstaton një nevojë shumë më të madhe për tu bërë aktiv.
- Pranimi i shteteve të tjera të Evropës Lindore nuk do të ishte i mundur pa një reformë të politikave agrare. Por kjo do të thoshte humbje të konsiderueshme për fermerët, që shkaktojnë një opozitë të fortë nga ana e lobit francez në çështje të bujqësisë.

Ndaj Franca i kundërvihet fuqishëm heqjes së subvencioneve bujqësore për shtetet e vjetra anëtare.

Franca dhe Bosnje-Hercegovina kanë mundur që në shumë vite bashkëpunimi të grumbullojnë mjaft përvojë të mirë të përbashkët.

Service de coopération et d'action culturelle (Referati për Kulturën dhe bashkëpunimin), i cili u ngrit në Sarajevë menjëherë pas përfundimit të luftës, ndjek një politikë, që vendos në plan të parë mbështetjen e Bosnje-Hercegovinës në nivel institucional. Në vitin 2002, me rastin e vizitës së ministrit të jashtëm de Villepin u nënshkrua një marrëveshje francezo-bosnjake mbi bashkëpunimin në fushën e kulturës, shkencës dhe teknikës. Në një vend, klima e brendshme e të cilit vazhdon të mbartë konflikte ndëretnike, veprimet tona shikojnë me vendosmëri në drejtim të të ardhmes, pra drejt rinisë bosnjake (publikut të ri dhe të njerëzve të rinj të kulturës).

Përhapja e gjuhës dhe kulturës franceze bëhet kryesisht nga Institut français i Bosnje-Hercegovinës dhe zyrat e tij në Mostar, Banja Luka dhe Tuzla si dhe nga Centre André-Malraux, që u themelua në Sarajevë në kohën e pushtimit dhe me funksionin e një rëndësie thelbësore si urë kulturore dhe qendër gjuhësh.

Që prej vitit 2004 mësimi i gjuhës gjermane, i cili më parë kishte pësuar rënie të ndjeshme, ka marrë impulse të reja në kuadër të Programit „Educ-action“ (bursa, ftesa, kurse gjuhe në vend, kualifikime dhe kurse frëngjishteje veçanërisht për nëpunës). Marrëveshja ndërshtetërore mes Francës dhe Bosnje-Hercegovinës, nënshkruar në vitin 2006, ofron kuadrin e përshtatshëm për mësimin e gjuhës frëngë në mbarë vendin. Në vitin 2007, në Universitetin e Banja Lukës është hapur katedra e frëngjishtes. Në fushën e mësimin të gjuhës së huaj në shkolla aspekti më rëndësishëm është zgjerimi i seksioneve dygjuhëshe në Sarjevë dhe Mostar si dhe në aksionet e punës me të rinjtë (programe shkëmbimesh për të rinjtë bosnjakë dhe francez, kualifikimi i mësuesve të rinj).

Në sektorin e shkollave të larta dhe kërkimeve shkencore përpjekjet janë përqendruar në zhvillimin e partneriteteve mes shkollave të larta dhe institucioneve për kërkime shkencore, në rritjen e numrit të bursave, mbështetjen e projekteve kërkimore dhe në shkëmbimet universitare. Bashkëpunimi me OJQ-të bazohet mbi një system subvencionesh, të cilat në radhë të parë janë të destinuara për partnerë, që angazhohen në mënyrë aktive në projekte me të rinjtë. Krahas kësaj subvencione të tjera janë vënë në dispozicion për mbështetjen e aktorëve lokalë në rajonet e prapambetura të vendit.

Bashkëpunimi në fushën e mjekësisë bëhet konkret përmes mbështetjes së Shoqatës franceze MFBH (Medizin Frankreich Bosnien-Herzegovina), e cila është prej shumë vitesh aktive në këtë sektor. Përsa i përket fushës së drejtësisë pranë Gjykatës Shtetërore të Bosnje-Hercegovinës janë dërguar dy ekspertë ligjorë francezë: një avokate për të drejtën ndërkombëtare prej nëntorit 2006 dhe një gjykatës. Aktualisht është duke u punuar në projekte, që synojnë të shfrytëzojnë eksperiencën ligjore franceze në fushën e sistemit gjyqësor për të rinjtë dhe atë të organizimit të avokatisë. Krahas kësaj Franca financon edhe masa të caktuara në sektorin e bashkëpunimit policor. Bashkëpunimi administrativ për vitin 2007 gjen shprehje në kualifikimin e dy studentëve bosnjakë në Shkollën e Administratës ENA. Zhvillimi i turizmit është një fushë tjetër ku Franca vë në dispozicion Know-How-in e saj, veçanërisht pëmes pranisë së një asistenti teknik.

Tanimë janë krijuar instrumentet e duhura të bashkëpunimit, sikurse janë „dhjetë ditët e frankofonisë“, një ngjarje kulturore, që organizohet në nivel kombëtar. Është krijuar

gjithashtu edhe programi për mbështetjen e publikimit të veprave franceze. Aktiviteti I përvitshëm letrar „Rencontres européennes du Livre“ është event i më i madh i këtij lloji në këtë pjesë të Evropës. Veç kësaj mbështeten edhe arti viziv, muzika, teatri, arkitektura dhe trashëgimia kulturore.

Për shkak të ndërthurjes ekzistuese të komunave dhe rajoneve bashkëpunimi i decentralizuar vazhdon të jetë i kufizuar, madje ekziston rreziku që të pushojë fare së qeni. Shoqatat franceze të komunave do të kishin interes të bashkëpunonin në sektorët e eko-turizmit, bujqësisë ekologjike dhe energjisë. Me iniciativën e rajonit Auvergne për shembull u nis një bashkëpunim me Kantonin e Bosnjes Qendrore (Travnik) për të cilin qytetet Millau dhe Mostar në dhjetor 2006 nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi. Ndërkohë është duke u shqyrtuar një projekt partneriteti mes Mostarit dhe Saint-Denis. Në datën 19 prill 2007 u zhvillua një seminar, i cili kishte tre objektiva: një dinamikë të re në bashkëpunimin e decentralizuar, krijimin e një rrjeti të partneriteteve mes qyteteve dhe zgjerimin e bashkëpunimit në nivel rajonal.

Edhe mes Maqedonisë dhe Francës ka marrëdhënie po aq intensive. Por këto lidhje nuk mund të ndryshojnë faktin që Franca (ndryshe nga Gjermania, Italia dhe Britania e Madhe) mbështesin pozicionin e Greqisë në debatin mbi emrin e Maqedonisë.

Në janar 1998 të dy vendet nënshkruan një marrëveshje të bashkëpunimit kulturor, shkencor dhe teknik. Mjetet financiare, që vihen në dispozicion për bashkëpunimin me Maqedoninë, synojnë në radhë të parë forcimin e shtetit ligjor, kualifikimin e kuadrove drejtues maqedonas dhe nxitjen e gjuhës franceze.

Është në vijim programi arsimor për kuadrot e ardhshme drejtuese të administratës së vendit, i cili ka nisur të zbatohet në vitin 2002; ai plotësohet nga një masë për mbështetjen e Akademisë së Gjykatësve dhe Prokurorëve, ngritur para pak kohësh me qëllim arsimimin dhe kualifikimin e gjykatësve dhe personave të tjerë që punojnë në sistemin e drejtësisë.

Për studentët frankofonë të kombësisë maqedonase dhe shqiptare në bashkëpunim me universitetet franceze dhe labororet e kërkimeve shkencore është ngritur një projekt shkëmbimesh dhe bursash, i cili përqendrohet në sektorin e drejtimit të shtetit.

Nxitja e mësimi të hershëm të gjuhës frënge, zgjerimi i rrjetit të klsave dygjuhëshe, kualifikimi i koordinatorëve pedagogjikë dhe një frekuentim më i madh i universiteteve të vendit (Bitola, Tetovë dhe Shkup) janë katër drejtimet e bashkëpunimit gjuhësor.

Qendra e kulturës franceze, themeluar në vitin 1972 në Shkup, është institucioni më i vjetër i kulturës së huaj që ekziston në vend. Qendra shërben si pikëmbledhje e bashkëpunimit kulturor dhe artistik, pasi ajo garanton përhapjen e krijimtarisë artistike franceze dhe në të njëjtën kohë mbështet projektet në fushën e përgatitjes dhe mbledhjes së përvojës në favor të strukturave lokale.

Po kështu Franca ka kontakte të mira të kaheshme me Serbinë, të cilën e mbështet gjithashtu në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian. Megjithatë afërsia me Serbinë nuk mjafton për të ndryshuar faktin, që Franca së bashku me Gjermaninë kanë qenë dy shtetet e para të Bashkimit Evropian që njohën pavarësinë e Kosovës në shkurt 2008. Ndërkohë Kosovën e kanë njohur si shtet sovran 22 shtete të BE-së.

Qeveria Juaj përsëritet arrestimin e Radovan Karadzic në vitin 2008. Ju e vlerësoni këtë si një tregues vëçanërisht pozitiv për Serbinë. Në të njëjtën kohë Ju theksoni me forcë faktin, që vetëm ky sukses në kërkimin dhe kapjen e kriminelëve të luftës nuk mjafton

dhe që duhet të vazhdohet të kërkohet me forcë për të kapur të gjithë kriminelët e luftës në arrati. Prej Gjykatës Ndërkombëtare të pavarur për Ish-Jugosllavinë (ICTY) Ju kërkoni më tej angazhim intensiv dhe vendim burgimi afatgjatë për Karadzic.

Taktika:

Në përgjithësi Ju mbështesni vijimin e integritit, që t'ï përgjigjet rolit të tij historik. Por nga ana tjetër druani se mos gjatë procesit të integritit humbni rolin Tuaj prej fuqie kryesore. Pra së jashtmi Ju mbështesni integritimin e shpejtë, e megjithatë përpigëni të përfitoni sa më shumë për vete dhe që në të gjithë këtë Gjermania të marrë pjesën më të madhe të kostove.

Gjithsesi së bashku me Gjermaninë Ju kërkoni të krjoni një pozicion të mirë starti për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në lidhje me zgjerimin theksoni, që në parim pranimi është i mundshëm për të gjitha shtetet, nëse në përfundim të bisedimeve janë plotësuar të gjitha kriteret pa kompromis. Për bisedimet propozoni parimet e mëposhtme:

1. Adaptimin e kuadrit ligjor komunitar, pra marrjen përsipër të tërësisë së të drejtave dhe detyrimeve evropiane nga shtetet kandidatë për anëtarësim. Në këtë mënyrë zgjerimi nuk do të sjellë dobësimin e Unionit dhe politikës së tij. Franca nuk dëshiron të pranojë që Evropa të reduktohet në një zonë integriti rajonal ekonomik.

2. Në mënyrë që madhësia e Evropës së ardhshme dhe homogjeniteti më i paktë të mos jetë një pengesë për ato vende, që dëshirojnë të ndermarrin hapa të tjerë integriti, duhet të zbatohet koncepti i një "bashkëpunimi të thelluar", sikurse parashikohet në Traktatin e Amsterdimit. Në këtë mënyrë nuk krijohet as një Evropë "à la carte", ku secili merr sipas dëshirës, as edhe një "bërthamë e fortë", e cila kategorizon në "Ligën e dytë" të gjithë ata që nuk bëjnë pjesë në të, por përkundrazi krijohen instrumentet e duhura për të vijuar ndërtimin e Evropës në një kontekst të ri.

Duke mbajtur parasysh popullsinë Tuaj kritike ndaj zgjerimit Ju duhet t'ï peshoni mirë argumentat Tuaja për pranimin e anëtarëve të rinj në BE dhe të tematizoni frikën dhe dyshimet e zgjedhësve Tuaj. Sillni në vëmendje p.sh. që është në interes të të gjithëve, që bisedimet me Turqinë të shtrihen në një periudhë të gjatë kohore, derisa vendi të ketë arritur me të vërtetë pjekurinë e anëtarësimit. Duke marrë në konsideratë popullsinë Tuaj bëni të qartë, që Turqia që do të anëtarësohet më vonë në BE, nuk është Turqia e ditëve të sotme.

Si marrës neto në politikën agrare të Unionit Ju jeni para së gjithash i interesuar për vendosjen e afateve të gjata kalimtare në sektorine bujqësisë si dhe i kundërviheni përfshirjes së menjëhershme të shteteve të reja në sistemin e subveconeve të BE-së. Ju jeni të vetëdijshtëm për ndikimin e fuqishëm të lobit agrar të vendit Tuaj dhe kërkoni që mundësisht të shmangni përballjen me këtë grup interesash. Ndaj edhe përpigëni që të pengoni shkurtimet e shpejta në sistemin e subveconeve për shetet e vjetra anëtare. Duke qenë se e dini që Gjermania ka interes në vendosjen e afateve kalimtare sidomos në lidhje me lëvizjen e lirë të fuqisë puëtore, ja ku e keni mundësinë për të gjetur një paketë zgjidhjesh të përbashkëta. Por kini parasysh që opinionin francez është tejet kritik ndaj zgjerimit të shpejtë e ndoshta të nxituar të Bashkimit Evropian. Ju gjendeni përpara detyrës së vështirë për të shpënë përpara procesin e anëtarësimit dhe nuk duhet të lejoni që të bëhen premtime të qarta veçanërisht në adresë të Turqisë.

Italia (Italia)

Kryeqyteti:	Roma (2.653.200 banorë) (të gjitha shifrat e 2004)
Forma shtetërore:	Republikë, Demokraci parlamentare, me Sistem Dy-Dhomësh
Sipërfaqja:	301.336 km ²
Nr. i banorëve:	58.843.000 (2006)
PBB / banor:	3.1991 US-Dollar
Rritja e ekonomisë:	2,9%
Papunësia:	6,1 %
Gjuhët:	italisht; pakicat: Tirolit Jugut (gjermanisht, retoromanisht), frëngjisht, sllovenisht
Besimet fetare:	dominion pjesa romako-katolike, muslimanë mbi 1 mil, budistë 120.000, protestantë 50.000, hebrenj 40.000
Anëtar i Kom.evr./BE:	Anëtar themelimi
Kryetar shteti:	Giorgio Neapolitano
Kryetar qeverie:	Silvio Berlusconi
Informacione të tjera:	www.ambberlino.ersteri.it

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni përfaqësues i Italisë. Në këtë funksion, pas raundit të fundit të zgjerimit me dymbëdhjetë shtete të reja anëtare të Evropës Qendrore dhe Lindore, po përballeni me kërkesa të tjera anëtarësimi dhe duhet të vendosni në lidhje me to.

Italia në BE

Italia është bashkëpunuese e Traktateve të Romës së vitit 1957, anëtare e NATO-s dhe Bashkimit të Evropës Perëndimore. Ndër katër shtetet e mëdha të Bashkimit Evropian (Gjermania, Franca, Britania e Madhe dhe pikërisht Italia) Italia konsiderohet si vendi më entuziast për idenë evropiane. Kjo politikë proevropiane në të shkuarën ka patur para së gjithash motive me bazë politikën e brendshme, ndërsa vitet e fundit është shndërruar në një kurs më pragmatik, deri diku edhe më kritik.

Për qeverinë italiane përbëjnë shqetësim raportet agresive të popullsisë mbi fuqinë punëtore (pjesërisht ilegale) nga Rumania. Niveli i pranueshmërisë së njerëzve që vinë nga shtetet e reja dhe më të varfra të Bashkimit Evropian është për momentin ende shumë i ulët.

Në kuadër të përpjekjeve të ndryshme institucionale për reforma të BE-së Italia përfaqëson në parim një pozicion shumë miqësor kundrejt integritit dhe mbështet konsolidimin e elementëve mbikombëtare në aparatit institucional të BE-së (Komisioni, Parlamenti Evropian dhe Këshilli).

Italia u kushton vëmendje të veçantë para së gjithash tre fushave të politikës së BE-së. Për shkak të pozicionit të vet gjeografik ky vend është një mbrojtës aktiv i politikës evropiane për rajonin e Mesdheut, që në kuadër të Procesit të Barcelonës synon ndërtimin e një partneritet intensiv me shtete të tjera kufitare të rajonit të Mesdheut.

Lidhur ngushtë me angazhimin në funksion të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë Italia përpiqet edhe në nivel evropian për zhvillimin e një politike të përbashkët për të huajt si dhe për arritjen e një zgjidhjeje mbarëevropiane të problemit të imigracionit ilegal nga vendet e Afrikës së Jugut. Dhe në fund ky vend angazhohet fuqimisht për zgjerimin e rrjetit të infrastrukturës transevropiane si një faktor ndikues për më shumë integrim dhe si motor të rritjes ekonomike në Evropë.

Italia dhe zgjerimi i ardhshëm

Që prej fillimit të procesit të bashkimit evropian Italia ka mbështetur të gjitha masat që synojnë në thellimin e Komunitetit. Ndaj të gjitha fazat e deritanishme të zgjerimit janë konsideruar si zhvillime pozitive. Për shkak të përqendrimit të interesave në rajonin e Detit Mesdhe ky vend ka mbështetur edhe zgjerimin e BE-së në drejtim të Jugut (pranimi i Greqisë, Spanjës dhe Portugalisë), megjithëse këto tre vende do të ishin vende konkurrencte të Italisë për tregun bujqësor të Evropës së Jugut.

Italia ka mbajtur të njëjtin qëndrim bazë pozitiv edhe në lidhje me raundet e zgjerimit të radhës. Gjithsesi kohët e fundit vihet re një shqetësim në rritje në lidhje me faktin, që pranimi i shteteve të reja do të mund të dëmtonte disa prej interesave elementare të vendit. Ashtu si edhe gjatë zgjerimit në drejtim të Lindjes, edhe në këtë rast është ngritur shqetësimi, që zhvendosjet e qendrave gjeografike që shoqërojnë procesin e zgjerimit, mund të çojnë në lënien pas dore të rajonit të Mesdheut në pikëpamje ekonomike dhe politike. Industritë e rajonit të Mesdheut kanë frikë nga konkurrenca në ardhje dhe shqetësohen për pjesën e tyre nga asistenca evropiane për ndërtimin e strukturave. Krahas kësaj Italia sheh të procesi i zgjerimit edhe rrezikun e lënies pas dore të politikës mesdhetare në nivel evropian. Për shkak të pozicionit të vet gjeografik Italia është veçanërisht e ekspozuar ndaj rreziqeve që vinë nga shtetet e Afrikës së Veriut: terrorizmit ndërkombëtar në rritje, fundamentalizmit islamist dhe imigracionit ilegal përmes detit.

Veçanërisht e rëndësishme për Italinë është natyrisht edhe anëtarësimi i disa kandidatëve të rinj për shkak të përqendrimit në rajonin e Mesdheut. Kjo vlen veçanërisht për pranimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor, veçanërisht të Kroacisë si vend pothuaj fqinj i Italisë nga Lindja dhe vendeve kufitare buzë Adriatikut. Kuptohet që në këtë kontekst për qeverinë italiane është e rëndësishme një zgjidhje e përgjithshme e konflikteve në Ballkan – valët e refugjatëve si pasojë e këtyre konflikteve e prekin Italinë në mënyrë veçanërisht intensive – si dhe demokratizimi dhe stabilizimi i rajonit.

Menjëherë pasi Gjermania dhe Franca njohën pavarësinë e Kosovës në shkurt 2008, edhe Italia bëri të njëjtën gjë – njësoj si nëntëmbëdhjetë shtete të tjera të BE-së: Në të njëjtën masë Italia u vë theksin edhe raporteve të miqësisë me Serbinë.

Por në diskutimin rreth zgjerimit në qendër të vëmendjes po vihen gjithnjë e më shumë aspektet financiare. Italia, së cilës i është dashur të pësojë reduktime të shumta për të përmbushur euro-kriteret, shqetësohet për kostot e rritura, që do të duhet të mbajë pas zgjerimit. Për këtë arsye vendi angazhohet që zgjerimi të mos rëndojë financiarisht në kurriz të tij.

Në fund, për qeverinë italiane është e rëndësishme, që vijimi i procesit të zgjerimit të mos mbysë idenë e thellimit, si dhe që aftësia operationale e Institucioneve duhet të vazhdojë të ruhet. Ndaj ajo kërkon si kusht për fazën e ardhshme të zgjerimit, që të vendoset rregull , sipas të cilit në Këshill vendimet të merren e shumicë të cilësuar. Edhe

në fusha të rëndësishme të politikës, veçanërisht në atë të Politikës së Përbashkët në Punët e Jashtme dhe Çështjet e Sigurisë, duhen bërë hapa cilësore përpara, në mënyrë që të garantohet një funksionim efektiv i BE-së në skenën botërore.

Duke marrë shkak nga një fjalim i Presidentit të Italisë më 10.02.2007 me rastin e 60-vjetorit të shkëputjes së krahinave italiane në Istria, Dalmaci dhe Venecia-Juliane (sipas Marrëveshjes së Parisit për Paqen e vitit 1947), Presidenti kroat Stipe Mesic akuzoi homologun e tij, Giorgio Napolitano për "racizëm të hapur, revizionizëm historik dhe revanshizëm politik". Përkrah trishtimit në lidhje me viktimat italiane gjatë masakrës në Istria nga trupat jugosllave partizane të drejtuara nga Tito pas Luftës së 2. Botërore, Napolitano u shpreh se përmes këtyre akteve mizore janë vënë në zbatim "planet sllave për aneksim" dhe si pjesë e saj "spastrimi etnik" i gadishullit. Në datë 18.02., pas një proteste të fortë nga ana e Ministrit të Punëve të Jashtme të Italisë, Masimo D'Alema, Mesic i tërhoqi të gjitha akuzat e tij në formë dhe përmbajtje. Edhe Komisioni i BE-së i tërhoqi vëmendjen drejtuesit kroat në lidhje me përzgjedhjen e fjalorit të tij. Për kunderpeshë Qeveria italiane siguroi se nuk synonte në asnjë mënyrë rishikimin e Marrëveshjes për Paqe lidhur me ish- Jugosllavinë dhe do të mbështeste pa rezerva kandidaturën e Kroacisë për antarësim në BE.

Në fillim të vitit 2008 u duk sikur bisedimet me Kroacinë ngecën: Shpallja e njëanshme e një zone peshkimi, datë 1 janar 2008, jashtë ujërave territoriale kroate rënduan jo vetëm marrëdhëniet e Kroacisë me fqinjët e vet, shtete anëtare të BE-së, Italinë dhe Slloveninë, por edhe me vetë BE-në. Zagrebi foli zyrtarisht për një zonë ekologjike në mbrojtje të rezervave të peshkut në detin Adriatik. Në të njëjtën kohë Kroacia pretendonte me këtë edhe të drejta territoriale ndërkombëtare jashtë kufijve të territorit të saj. Kjo zonë për të cilën bëhej fjalë kishte një sipërfaqe prej 25 000 km². Pala kroate apeloi në këtë kontekst të drejtën ndërkombëtare duke sjellë në vëmendje që në rajon kishte patur raste të tilla precedente: edhe Italia dhe Sllovenia kishin shpallur zona të tilla të njëanshme.

Sllovenia dhe Italia e hodhën poshtë këtë varaint si një përshkrim jokorrekt dhe theksuan, se ato asnjëherë nuk ishin përpjekur, që me pretekstin e mbrojtjes së rezervave të peshkut në detin Adriatik, të kishin dashur të shtrinin në mënyrë të njëanshme të drejtat e tyre territoriale në Adriatik duke krijuar kështu rrethana të reja faktike në kuadrin e të drejtës ndërkombëtare.

Në lidhje me debatin për emrin mes Maqedonisë dhe Greqisë, Ju, në mënyrë të ngjashme me Gjermaninë, mbani një pozicion në tërësi neutral. Por gjithsesi për Ju është e pakonceptueshme se përse ky emër kushtetues, „Republika e Maqedonisë“ i njohur tashmë nga 120 shtete nuk njihet nga Greqia. Ju mund të përpiqeni të luani ndërmjetësin asnjnjës për të arritur që edhe Greqia të bjerë dakord me përafrimin e Maqedonisë me BE-në.

Taktika:

Si përfaqësues/ i/e Italisë Ju mbështesni në përgjithësi një fazë të re zgjerimi të BE-së me shtetet candidate.

Gjithsesi Ju ngrini disa dyshime Tuajat në lidhje me realizueshmërinë e tij dhe duhet të shqyrtoni mirë pasojat në politikën e brendshme dhe në fushën financiare. Këtu keni parasysh veçanërisht popullsinë Tuaj. Përpara se të jepni miratimin Tuaj për anëtarësimet, Ju bëni këto kërkesa:

Shtetet që aspirojnë anëtarësimin duhet që gradualisht të marrin përsipër e të adaptojnë inventarin ligjor të Komunitetit, dhe vetëm pas kësaj anëtarësimi bëhet i mundshëm.

- Politika e Përbashkët Agrare duhet t'u përshatet kërkesave të një Unioni të zgjeruar, pa ngarkuar në një masë mbiproporcionale marrësit e vjetër të subvencioneve.
- Rajoni i Detit të Mesdheut nuk duhet dalë jashtë vëmendjes. Ndaj Ju kërkoni një pozicionim të qartë të BE-së për një politikë aktive për Mesdheun edhe pas realizimit të zgjerimit.
- Procesi i zgjerimit do të ishte jorealit pa subvencionet përkatëse financiare, dhe kjo ngarkesë shtesë do të mbahet kryesisht nga shtetet financiarisht të forta.
- Duhet të arrihet harmonizimi i gjerë i kuadreve ligjore të shteteve të veçanta në fushën e lëvizjes së lirë të njerëzve.

Bëni temë të bisedimeve kërkesën për asistencë më të madhe të Jugut të Italisë me nivel të dobët zhvillimi dhe lidhur me këtë, kërkesën për kosto më të pakta të zgjerimit në kurriz të vendit Tuaj. Në mbyllje kërkoni mbështetjen e Francës dhe Gjermanisë për lehtësimin e mundshëm të barrës financiare.

Ju mund të përpiqeni, që të fitoni Spanjën si partner në përfaqësimin e çështjeve Tuaja. Por mos harroni, që Ju përfaqësoni pozicione shumë të ndryshme nga Spanja në lidhje me Kosovën.

Në të njëjtën kohë mbështesni procesin e anëtarësimin të Serbisë. Por kjo, sipas Jush, nuk duhet të ndodhë duke rënduar mbi vendet e tjera kandidate.

Lituania [Lietuva]

Kryeqyteti:	Vilna (550.000 banorë)
Forma shtetërore:	Demokraci parlamentare, elementë të theksuar presidencialë
Sipërfaqja:	65.301 km ²
Banorë:	3.394 000
PBB / banor:	7.930 Euro
Rritja ekonomike:	7,7 %
Papunësia:	4,3 %
Gjuhët:	lituanisht
Grupe etnike:	83,5 % lituanezë, 6,3 % rusë, 6,7% polakë, 1,2 % bjellorusë, 0,7 % ukrainas, 0,1 % hebrej, 1,5 % kombësi të tjera (2002)
Besimet fetare:	pjesa dërrmuese katolikë, krahas kësaj ortodoksë rusë, protestantë, hebrej
Anëtar i BE/Kom.Evr.:	1. Maj 2004
Presidenti:	Valdas Adamkus
Kryetari i qeverisë:	Gediminas Kirkilas
Kontakt:	www.botschaft-litauen.de

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni përfaqësues i Lituanisë në Këshillin e Bashkimit Evropian. Që prej 1 majit 2004 vendi Juaj është anëtar i BE. Në këtë funksion qeveria Juaj përballet me vendimmarrjen për një raund të ri zgjerimi të Komunitetit.

Lituania në BE

Shteti i sotëm i Lituanisë është themeluar në vitin 1918, por vetëm pas 50 vjetësh sundimi të huaj, pra më 1990, fitoi pavarësinë. Shumica e popullsisë e sheh anëtarësimin në BE dhe në NATO si të vetmen garanci të vërtetë për ruajtjen e kësaj pavarësie. Lituania kufizohet me Poloninë, Letoninë, Bjellorusinë dhe enklavën ruse Königsberg. 25 km në veri të Vilnës, në fshatin Bernotai gjendet, sipas hartografëve, qendra gjeografike e kontinentit evropian.

Integrimi i vendit në strukturat perëndmore, pra anëtarësimi në BE dhe në NATO, ka qenë prej kohësh prioriteti më i rëndësishëm i politikës së jashtme të këtij vendi, tashmë i realizuar. Në dhjetor të vitit 2002 qeveria lituaneze nënshkroi Marrëveshjen e anëtarësimit në BE, e cila u konfirmua fuqishëm në një referendum në maj të vitit 2003 me 91 % vota pro të popullsisë lituaneze. Që prej datës 1 maj 2004 Lituania është anëtare e BE.

Vitin e parë të anëtarësisë së vet Lituania e shfrytëzoi për stabilizimin dhe përforcimin e bashkëveprimit të saj në institucionet evropiane. Në dimensionin e përmbajtjes, vendi, nisur nga lidhjet historike dhe gjeografike, i kushton rëndësi të veçantë bashkëpunimit rajonal në zonën e Detit Balltik, veçanërisht me dy shtete të tjera balltike. Vendi e sheh veten si qendër gjeografike të bashkëpunimit ndërrajonal. Qeveria lituaneze angazhohet që kësaj teme t'i kushtohet më shumë vëmendje edhe në nivel evropian.

Marrëdhëniet pjesërisht të rënduara me Rusinë janë përmirësuar (ndër të tjera Lituania u ka njohur nënshtetësinë edhe qytetarëve rusë) dhe Lituania punon për intensifikimin e

këtyre linjave të bashkëpunimit edhe në nivel evropian në kuadër të marrëdhënieve BE-Rusi. Në këtë kontekst Lituania mbështet edhe bashkimin e enklavës Kaliningrad.

Në politikën e jashtme evropiane Lituania angazhohet shumë qartë për përf forcimin e marrëdhënieve transatlantike dhe për konsolidimin e rolit të NATO-s.

Lituania dhe raundi i ardhshëm i zgjerimit

Me anëtarësimin e Lituaniës në BE, u shtua një vend që mbart një masë të madhe njohurish rreth fqinjve të rinj të BE në Evropën Lindore si dhe sjell në Komunitet një sërë kontaktesh dypalëshe. Në këtë kontekst vendi bën pjesë në mbrojtësit më të flaktë të një politike aktive zgjerimi të BE, veçanërisht në drejtim të Evropës Lindore.

Ideja bazë e kësaj politike të hapjes kundrejt shteteve që aspirojnë anëtarësimin mbështetet mbi bindjen që transformimi demokratik i këtyre vendeve është themeli për stabilitetin dhe suksesin në Evropë, tani dhe në të ardhmen. Për Lituaninë epërsitë e zgjerimeve të ardhshme për të dyja palët janë qartësisht më të shumta: për vendet kandidate kjo do të thotë përkushtim ndaj sigurisë, stabilitetit dhe zhvillimit pas një periudhe konfliktesh dhe mungese lirie, ndërsa për BE zgjerimi do të sjellë gjithashtu elementë pozitivë në shumë fronte. Krahas një plusi në stabilitetin rajonal dhe forcimin e ndikimit si aktor global, Lituania sjell në vëmendje, që secila fazë zgjerimi deri më tani ka qenë një katalizator për progresin institucional brenda BE. Në këtë kuptim qeveria lituaneze mbron idenë, për të mos qenë a priori të mbyllur kundrejt kërkesave të anëtarësimit, por për të qenë gjithmonë të hapur për zhvillime të ardhshme.

Zor se ka një vend tjetër të BE që është kaq i hapur dhe pa paragjykime kundrejt raundeve të reja të zgjerimit. Edhe Turqia nuk përjashtohet nga Lituania a priori, edhe pse kërkohet qartësisht respektimi i Kriteve të Kopenhagenit.

Për përgatitjen e anëtarësimeve të ardhshme Lituania kërkon zbatimin e shpejtë e një politike aktive të fqinjësisë së mirë të BE më Lindjen, që duhet të mbështesë shtetet e atjeshme në proceset e tyre të transformimit. Vetëm me këtë mbështetje dhe me hapjen e perspektivave të qarta të anëtarësimit mund të ketë sukses demokratizimi i plotë i të gjithë Evropës së Lindjes. Në kuadër të politikës së fqinjësisë Lituania synon edhe një bashkëpunim më të ngushtë me Rusinë.

Taktika:

Si përfaqësues/e i/e Lituaniës Ju jeni një ndër mbrojtësit më të flaktë e radikalë të një politikë gjithëpërfshirëse zgjerimi. Në kuptimin e argumentimit të mësipërm Ju mbështesni në mënyrë aktive jo vetëm një politikë integrimi të shteteve që synojnë anëtarësimin, por angazhoheni brenda BE për një kurs të qartë zgjerimi. Këtu sillni në vëmendje që është vetëm diçka konsekuente, që argumenta të tillë si demokratizimi, stabilizimi dhe rritja ekonomike t'i përdorni tanimë edhe për kandidatët e tjerë për anëtarësim. Në vlerësimin Tuaj dyert duhet të hapen për të gjitha kombet, që kanë zgjedhur rrugën e demokracisë dhe të ekonomisë së tregut. Nga BE kërkoni që kandidatëve eventualë t'u dërgohet një sinjal i qartë: obligimi për ndjekjen e kësaj rruge në mënyrë strikte do të udhëheqë drejt suksesit! Skeptikëve brenda BE u thoni, që pa një perspektivë zgjerimi Komuniteti humbet kuptimin dhe misionin e vet si një *global player*. Për Ju as nuk vihet në diskutim anëtarësimi i Kroacisë në një të ardhme të shpejtë.

Në mënyrë të ngjashme Ju argumentoni në rastin e Turqisë, vend që e konsideroni një partner të rëndësishëm politik, ekonomik dhe kulturor. Ju gjykoni që bisedimet e anëtarësimit me të duhet të nisin sa më shpejt të jetë e mundur. Me anëtarësimin e Turqisë në BE jo vetëm do të rritej stabiliteti në rajon por edhe të forcohej qartë ndikimi i BE në Lindjen e Mesme dhe në Kaukaz dhe Komuniteti do të shndërrohej në një fuqi udhëheqëse multikulturore dhe multifetare. Prej Turqisë kërkoni gjatë bisedimeve të vijojë në mënyrë konsekuente reformat e filluara dhe sidomos t'i zbatojë më mirë ato.

Në mënyrë logjike Ju mbështesni edhe kërkesat për anëtarësim të shteteve të tjera të Ballkanit, ku Ju gjithsesi këmbëngulni në bashkëpunimin pa kushte me Gjykatën e Krimeve të Luftës. Njohja e Kosovës ka qenë diçka e diskutuar për muaj të tërë në politikën e brendshme, e megjithatë tanimë Ju i zgjasni dorën edhe Kosovës së pavarur. Por objektivat Tuaja afatgjata shkojnë përtej raundit të kandidatëve të tanishëm për anëtarësim. Në terma afatgjatë Ju shihni në BE edhe Bjellorusinë, Moldavinë, Ukrainën dhe Gjeorgjinë.

Gjithsesi këtë nuk duhet ta shprehni shumë qartë, pasi jeni të vetëdijshëm, që në këtë mënyrë do të zgjoni një rezistencë të fuqishme brenda BE. Në vend të kësaj angazhohuni fillimisht në mënyrë aktive për ndërtimin e programeve të fqinjësisë me këto vende.

Në parim, për realizimin e pozicioneve Tuaja, Ju natyrisht jeni i varur nga partnerë dhe koalicione. Shumë shtete anëtare të BE nuk janë kaq pozitivë sa Ju kundrejt një zgjerimi të ri. Tradicionalisht tre shtetet balltike kanë qenë të të njëjtit pozicion. Edhe tek Polonia mund të gjeni një partner për kursin Tuaj të zgjerimit. Por duhet të jeni i gatshëm edhe të lidhni kompromise, pasi përndryshe rrezikoni të izoloheni.

Luksemburg (Luxembourg)

Kryeqyteti:	Luksemburg
Forma shtetërore:	Monarki
Sipërfaqja:	2.586 km ²
Banorë:	462.000
PBB /banor:	71.240 US-Dollar
Rritja ekonomike :	6,2 %
Papunësia:	4,1 %
Gjuhët:	letzteburgisht, gjermanisht, frëngjisht
Besimet fetare:	86 % Katolikë
Grupet etnike:	60 % Luksemburgas, 40 % të huaj
Anëtar i Kom.Evr./BE:	anëtar themelimi
Kryetar shteti:	Duka i Madh Henri
Kryetar qeverie:	Jean-Claude Juncker
Informacione të tjera:	www.mea.lu

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni përfaqësues i Luksemburgut në Këshillin e Bashkimit Evropian. Si anëtar i BE që prej themelimit Luksemburgu ka marrë pjesë në marrjen e shumë vendimeve për zgjerim. Pas raundit të fundit të zgjerimit vendi po përballet me kërkesa të tjera anëtarësimi nga Evropa Lindore dhe Juglindore.

Luksemburgu në BE

Prej kohësh politika e jashtme e Luksemburgut ka qenë e karakterizuar nga dy çështje : siguria dhe integrimi në një zonë të madhe ekonomike. Që para themelimit të KEQÇ në vitin 1952, Luksemburgu kishte formuar në vitin 1948 së bashku me Belgjikën dhe Hollandën Bashkimin Ekonomik të BENELUX-it. Që prej fillimeve të procesit të integritimit evropian Luksemburgu ka bërë një politikë tejet të përqendruar evropiane. Si një shtet i vogël ai është i interesuar për një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm, ndaj në Luksemburg Bashkimi Evropian vlerësohet si një instrument i garantimit të paqes. Krahas kësaj vendi shikon në bashkëpunimin shumëpalësh mundësinë më të mirë për ruajtjen e pavarësisë së tij dhe të peshës së zërit të tij në botë. Luksemburgu ka përfituar shumë nga zhvillimi i Bashkimit Evropian, dhe, jo më pak, nga institucionet evropiane me seli në Luksemburg. Tradicionalisht ky vend ka ushtruar një funksion ndërmjetësues në procesin e bashkimit evropian.

Luksemburgu ka një interes të qartë në vijimin e thellimit të Bashkimit Evropian. Por duke qenë shteti i dytë më i vogël në Evropë është i shqetësuar për situatën e shteteve më të vogla dhe mundësitë e tyre të ndikimit në të ardhmen. Luksemburgu dëshiron të vazhdojë të qëndrojë në qendër të Bashkimit Evropian dhe të institucioneve të tij si dhe të ushtrrojë pushtetin e tij tradicional.

Luksemburgu dhe raundi i ardhshëm i zgjerimit

Luksemburgu në fakt ka një raport të mirë me shtetet e Evropës Lindore dhe Juglindore, veçanërisht me Rumaninë, ku edhe sot vazhdojnë të jetojnë pasardhësit e emigrantëve luksemburgas të shek. XII dhe XIII. Gjithsesi raundi i ardhshëm i zgjerimit e prek këtë vend më shumë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, nëse nisemi nga pozicioni i tij brendaevropian. Në radhë të parë qeveria e Luksemburgut shpreson, që me integrimin e shteteve të tjera të ruhet stabiliteti i gjendjes politike në të gjithë kontinentin. Për këtë arsye ky vend mbështet vijimin e zgjerimit sipas një plani të caktuar kohor.

Për qeverinë e Luksemburgut është e rëndësishme, që vendimi rreth anëtarësimeve të reja të merret vetëm mbi bazën e vlerësimit individual dhe objektiv të performancave vetiake të vendeve të veçanta kandidatë dhe jo në formën e një vendimmarrjeje politike në bllok.

Ju jeni kritikë në lidhje me Bosnje-Hercegovinën, pikërisht bashkëjetesën e atjeshme mes të krishterëve dhe muslimanëve. në gjykimin Tuaj bashkëjetesa paqësore mes besimeve fetare është një kriter vendimtar.

Në fakt Republika e Maqedonisë (shumicë e krishterë) dhe Kosova (pakicë të krishterësh) bashkojnë në vendin e tyre dy grupe të mëdha fetare. Gjithsesi, tensionet në të shkuarën nuk kanë ardhur vetëm prej këtyre arsyeve.

Në lidhje me debatin për emrin Luksemburgu po mban një qëndrim shumë të kujdesshëm dhe vetë nuk guxon të pozicionohet në mënyrë të saktë. Edhe në kuadër të kësaj çështjeje Ju e shihni veten në rolin e ndërmjetësit.

Si probleme të raundeve të reja të zgjerimit Ju konsideroni kryesisht barrat finaciare që ato do të mbartin (Luksemburgu është shteti më i pasur i Evropës pra edhe pagues kontributesh neto) dhe reduktimi i ndikimit të Luksemburgut mbi procesin e vendimmarrjes në një BE të zgjeruar. Këto dy pika luajnë një rol të madh për këtë vend në bisedimet e ardhshme.

Taktika:

Në përgjithësi Ju mbështesni vijimin e zgjerimit evropian, por kërkonti një aplikim strikt të kritereve të Kopenhagen-it për vendet e veçanta kandiduese, përpara se të realizohet pranimi. Para dhënies së miratimit për pranimin e anëtarëve të rinj Ju kërkonti në formacione të ndryshme të BE një reformë të politikës së kushtueshme në fushën e bujqësisë dhe tatimeve. Krahas kësaj kërkonti edhe garanci për faktin, që ndikimi i vendeve të vogla dhe trajtimi i barabartë i të gjitha shteteve anëtare në BE të jetë i siguar dhe të mos ketë hapa prapa në integrim. Në këto kushte Ju e mbështesni shumë qartë dhe dukshëm procesin e zgjerimit.

Për Kroacinë Ju shihni një mundësi anëtarësimi në të ardhmen e afërt, por angazhoheni gjithashtu edhe në mbikqyrjen e progresit praktik të reformave edhe pas nënshkrimit të marrëveshjes së anëtarësimit deri në aktin konkret të tij, në mënyrë që të mund të reagohet menjëherë në rast mungesash apo gabimesh eventuale. Në përgjithësi, në terma afatgjatë, Ju e shihni të ardhmen e Ballkanit brenda BE. Por, duke marrë në konsideratë veçanërisht shtetet e Ballkanit Perëndimor, Ju theksoni, që çelësi i fillimit të bisedimeve të anëtarësimit qëndron në kryeqytetet përkatëse. Edhe pse Ju kërkonti të shmangni sinjalet negative për procesin e reformave të të gjithë Ballkanit, hapja e bisedimeve me Kroacinë për Ju do të ishte e mundshme vetëm pasi të konstatohej që ky vend bashkëpunon në mënyrë të kënaqshme me Gjykatën Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në Ish-Jugosllavi.

Nga Turqia kërkoni zbatimin konsekuent të reformave, për të cilat janë marrë vendimet përkatëse (veçanërisht vendosjen e të drejtave të njeriut) si dhe mbështetjen e procesit të paqes dhe bashkëpunimit në ishullin qipriot. Në momentin që konstatohen këto, atëherë Ju jeni sigurisht i hapur për bisedimet e anëtarësimit.

Veç zgjerimit në vetvete për Ju është një çështje e rëndësishme të kujdeseni për realizimin e interesave Tuaj – në radhë të parë ruajtjen e ndikimit të Luksemburgut në BE. Kjo do të thotë që Luksemburgu duhet të vazhdojë të merret mjaftueshëm në konsideratë. Përpiquni të lidhni një „package deal“, duke bërë lëshime në pika të tjera, por që sigurojnë ndikimin Tuaj. Tërhiqni gjithashtu vëmendjen në mënyrë të qartë, që në fakt Ju jeni një vend gjeografikisht i vogël por me një ndikim shumë të madh ekonomik, para së gjithash në sistemin financiar.

Malta [Malta]

Kryeqyteti:	La Valetta
Forma e shtetit:	Republik
Sipërfaqja:	315,6 km ²
Banorë:	410.000
PBB /banor:	15.300 US-Dollar
Rritja ekonomike:	3,4 %
Papunësia:	6,4 %
Gjuhët:	Malteze, anglisht e pjesërisht italisht si gjuhë e përditshme
Besimet fetare:	95,2 % katolikë
Grupet etnike:	Maltezë
Anëtar i Kom.Evr. / BE:	2004
Kryetar shteti:	Edward Fenech-Adami
Kryetar qeverie:	Laurence Gonzi
Informacione të tjera:	maltaembassy.berlin@gmx.net

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni përfaqësues i Maltës në Këshillin e Bashkimit Evropian. Vendi Juaj është anëtar i BE që prej datës 1 maj 2004. Në këtë funksion Ju përballeni me vendimmarrjen rreth rrethit të ardhshëm të zgjerimit të BE.

Malta në BE

Ishulli i Maltës, i cili së bashku me ishullin tjetër, fqinjë e më të vogël Gozo, i cili i përket Maltës, ndodhet në Mesdhe mes Sicilisë dhe bregut afrikan, ka një histori në dryshim të vazhdueshëm. Për shkak të pozicionit të favorshëm strategjik në Mesdhe ky ishull, me kalimin e kohës, i ka ndërruar në mënyrë të përsëritur pronarët e vet. Kështu pas rënies së sundimit të fenikasve, kartagjenasve dhe romakëve Malta ra nën Perandorinë Bizantine, më pas vijuan arabët, normanët dhe në fund sicilianët. Një ditë kyçe e historisë së Maltës është viti 1523, kur ishulli u pushtua nga urdhri i Johanitëve nga Jeruzalemi. Pas një periudhe të shkurtër të sundimit francez Malta u shndërrua me vullnetin e vet në vitin 1814 në një pjesë të Britanisë së Madhe dhe në vitin 1964 fitoi pavarësinë.

Jeta politike në Maltë dominohet para së gjithash nga dy parti të mëdha, Partia e Punës dhe Partia Nacionalsocialiste. Të dyja këto kanë formuar deri më tani, herë njëra e herë tjetra, shumicën në Parlamentin Maltez, pra edhe qeverinë e vendit.

Referuar anëtarësimit në Bashkimin Evropian në Maltë nuk ka patur një konsensus politik gjithëpërfshirës. Në vitin 1990 Malta, nën qeverisjen e Partisë Nacionalsocialiste, bëri kërkesën për pranim në BE, kërkesë që qeveria e zgjedhur në vitin 1996, përfaqësuar nga Partia e Punës e pezulloi. Pas ndërrimit të pushtetit të vitit 1998 Malta përsëriti kërkesën e vet. Që prej këtij momenti anëtarësimi në BE ishte për Maltën objektivi më i rëndësishëm i politikës së jashtme. Në referendumin e datës 8 mars 2003 53,5% e maltezëve mbështetën anëtarësimin në BE. Duke ndjekur vijën e referendumit dhe duke përshëndetur përafrimin me BE në vitin 2003 u zgjodh në pushtet sërish Partia Nacionalsocialiste. Në datën 1 maj 2004 Malta hyri në BE dhe zhvendosi kështu Luksemburgun si vendin më të vogël të BE.

Përmes Kushtetutës së saj të vitit 1987 Malta është përcaktuar në pozicionin e saj neutral, i cili u përforcua edhe në marrëveshjen e anëtarësimit në BE. Në këtë mënyrë Malta vijon politikën e vet të deritanishme të asnjënjësisë dhe të lirisë në bllok.

Malta bën një politikë të jashtme me orientim mesdhetar dhe kujdeset për marrëdhënie të mira jo vetëm me fuqinë e vet të dikurshme koloniale Britaninë e Madhe por edhe për kontakte të ngushta me Italinë, SHBA, shtetet e Afrikës së Veriut, veçanërisht me Libinë. Përmes pozicionit të vet gjeografik Malta sjell rëndësinë e vet strategjike në BE dhe e konsideron veten si një urë përmes Detit Mesdhe, e cila bën të mundur lidhjet mes BE dhe shteteve afrikano-veriore.

Malta dhe zgjerimi

Malta është e hapur kundrejt një faze të re zgjerimi të BE në përgjithësi. Në vijimin e kursit të zgjerimit ky vend shikon një stimulim të fuqishëm për vendet që aspirojnë anëtarësimin, për të çuar më tej reformat pozitive, me qëllim që të bëhen një pjesë e projektit evropian. Ky vrull reformash është në fund të fundit në të mirë të të gjithë kontinentit, pasi kështu mund të garantohet stabiliteti në terma afatgjatë.

Për ato vende, situata politike dhe ekonomike e të cilave nuk bën të mundur një anëtarësim të shpejtë në kohë, Malta nxit zgjerimin e politikës së fqinjësisë së mirë, në mënyrë që edhe atje të arrihet një efekt stabilizues. Në kuadër të këtij bashkëpunimi kërkohet që të vihen në plan të parë veçanërisht kontrolli i lëvizjeve të migracionit, konsolidimi i të drejtave të njeriut, demokratizimi. Lufta kundër terrorizmit dhe mbështetja e një klime pozitive investimesh.

Në thelb Malta është mbështetëse e të gjitha shteteve të interesuara për anëtarësimin. Malta është njësoj e hapur si për një anëtarësim të shpejtë të Kroacisë ashtu edhe për atë të Turqisë. Malta është shprehimisht për një përshpejtim të procesit të përafrimit dhe për premtime obliguese në adresë të Turqisë.

Disi më kritike Malta është përkundrejt politikës në Bosnje-Hercegovinë. Qeveria e Maltës druan shkatërrimin e shtetit të atjeshëm, ndaj edhe kërkon prej grupeve të ndryshme të popullsisë, të kapërcejnë dallimet e tyre fetare dhe të punojnë për një shtet të bashkuar. Vetëm në këtë mënyrë njerëzit e këtij rajoni mund të shprehin për anëtarësimin në BE. Malta e ka njohur pavarësinë e Kosovës.

Taktika:

Si përfaqësues/e i/e Maltës Ju në thelb e mbështesni pranimin e anëtarëve të tjerë në BE. Por e kushtëzoni miratimin Tuaj duke thënë, që këto vende mund të pranohen vetëm pasi të jenë tërësisht të aftë të plotësojnë kriteret e Kopenhagen-it si dhe të kenë sisteme të qëndrueshme ekonomike dhe politike.

Për Ju është e rëndësishme, që integrimi i antërëve të rinj të mos rrënojë BE në njësimin e vet social, politik dhe ekonomik, por përkundrazi ta nxisë më tej atë.

Ndër vendet e ndryshme kandidatë për anëtarësim Ju dëshironi veçanërisht pranimin e Kroacisë. Sapo vendi të përmbushë kushtet e Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës për Ish-Jugosllavinë, pra të dorëzojë të gjithë kriminelët e kërkuar të luftës, Ju nxisni për një pranim të shpejtë të këtij vendi në BE.

Më tej Ju kërkoni të përdorni në mënyrë më intensive instrumentin e politikës evropiane të fqinjësisë së mirë për të lidhur më fort shtetet fqinje me BE. E njëjta gjë vlen për Serbinë.

Aplikimi i kësaj politike për Ju është mjaft i rëndësishëm veçanërisht duke iu referuar zonës së Detit Medhe dhe Afrikës së Veriut, pasi Ju jeni i shqetësuar, që interesat e BE për zgjerimin po zhvendosen më shumë drejt lindjes, duke lënë kështu pas dore fqinjët jugorë. Për të penguar këtë duhet të bashkoheni me shtete të tjera që kufizojnë zonën mesdhetare.

Edhe përkundrejt anëtarësimit të Turqisë Ju keni një pozicion aspak strikt e refuzues, pasi përmes pranimi të këtij vendi do të përforcohej pozicioni i shteteve jugore dhe atyre kufizues të zonës së Medheut brenda BE.

Krahas kësaj Ju kujdeseni për marrëdhëniet tradicionalisht të ngushta me Britaninë e Madhe, ndaj edhe përpiqeni që të përfaqësoni pozicione të përbashkëta. Në fund duhet të konsideroni faktin, që duke qenë vendi më i vogël brenda BE Ju shqetëson edhe ndikimi Juaj brenda aparatit vendimmarrës të BE.

Përpara zgjerimit përpiquni që shtetet e vogla të mund të përfaqësohen në një mënyrë të përshtatshme dhe të mos humbasin ndikimin e tyre.

Hollanda (Nederland)

Kryeqyteti:	Amsterdam
Selia e qeverisë:	Hagë
Forma shtetërore:	Monarki Parlamentare
Sipërfaqja:	41.526 km ²
Banorë:	16.340.000
PBB/Banor:	43.050 US-Dollar
Rritja ekonomike:	2,9 %
Papunësia:	3,2 %
Gjuhët:	hollandisht, friezisht (rajonal)
Besimet fetare:	30 % katolikë, 20 % protestantë, më shumë se 40 % pa përkatësi fetare
Grupet etnike:	97 % hollandezë
Anëtar i BE/Kom.Evr.:	Anëtar themelimi
Kryetar shteti:	Mbretëresha Beatrix
Kryetare e qeverisë:	Jan Peter Balkenende
Informacione të tjera:	www.niederlandeweb.de

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni përfaqësues/e i/e Hollandës në Bashkimin Evropian. Si shtet anëtar i themelimit të KEE vendi Juaj ka ndikuar në vendimet për një sërë raundesh zgjerimi. Pak pas zgjerimit të fundit të madh në drejtim të Lindjes Hollanda po përballet më kërkesa të reja anëtarësimi nga shtetet evropiano-lindore dhe juglindore.

Hollanda në BE

Hollanda tradicionalisht është kujdesur për një bashkëpunim intensiv me shtetet fqinje duke u nisur nga pozicioni i vet gjeografik dhe nga madhësia e saj. Që prej themelimit të KEQÇ në vitin 1951 Hollanda u bashkua me Luksemburgun dhe Belgjikën në Unionin Ekonomik të BENELUX-it. Që prej themelimit të KEE Hollanda ka një interes të madh në një treg të brendshëm funksional, pasi 75% e produkteve të saj eksportohen në tregun evropian.

Gjithsesi politika holandeze për Evropën nuk orientohet vetëm nga aspektet ekonomike. Prej kohësh vendi aplikon brenda BE një politikë shumë miqësore me integrimin dhe mbron lidhjet e ngushta të brendshme, dhe është për përforcimin e pozicionit të Parlamentit dhe Komisionit si dhe zgjerimin e vendimeve mbi bazë shumice në Këshill. Në këtë kuptim për Hollandën është e pashmangshme një reformë e institucioneve të BE, në mënyrë që edhe në të ardhmen të garantohet aftësia operacionale e Komunitetit.

Edhe në dimensionin e politikës evropiane për Punët e Jashtme dhe të Sigurisë qeveria holandeze kërkon një bashkëpunim më të ngushtë dhe angazhim më të madh, por jo në kurriz të marrëdhënieve transatlantike. Raporti me SHBA për Hollandën ka një rëndësi të lartë për politikën e jashtme dhe nuk duhet të rrezikohet.

Në mbyllje Hollanda, ky kontribues i madh financiar, kërkon që të gjitha hapat e ardhshëm të integritit evropian të realizohen me kosto të pranueshme, që do të thotë një reformë rrënjësore të politikës së kushtueshme të përbashkët agrare.

Hollanda dhe zgjerimi i ardhshëm i BE

Hollanda mbështet zgjerimin e ardhshëm të BE më një numër të kufizuar shtetesh dhe me kushte të caktuara. Në parim pranimi i anëtarëve të rinj gjen mbështetjen e Hollandes, se në këtë mënyrë stabiliteti i Evropës rritet dhe njëkohësisht kjo sjell avantazhe të veçanta për sipërmarrjet hollandeze të orientuara për nga eksportet. Megjithatë Hollanda shprehet për një kalim të kujdesshëm në hapat e mëtejshëm të zgjerimit.

Problemet aktuale të vendit me integritin e emigrantëve dhe me frikën që rrjedh së këtejmi për tendenca kritike ndaj të huajve në shoqërinë hollandeze duhet të merren seriozisht nga qeveria. Në mënyrë që frika të mos përhapet më tej, qeveria është duke ndjekur kursin e mbështetjes së anëtarësimeve të reja vetëm pas përcaktimit të disa klauzolave të sigurisë dhe afateve kalimtare veçanërisht në sektorin e lëvizjes së lirë të personave.

Efekti i një zgjerimi mbi aparatit institucional duhet analizuar paraprakisht në mënyrë të qartë si dhe duhet bërë kusht në një fazë e integritit të mëtejshëm, në mënyrë që të mos rrezikohet aftësia vendimmarrëse e BE. Me qëllim që pranimi i pakontrolluar i anëtarëve të rinj të mos shkatërrojë thelbin e BE, Hollanda vë fillimisht theksin në ratifikimin e shpejtë të marrëveshjes së Kushtetutës Evropiane.

Një masë tjetër në mbrojtje të aftësisë operacionale të BE qëndron në zbatimin strikt të kritereve politike dhe atyre ekonomike për secilin prej vendeve kandidate për anëtarësim. Në këtë mënyrë duhet të garantohet, që tregu i brendshëm të mos humbasë në vlerë për shkak të zgjerimit, po kështu edhe sektorët e tjerë të politikës evropiane (si p.sh. mbrojtja e mjedisit).

Dinamika e procesit të bashkimit duhet të vazhdojë të ruhet, ndaj për Hollandën është e pashmangshme një shkallë e caktuar integriti të diferencuar brenda Bashkimit Evropian të zgjeruar. Ndër kushtet e përcaktuara në kontratë për një bashkëpunim të përforcuar – ai duhet të jetë në çdo kohë i hapur për shtete anëtare, që duan të bashkëpunojnë dhe nuk duhet të rrezikojë as rendin juridik dhe as tregun e brendshëm – qeveria mbështet një shfrytëzim më të mirëorientuar të këtij instrumenti, me qëllim që të pengohet stagnacioni i procesit të integritit në BE e madhe.

Por hollandezët kanë gjithnjë e më tepër frikë, se mos në një BE që është në rritje të vazhdueshme, ata do të humbin ndikimin e vet. Këtu luan rol edhe frika nga flukset masive të emigrantëve dhe nga një „tejhuajëzim“ i shoqërisë. Në kontekstin e kësaj përzierjeje shqetësimesh të ndryshme hollandezët vendosën në qershor 2005 me shumicë të refuzonin kushtetutën Evropiane në një referendum.

Qeveria hollandeze angazhohet fuqishëm për të drejtën e vetëvendosjes së popujve dhe përshëndet pavarësinë e Kosovës si dhe kërkon që Maqedonia të ketë të drejtën për të përcaktuar vetë emrin e saj.

Taktika:

Si përfaqësues/e i/e Hollandës Ju jeni për një zgjerim afatgjatë të BE me vende të Ballkanit Perëndimor dhe eventualisht edhe me Turqinë, por kërkonit të siguroheni që të garantohet të qenët bashkë dhe vazhdimësia e Unionit. Sipas linjës së mësipërme të argumentimit Ju nxisni një reformë të thellë institucionale, përpara se të pranohen anëtarë të rinj.

Edhe në lidhje me tendencat euroskeptike të krijuara brenda popullsisë së BE, veçanërisht ato të popullsisë së vet, Ju nënvizoni domosdoshmërinë e një integrimi gradual të anëtarëve të rinj dhe jeni për vëniën në zbatim të klauzolave të sigurisë dhe afateve kalimtare në sektorë të ndjeshëm skurse është lëvizja e lirë e personave. Argumentoni që mbështetja publike është e domosdoshme për të realizuar një zgjerim të ri.

Një çështje e madhe për Ju është edhe kufizimi i kostove të një faze të re zgjerimi. Ju kërkonit një reformë të vendosur të strukturës së shpenzimeve brenda Unionit si dhe një kufizim të përgjithshëm të buxhetit të BE në një përqind të fuqisë ekonomike evropiane. Dhe kjo do të thotë një reduktim i ndjeshëm i fuqisë financiare të BE.

Vendet, që në gjykimin Tuaj do të kenë mundësinë më të shpejtë të anëtarësimit në një të ardhme të afërt, janë Kroacia dhe Maqedonia, proceset e transformimit të të cilave Ju i mbështesni në mënyrë aktive. Gjithsesi Ju kërkonit edhe njëmbikqyrje të rreptë të përpjekjeve për reforma të të dy vendeve deri në momentin e pranimit faktik në BE si dhe shqyrtimin e mundësisë kontraktuale, që në rast se konstatohen pamjaftueshmëri anëtarësimi, të mund të shtyhet për më vonë.

Edhe të ardhmen e shteteve të tjera të Ballkanit Perëndimor Ju e shihni brenda BE në terma afatgjatë. Lidhur me kërkesat aktuale për anëtarësim të Kroacisë, dhe veçanërisht të Serbisë, Ju jeni një mbrojtës i flaktë i kriterëve politike të vendosura, ku bën pjesë edhe bashkëpunimi i pakufizuar me Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve.

I ngjashëm është qëndrimi Juaj në lidhje me Turqinë. Në fakt Ju keni rezerva serioze lidhur me ndikimin që do të ketë anëtarësimi i Turqisë në BE, por jeni gjithsesi kundër faktit, që për Turqinë duhet kërkuar përmbushja e disa kriterëve shtesë – të natyrës fetare apo kulturore. Nëse Turqia përmbush kriteret politike Ju nuk e pengoni hapjen e bisedimeve me të. Gjithsesi duhet të bëni plotësisht të qartë, që bisedimet duhet të zhvillohen për një periudhë të gatë kohore pa përcaktuar rezultatin apo afatin përkatës. Mbikqyrja strikte e zbatimit të reformave në Turqi është për Ju kusht paraprak për zhvillimin e bisedimeve.

Për vende të tjera përtej Ballkanit dhe Turqisë Ju aktualisht nuk shikoni një perspektivë konkrete anëtarësimi. Por për Ju një politikë fqinjësie aktive dhe e ndershme është një instrument i mirë alternativ drejt zgjerimit të pakufizuar, për të përhapur stabilitetin dhe demokracinë edhe përtej kufijve të BE.

Polonia [Polska]

Kryeqyteti:	Varshava (2,4 mil banorë) (të gjitha shifrat për 2004)
Forma shtetërore:	demokraci parlamentare me parlament dy-dhomësh
Sipërfaqja:	312.685 km ²
Banorë:	38,129 Mio.
BIP/banor:	8.210 US-Dollar
Rritja ekonomike:	6,1 %
Papunësia:	9,6 %
Gjuhët:	Polonisht
Besimet fetare:	katolikë (35 mil), ortodoksë rusë, protestantë, katolikë të vjetër, hebrenj
Anëtar i Kom.Evr./BE:	2004
Kryetar shteti:	Lech Kaczynski
Kryetar qeverie:	Donald Tusk
Informacione të tjera:	www.botschaft-polen.de

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni përfaqësues/e i/e Republikës së Polonisë në Këshillin e Bashkimit Evropian. Vendi Juaj është që prej datës 1 maj 2004 anëtar i BE-së dhe në këtë funksion përballet me vendimmarrjen për një zgjerim të mëtejshëm.

Polonia në BE

Ndërsa popullsia polake, në shumicën e saj, u ndesh me skepticizëm dhe e pavendosur me anëtarësimin e vendit të saj në 1 maj 2004, është krijuar ndërkohë bindja që në përgjithësi Polonia ka përfituar nga anëtarësimi i saj në BE. Kjo vlen në mënyrë të veçantë për sektorin e bujqësisë, që ka marrë subvencione të shumta, si dhe për ekonominë e eksporteve. Në kaudër të bisedimeve rreth Kushtetutës Evropiane Polonia është paraqitur si një shtet anëtar i vetëdijshëm, i cili angazhohet për ruajtjen e ndikimit të vet brenda institucioneve të BE-së. Në veprimtarinë e përditshme substanciale të BE-së Polonia angazhohet veçanërisht në kuadër të politikave të fqinjësisë, në zhvillimin e mëtejshëm të strategjisë së Lisbonës dhe në Politikën Evropiane për Sigurinë dhe Mbrojtjen. Kjo e fundit duhet të konceptohet si një plotësim dhe jo si konkurrencë e NATO-s. Marrëdhëniet e mira me SHBA-të janë shumë të rëndësishme për këtë vend. Krahas kësaj Polonia është një mbrojtëse e fuqishme e vijimit të politikës së zgjerimit.

Polonia dhe zgjerimi i ardhshëm

Megjithëse Polonia është një shtet anëtar i ri, ajo kërkon që përmes pozitës së vet gjeografike specifike mes Lindjes dhe Perëndimit si dhe përmes lidhjeve kulturore dhe historike mes Lindjes dhe Perëndimit të ndikojë në politikën e ardhshme të zgjerimit. Në tërësi Polonia është tejet pozitive kundrejt vijimit të zgjerimit dhe mbështet në mënyrë aktive shtetet kandidatë në përpjekjet e tyre për anëtarësim.

Vijimi i procesit të zgjerimit është në interesin polak edhe për shkak se vendi ka marrëdhënie ekonomike intensive me Evropën Lindore dhe Juglindore dhe, nga një pranim i mundshëm i këyre vendeve në BE, shpreson shumë të ketë avantazhe ekonomike.

Në rast se do të ketë faza të tjera zgjerimi për Poloninë është e rëndësishme të ruajë interesat e veta. Reformat e brendshme të 15 viteve të fundit, që qenë të nevojshme për anëtarësimin në BE, e mobilizuan popullsinë ndër të tjera edhe me perspektivën e pranimit aq të dëshiruar në BE. Pasi e arriti këtë objektiv të vetin, Polonia kërkon tanimë, si vend marrës i subvencioneve neto, të shfytëzojë shanset e ofruara për procesin e modernizimit dhe të rimëkëmbjes. Në këtë mënyrë nuk do të ishte në interesin e Polonisë, që fazat e reja të zgjerimit të financoheshin duke shkurtuar subvencionet e veta dhënë nga BE-ja. Këto kosto duhet të merren përsipër në pjesën më të madhe nga anëtarët, që janë në gjendje më të mirë financiare.

Si vend me një madhësi të mesme Polonia nuk kërkon të humbasë ndikimin e saj brenda BE-së. Polonia ndihet një partner i rëndësishëm brenda BE-së, dhe kjo jo vetëm për shkak të numrit të madh të popullsisë, por para së gjithash për shkak të kontributit të vet historik në bashkimin e kontinentit. Vendi është aktualisht me rëndësi të madhe për BE-në në rolin e tij si një ndërmjetës natyral mes Lindjes dhe Perëndimit. Zgjerimet e ardhshme nuk duhet të reduktojnë peshën politike të Polonisë në institucionet e BE-së.

Polonia ka lidhje të veçanta historike me Ukrainën dhe Bjellorusinë, pasi përfundimi i Ukrainës dhe Bjellorusisë ka qenë për një kohë të gjatë, deri në tre ndarjet e fundshekullit të 18-të, pjesë e shtetit polak. Së këtejmi lindën marrëdhënie të ngushta kulturore, që kanë lënë gjurmët e tyre deri në ditët e sotme dhe e forcojnë më tej rëndësinë e Polonisë si ndërmjetës midis këtyre shteteve dhe BE-së. Duke qenë se anëtarësimi i Ukrainës dhe Bjellorusisë në një të ardhme të afërt nuk gjen mbështetje të shtetave të tjera anëtare, atëherë Polonia angazhohet shumë në kuadër të shtrirjes së politikës së fqinjësisë me këto vende. Por edhe në këndvështrimin ekonomik Polonia nuk është e interesuar që kufiri i jashtëm Lindje-BE të shndërrohet në një linjë të theksuar ndarjeje. Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtia ndërkufitare duhet të vazhdojnë të ruhen, pasi prej tyre varen shumë vende të rëndësishme pune.

Taktika:

Ju jeni përfaqësues/e i/e Polonisë. Në këtë cilësi Ju theksoni në mënyrë të veçantë rëndësinë e vendit Tuaj si ndërmjetës i natyreshëm mes Lindjes dhe Perëndimit. Lidhur me mënyrën se si do të veprohet me zgjerimin në të ardhmen Ju ndiqni moton: "dje Bullgaria, sot Kroacia dhe Turqia, nesër Ukraina", që do të thotë se Ju kërkonit që zgjerimi të vijojë në mënyrë konsekuente.

Ju angazhoheni në mbështetje të Kroacisë duke vënë kushtin që ky vend të bashkëpunojë mjaftueshëm me Gjykatën për Krimet e Luftës në Hagë. Edhe Turqinë e shihni në terma afatgjate anëtare të BE-së. Përfshirja e këtij vendi në strukturat evropiane është një faktor elementar stabiliteti në mbarë rajonin. Perspektiva e anëtarësimit do të përshpejtojë procesin e brendshëm të reformave në Turqi, megjithëse e dini që në këtë drejtim ky vend ka ende shumë për të bërë, veçanërisht në fushën e të drejtave të grave dhe të mbrojtjes së minoriteteve. Kërkonit nga Turqia përpjekje më intensive për reformat dhe ofroni për kompensim një mbështetje aktive në Këshill për kërkesën e saj për anëtarësim.

Por për Ju mund të diskutohet rreth anëtarësimit të mundshëm të vendeve të tjera candidate, vetëm nëse në fund të bisedimeve janë përmbushur të gjitha kriteret.

Edhe Polonia e ka njohur Kosovën ndërkombëtarisht, megjithëse në nivel të politikës së brendshme polake ka patur një debat të madh substancial në lidhje me këtë temë, nëse lejohet që BE-ja të përzihet në çështje të brendshme të Serbisë dhe të vërë në diskutim integritetin territorial të saj. Por frikën, se mos edhe shteti polak mund të pësojë një shpërbërje të ngjashme, e ka vetëm një pakicë e vogël në popullsinë polake.

Si marrës neto i subvencioneve Ju nuk jeni i interesuar, që për shkak të anëtarësimeve të tjera në BE të shkurtohen fondet e ndërtimit të strukturave dhe fondet e sektorit të bujqësisë për vendin Tuaj. Ju shpresoni të përshpejtoni procesin e modernizimit dhe të rimëkëmbjes pikërisht nëpërmjet këtyre fondeve, ndaj edhe nuk jeni i gatshëm të hiqni dorë prej tyre. Kostot, që do të lindin nga zgjerimi i ardhshëm, duhet të merren përsipër nga shtetet anëtare të BE që kanë mirëqenien më të madhe dhe jo nga shtetet më të varfëra, duke iu shkurtuar atyre subvencionet. Për këtë strategji Ju mund të bëni për vete me siguri të gjitha shtetet e reja anëtare nga Evropa Qendrore dhe Lindore, dhe, si shteti më i madh mes tyre, të bashkoni interesat Tuaja. Por aleatë potencialë mund të jenë edhe marrësit e tjerë të subvencioneve neto në ekonominë bujqësore si Franca, Spanja, Portugalia, Greqia dhe të tjerë.

Zgjerimet e ardhshme nuk duhet të çojnë në humbje të peshës Suaj brenda institucioneve të BE-së. Së bashku me Spanjën, që ka po aq banorë sa Polonia, Ju e konsideroni veten ndër shtetet me madhësi mesatare por me shumë ndikim në BE. Për këtë arsye Ju kërkoni të bëni të dështojnë të gjitha ato përpjekje, që synojnë që fazat e ardhshme të zgerimit të shoqërohen me reforma të institucioneve, që më pas do të çonin në rruhdhjen e rolit Tuaj. Nuk duhet të ndodhë, që katër kombet e mëdha, pikërisht Britania e Madhe, Franca, Gjermania dhe Italia të vendosin për shtetet e mesme dhe të vogla.

Për këto probleme Ju mund të shpresoni në miratimin e gjerë të një numri të madh shtetesh anëtare.

Portugalia (República Portuguesa)

Kryeqyteti:	Lisbonë
Forma shtetërore:	Republikë
Sipërfaqja:	92.345 km ²
Banorë:	10.589.000
PBB/banor:	17.850 US-Dollar
Rritja ekonomike:	1,3 %
Papunësia:	8,0 %
Gjuhët:	Portugalisht
Besimet fetare:	89 % katolikë, protestantë, muslimanë dhe pakica hebreje
Grupe etnike:	97,8 % portugezë
Anëtar i Kom.Evr. /BE:	1986
Kryetar shteti:	Anibal Cavacol Silva
Kryetar qeverie:	Luis Amado
Informacione të tjera:	www.botschaftportugal.de

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni përfaqësues/e i/e Portugalisë në Këshillin e Bashkimit Evropian. Vendi Juaj është bërë anëtar i BE në vitin 1986. Pak pas raundit të fundit të zgjerimit të vitit 2004 Ju përballeni edhe njëherë me vendimmarrjen rreth kërkesave për anëtarësim të kandidatëve të tjerë.

Portugali në BE

Portugalia, një ndër shtetet më të vjetra evropiane, e ka bërë kërkesën e saj për anëtarësim në BE që në vitin 1977. Fakti që kjo u bë e mundur vetëm në vitin 1986 ka patur për arsye lidhjen e pranimit Portugalisë me anëtarësimin e Spanjës dhe që bisedimet me Spanjën zgatën më shumë nga ç'ishte parashikuar.

Anëtarësimi në BE e ndihmoi Portugalinë në një zgjerim të shpejtë të strukturave demokratike në këtë vend, i cili kishte vuajtur nën diktaturën e Salazarit dhe të trazirave që pasuan. Përmes reformash të shumta politike dhe ekonomike si dhe falë strukturave mbështetëse të BE Portugalia pati sukses në konsolidimin e ekonomisë së saj që prej anëtarësimit në BE, edhe pse ende konstatohet një nevojë për të rekuperuar diçka si dhe ekzistojnë dallime mes zonave urbane dhe rurale.

Në vitet e para të anëtarësimit të saj BE është parë shpesh me skepticizëm nga portugezët si dhe është bërë përgjegjës për pasojat negative në tregtinë agrare dhe për shifrat në rritje të papunësisë. Shpesh në kuadër të debatit europolitik dilnin në plan të parë vështirësitë e politikës së brendshme. Megjithatë vitet e anëtarësisë së Portugalisë në BE kanë çuar në një orientim më të fuqishëm drejt Evropës. Preidenca e Këshillit në vitin 2000, vënia në përdorim e Euros dhe emërimi i ish-Kryeministrit José Manuel Barroso në postin e Kryekomisionerit e përforcojnë më tej këtë linjë zhvillimi. Gjithsesi në politikën portugeze rëndësi prioritare vazhdojnë të ruajnë edhe marrëdhëniet trans-atlantike.

Veç, kësaj Portugalia kujdeset për marrëdhënie të mira me Spanjën, e cila ndër të tjera luan një rol të rëndësishëm ekonomik për vendin, njësoj sikurse Gjermania. Marrëdhënie të ngushta ka edhe me Britaninë e Madhe dhe Francën, vendin ku jetojnë pjesa më e madhe e portugezëve jashtë vendit. Dhe tradicionalisht Poportugalia, nisur nga pozita e vet gjeografike, ka marrëdhënie të mira me shtete afrikane, sikurse është Maroku.

Portugalia dhe zgjerimi

Portugalia e konsideron procesin e zgjerimit si një kusht paraprak për stabilitetin dhe progresin mbarëevropian, por në të njëjtën kohë nuk është se e konsideron veten si motor të zgjerimit. Njësoj e rëndësishme për Portugalinë është edhe çështja e bashkëpunimit me të gjitha vendet e Mesdheut – edhe ata të Afrikës veriore.

Ashtu sikurse dikur BE ishte për Portugalinë çelësi i stabilitetit politik dhe ekonomik, të njëjtat të drejta ajo ia njeh tanimë në thelb edhe demokracive të reja në Ballkan. Nisur nga përvoja e vet, kur anëtarësimi i saj në BE ishte i lidhur me atë të Spanjës dhe kjo çoi në vonesa të pakëndshme, Portugalia shprehet për një anëtarësim fleksibël të vendeve aktuale që aspirojnë anëtarësimin, duke e kushtëzuar këtë vetëm me progreset përkatëse të çdo vendi, në mënyrë që këta të mund të bëhen anëtarë të BE pa u dashur të presin të „vonuarit“.

Zgjerimi nuk duhet të rëndojë thellimin e synuar të Bashkimit Evropian në një Union politik. Inventari aktual komunitar (acquis communautaire) duhet të vazhdojë të ruhet në masë të plotë. Për qeverinë portugeze duket të jetë më e rëndësishme të heqë dorë nga anëtarësimet se sa të rrezikojë arritjet e Unionit prej 27 shtetesh anëtare. Portugalia ka frikë se mos me zgjerimin e ardhshëm drejt Lindjes interesi i BE për zonën e Mesdheut do të bjerë dhe kontributet mbështetëse financiare do të rrjedhin më shumë në drejtim të Lindjes. Këtë Portugalia kërkon me çdo kusht ta shmangë, pasi kuptohet që ajo vazhdon të jetë e interesuar të përfitojë nga fondet e strukturave të BE dhe të mos humbë shumë peshë në institucionet evropiane për shkak të zgjerimit.

Por duke qenë se Portugalia deklarohet kundër një „egoizmi afatshkurtër“, ajo është e gatshme të gjejë kompromise pa lënë pas dore plotësisht interesat e veta.

Portugalia e ka marrë vonë vendimin e njohjes së pavarësisë së Kosovës. Kjo shihet si një kontribut në stabilitetin e rajonit të Ballkanit. Në këtë çështje Portugalia ka dalë nga hija e vendit të saj fqinjë, Spanjës, e cila refuzon të njohë pavarësinë e Kosovës.

Taktika:

Ju jeni përfaqësues/ e i/e Portugalisë. Në këtë funksion Ju keni qenë mbështetës i zgjerimit të fundit në drejtim të Lindjes dhe në parim, edhe në rastin e zëgjërimeve të ardhshme, jeni për pranimin afatgjatë të kandidatëve për anëtarësim. Ju nuk doni të bllokoni vendimet e nevojshme në këtë kontekst e megjithatë sillni në vëmendje, që BE nuk duhet të zgjerohet me çdo kusht. Ndaj tregoni bindjen Tuaj për vlera të tilla si solidariteti, barazia dhe liria, të cilat duhet të vlejnjë edhe për politikën e zgjerimit.

Por mos harroni gjithashtu edhe interesat Tuaja vitale: Ju duhet të vazhdoni të merrni mbështetje financiare nga BE, që do të thotë se zgjerimi duhet të financohet nga rritja e buxhetit evropian. Përpiquni që të krijoni aleanca me vende të tjera jugore anëtare të BE që kanë interesa të ngjashme me Ju, dhe të garantoni në këtë mënyrë që drejt Portugalisë

do të rrjedhin subvencione të tjera nga fondet strukturore të BE. Mbështetjen e fqinjëve Tuaj jugorë do ta gjeni edhe në kuadër të politikës evropiane për Mesdheun.

Krahas kësaj Ju luftoni edhe për një thellim të vazhdueshëm të integritit politik të Unionit, gjë që mund të ketë sukses e lidhur me zgjerimin vetëm, nëse institucionet evropiane do të reformohen dhe bëhen më operative. Ndaj sillni në vëmendje faktin, që vetëm një Evropë e qëndrueshme e 27 anëtarëve mund të jetë një Evropë e qëndrueshme edhe për shtete të reja anëtare.

Kur këto interesa elementare të vendit Tuaj të jenë të garantuara, atëherë mund të deklaroheni si një mbështetës i qartë dhe aktiv i zgjerimit. Kërkoni edhe kontakte dypalëshe me vendet që aspirojnë anëtarësimin dhe tregoni gatishmërinë Tuaj për bashkëpunim.

Ju e mbështesni dhe përkrahni anëtarësimin e Turqisë në BE. Evropa, në gjykimin Tuaj, nuk duhet të konceptohet si një „shoqatë e krishterë“, dhe Ju nuk mund t'i kuptoni argumentat kulturorë apo fetarë kundër anëtarësimit të Turqisë.

Përpiquni të vendosni marrëdhënie me Turqinë dhe vende të tjera anëtare që e shohin pozitivisht anëtarësimin e saj, për të mbështetur kështu pranimin e Turqisë në Bashkimin Evropian.

Suedia (Sverige)

Kryeqyteti:	Stockholm
Forma shtetërore:	Monarki konsitucionale
Sipërfaqja:	449.364 km ²
Banorë:	9.084.000
PBB/banor:	43.530 US-Dollar
Rritja ekonomike :	4,2 %
Papunësia:	6,2 %
Gjuhët:	suedisht, finlandisht, samisht, anglisht dhe gjermanisht
Besimet fetare:	77 % evangjelistë kisha shtetërore luteriane, 1,4 % muslimanë, 0,9% katolikë
Grupet etnike:	92,2 % suedeze, pothuaj 3 % finlandezë dhe rreth 20.000 samezë
Anëtar i BE/Kom.Evr.:	1995
Kryetar shteti:	König Carl Gustav XVI.
Kryetare qeverie:	Frederik Reinfeldt
Insformacione të tjera:	www.schweden.org

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni përfaqësues/e i/e Suedisë në Këshillin e Bashkimit Evropian. Vendi Juaj është anëtar i BE që prej vitit 1995. Pasi keni marrë pjesë në bisedimet rreth raundit të fundit të zgjerimit në drejtim të Lindjes, gjatë të cilit u pranuan dymbëshjetë shtete të reja anëtare, Ju përballeni tani me kërkesat për anëtarësim të vendeve të tjera të Evropës Lindore dhe Juglindore.

Suedia në BE

Në pikëpamje historike Suedia ka qenë që në shek. XIX një vend, që kryesisht ka qëndruar larg zhvillimeve politike të kontinentit evropian. Përmes „politikës së gjatë të neutralitetit“ vendi ka patur një periudhë të gjatë paqeje, që çoi në përfundimin që lidhja dhe përfshirja e Suedisë me Bashkimin Evropian në fakt nuk është e nevojshme. Evropa në sytë e popullit suedez duhet të mbetet vetëm një kontinent i tregtisë së lirë mes shtetesh sovranë. Një politikë inetsive e përbashkët me shtetet drejtpërsëdrejti fqinje u bë realitet në vitin 1952 me formimin e „Këshillit Nordik“, ku u arritën avantazhe të prekshme dhe praktike për qytetaret dhe qytetarët (si p.sh. tregu i përbashkët i punës).

Traktati i Maastrihit (1993), kthesa e madhe në Evropën Lindore dhe Qendrore, si dhe marrëdhëniet tregtare gjithnjë e më të ngushta mes Suedisë dhe BE çuan në një orientim të ri të politikës evropiane të Suedisë. Më 1 janar 1995 Suedia u bë anëtare e Bashkimit Evropian. Ndërsa dy referendumet për anëtarësimin në Unionin Ekonomik dhe Monetar, zhvilluar më 2003 dhe 2006, patën rezultat negativ, kështu që vendi nuk mundi të vinte në përdorim monedhën e euros. Ky është një tregues që popullsia suedeze nuk ka hequr dorë nga pozicioni i saj kritik lidhur me BE.

Interesi suedez për anëtarësimin në BE drejtohet në radhë të parë nga mundësia e shfrytëzimit të aksesit të tregjeve ndërkombëtare, duke krijuar kështu bazën për rritje ekonomike, punësim dhe mirëqenie. Veç kësaj suedezët janë shumë krenarë për arritjet e modelit të tyre social, standardet në mbrojtjen e mjedisit dhe stilin transparent të qeverisjes së vendit. E gjitha kjo nuk duhet të vihet në rrezik nga politika evropiane. Ndaj edhe sektorët kyç të politikës evropiane të Suedisë janë politikat e punësimit dhe rritjes ekonomike, barazia gjinore, mbrojtja e mjedisit dhe e konsumatorit si dhe transparenca, legjitimimi demokratik dhe sjellja e qytetarëve afër institucioneve evropiane.

Suedia dhe raundi i ardhshëm i zgjerimit

Qëllimi më i rëndësishëm që e lidh Suedinë me zgjerimin e fundit, pikërisht shansi historik i pranimit në BE të fqinjëve të saj balltikë dhe partnerëve në fushën e tregtisë, u përmbush më 1 maj 2004. Megjithë disa rezerva të caktuara Suedia e ka mbështetur qartë mbarë procesin e fundit të zgjerimit gjatë Presidencës së saj të vitit 2001 dhe edhe tani është e hapur për vijimin e kësaj politike aktive zgjerimi. Argumenti kryesor është që forca tërheqëse e BE do të sjellë progres demokratik, ekonomik dhe social në vendet kandidate. Gjë që nga ana tjetër do të ketë një efekt pozitiv në situatën e sigurisë në Suedi dhe mbarë Evropën.

Veç kësaj për Suedinë është shumë e rëndësishme partneriteti i ngushtë me Rusinë, kushtëzuar kjo nga arsye historike dhe gjeografike. Me pranimin e shteteve të tjera evropiano-lindore Qeveria garanton një impuls të ri për marrëdhëniet BE-Rusi.

Qeveria suedeze, megjithë përkrahjen e procesit të zgjerimit me shtete të Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë është një mbrojtëse e aplikimit strikt të Kriteve të Kopenhagenit si kusht për anëtarësimin. Ato duhet të jenë njësi matëse për të parë, nëse vendi është i aftë për hyrjen apo jo. Suedia ngurron në këtë kontekst veçanërisht në lidhje me ruajtjen e standardeve sociale dhe mjedisore në shtetet anëtare, në mënyrë që të mund të kundërveprojë në rastin e rrezikimit të modelit social suedez për shkak të zgjerimit.

Vitet e fundit Suedia është angazhuar gjithnjë e më shumë në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe e sheh veten si avokate të shteteve të ish-Jugosllavisë. Për qeverinë Suedeze ka qenë e vetëkuptueshme njohja e pavarësisë së Kosovës vetëm pak ditë pas shpalljes së saj. Në të njëjtën kohë Suedia është shumë e interesuar që raporti mes Kosovës dhe Serbisë së shpejti të normalizohet.

Po kështu qeveria suedeze përdor emrin kushtetues të Maqedonisë, duke hequr dorë - dhe duke inatosur kështu kolegët grekë - nga termi zyrtar i Kombeve të Bashkuara. Suedia gjykon që Republika e Maqedonisë ka drejtë ta përcaktojë vetë emrin e saj kushtetues.

Suedia ka hartuar një strategji kombëtare për të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, për t'iu ndihmuar këtyre vendeve në ndërtimin e ekonomisë, sistemit ligjor dhe atij të drejtësisë.

Së bashku më Francën, Suedia është angazhuar për një qarkullim pa viza në shtetet e Schengen-it. Por kjo nuk është realizuar ende, pasi në mënyrë të veçantë Greqia është kundër heqjes së vizave për qytetarët dhe qytetarët e Republikës së Maqedonisë, për sa kohë nuk është sqaruar debati rreth emrit.

Si një kontribues i fuqishëm i Unionit Suedia ka frikë se do t'i duhet të mbajë një pjesë mbiproporcionale të kosotove të zgjerimit, ndaj edhe ngul këmbë në një kufizim të qartë të kuadrit financiar, përpara se të pranohen anëtarë të rinj.

Taktika:

Si përfaqësues/e i/e Suedisë Ju në përgjithësi e mbështesni pranimin e anëtarëve të rinj në BE. Lidhur me shqetësimin e popullsisë Suaj, disi kritike ndaj BE, Ju i vini disa kushte të caktuara pëlqimit Tuaj. Më i rëndësishmi për Ju është që kandidatët për anëtarësim të garantojnë përmbushjen e Kriteve të Kopenhagenit dhe respektimin e standardeve sociale dhe mjedisore si dhe t'i bëjnë të qarta këto përpjekje. Argumentoni duke thënë, që zgjerimi që Ju përkrahni dhe kërkon të çoni përpara, nuk duhet realizuar në atë mënyrë që të shkatërrojë sistemin social evropian dhe veçanërisht atë suedez.

Po kështu duhet garantuar që transparenca dhe legjitimitimi demokratik i aparatit vendimmarrës evropian të mund të ruhen dhe forcohen edhe pas zgjerimit. Në fund Ju kërkon në rrethin e shteteve anëtare aktuale, që të kufizohen në mënyrë kontraktuale kostot e zgjerimit si dhe të reformohet politika agrare e Unionit, e cila është shumë e kushtueshme, përpara se të anëtarësohen vende të reja me profil të qartë bujqësor.

Në Ballkan Ju shihni një lidhje të qartë mes perspektivës evropiane dhe një përshtetimi të procesit të stabilizimit dhe të reformimit. Ju mbështesni idenë e përgatitjes së integritimit të këtij rajoni në strukturat evropiane në mënyrë paralele me masat për stabilizimin e rajonit. Kjo nuk duhet të ndodhë domosdoshmërisht përmes anëtarësimit në BE, por mund të marrë edhe formën e partneriteteve të veçanta. Kush paraprak i domosdoshëm është gjithësi gatishmëria absolute e këtyre vendeve për të përmbushur kriteret e BE. Edhe Turqinë Ju e masni njësoj si kandidatët e tjerë: nëse vendi plotëson kriteret dhe çon përpara në mënyrë konsekuente procesin e reformave, Ju jeni për hapjen e bisedimeve të anëtarësimit. Nga kjo Ju prisni një shenjë pozitive dhe kërkon të nxisni për realizimin e reformave të vendosura tashmë. Gjithësi edhe përkundrejt Turqisë Ju e bëni të qartë që përpara anëtarësimit faktik ka ende shumë probleme për t'u zgjidhur, para së gjithash ato që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, të drejtat e gruas, heqjen e torturës dhe situatën e kurdëve.

Edhe pse e kuptoni pozicionin e Maqedonisë në debatin për emrin, përpiquni të ndërmjetësoni me dy shteteve, pasi vetëm një kompromis mes dy shteteve mund të bëjë të mundur, që Greqia të japë miratimin e nevojshëm për integrimin e Maqedonisë në BE. Në përgjithësi, në përcaktimin e strategjisë Suaj të bisedimeve, Ju duhet të mbani parasysh që jeni i varur nga mmbështetja dhe bashkëpunimi me shtetet e tjera ndaj edhe duhet të jeni i gatshëm për të bërë kompromise. Zbuloni fillimisht cilat shtete kanë interesa të ngjashme me Ju dhe më pas përpiquni të procedoni së bashku.

Sllovenia [Slovenija]

Kryeqyteti:	Ljubljana (246.000 banorë)
Forma shtetërore:	Republikë, demokraci parlamentare
Sipërfaqja:	20.253 km ²
Banorë:	2,007 Mio.
PBB / banor:	18.660 US-Dollar
Rritja ekonomike:	5,2 %
Papunësia:	4,9 %
Gjuhët:	sllovenisht
Besimet fetare:	vlerësohet: katolikë rreth 57,8 %, ortodoksë rreth 2,3 %, muslimanë 2,4 %, protestantë 0,9 %
Grupe etnike:	Sllovenë 83,6 % Pakica autoktone: hungarezë rreth 6.243, italianë rreth 2.258, grupe të tjera popullsie: kroatë rreth 35.642, serbë/malazez rreth 38.964/2.667, boshnjakë rreth 21.542, maqedonas rreth 3.972, shqiptare rreth 6.186, romë rreth 3.246, gjermano-folës rreth 680.
Anëtar i BE:	1. maj 2004
Kryetar shteti:	Dr. Danilo Türk
Kyetar qeverie:	Borut Pahor
Informacione të tjera:	vdm@mzz.dkp.gov.si

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni përfaqësues i Sllovenisë në Këshillin e Bashkimit Evropian. Që prej 1 majit 2004 vendi Juaj është anëtar i BE. Në këtë funksion qeveria Juaj përballet me vendimmarrjen për një raund të ri zgjerimi të Komunitetit.

Sllovenia në BE

Orinetimi i Sllovenisë drejt Evropës Perëndimore është mbështetur që prej shpalljes së pavarësisë nga të gjitha grupimet shoqërore të rëndësishme në vend. Sllovenia ka qenë edhe më parë anëtare e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, si p.sh., e OKB, Këshillit të Evropës, Bankës Botërore, Komunitetit Alpe-Adriatik dhe të Iniciativës së Evropës Qendrore (një bashkim shtetesh të ndryshme të Evropës Qendrore).

Përkatësia në Evropë dhe objektivi i përfshirjes në strukturat euro-atlantike bëjnë pjesë në kolonat kryesore të politikës së jashtme të Sllovenisë që prej shpalljes së pavarësisë. Për këtë arsye vendi ka ndërmarrë në nëntor 1998 bisedime të njëkohshme me Poloninë, Hungarinë, Republikën Çeke, Estoninë dhe Qipron. Këto bisedime patën një përfundim të suksesshëm në Samitin e Kopenhagenit në dhjetor 2002. Popullsia sllovene mbështeti anëtarësimin në BE me një shumicë dërrmuese prej pothuaj 90% gjatë referendumit të datës 23 mars 2003. Duke u bërë anëtare e Bashkimit Evropian Sllovenia ka mundur të përmirësojë marrëdhëniet më parë të rënduara me Italinë.

Si drejtim kryesor të politikës së vet evropiane vendi konsideron marrëdhëniet e Komunitetit me vendet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë kontekst vendi u kushton rëndësi të veçantë bisedimeve me vendet e reja candidate.

Pozicioni i Sllovenisë në raundin aktual të zgjerimeve

Sllovenia e konsideron procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian ende të papërfunduar edhe pas pranimit të dhjetë anëtarëve të rinj më 1 maj 2004 dhe zgjerimit vijues me Bullgarinë dhe Rumaninë, dhe kërkon madje vijimësinë e opsioneve të anëtarësimit për vende ende të paanëtarësuar dhe që aspirojnë anëtarësimin. Vazhdimi i zgjerimit shihet si garant për një mirëqenie dhe stabilitet të qëndrueshëm të të gjithë kontinentit.

Duke ndjekur logjikën e këtij toni miqësor me zgjerimin Sllovenia është e hapur edhe për hapjen e bisedimeve të anëtarësimit me Turqinë.

Por gjithsesi interesi kryesor dhe shumë i qartë i Sllovenisë në raundet e ardhshme të zgjerimit është për Ballkanin Perëndimor. Angazhimi për këtë rajon është i kushtëzuar si në pikëpamje gjeografike ashtu edhe në atë historike. Duke qenë drejtpërsëdrejti fqinjë dhe në kufi me vatrën e krizave të shteteve të Ballkanit çdo instabilitet i rajonit paraqet rrezik edhe për vetë Slloveninë. Kështu ekziston frika që pas tërheqjes së trupave të EUFOR-it mund të fillojnë sërish konflikte të armatosura mes palëve në konflikt. Megjithë përpjekjet për t'u distancuar nga provincat e përfshira në trazira, Sllovenia si ish-republikë e Jugosllavisë së dikurshme është e lidhur ngushtë historikisht me këtë rajon. Fakti që ky vend ka qenë i pari, dhe deri më tani i vetmi, në të gjithë rajonin që është bërë anëtar i BE, mbart një përgjegjësi të caktuar për zhvillimin e mëtejshëm të vendeve të Ballkanit dhe përafrimin e tyre me BE. Kësaj përgjegjësie për fqinjët e saj të drejtpërdrejtë Sllovenia i del për zot duke marrë pjesë në mënyrë aktive në Paktin e Stabilitetit për Ballkanin, duke mbështetur bashkëpunimin politik në sektorin bilateral dhe, jo pak, duke zgjeruar marrëdhëniet e bashkëpunimit ekonomik. Duke qenë se raportet në tregjet rajonale tradicionale të Sllovenisë janë stabilizuar, edhe tregtia me vendet fqinje, veçanërisht me Kroacinë, ka bërë përpara më ritme të shpejta. Në kuadër të këtij zhvillimi dhe pas përfundimit të epokës Tuxhman është përmirësuar në mënyrë të ndjeshme raporti pjesërisht problematik me vendin fqinjë Kroacinë, edhe pse konfliktet e vjetra kufitare aty këtu rindizen. Sllovenia sot përpiket përgjithësisht për një pranim të shpejtë të Kroacisë në BE.

Gjithsesi tema më e rëndësishme për Ju do të jetë pavarësia e rregullt e Kosovës dhe përafrimi i Serbisë dhe shteteve të tjera të Ballkanit me BE.

"Ne në Slloveni besojmë, që ka ardhur koha që kriza jugosllave të mbarojë", kjo është motoja Juaj. Kriza ka filluar më 1991 kur Presidenti i atëhershëm Slobodan Milosevic sulmoi Slloveninë. Tanimë zgjidhja do të mund të ishte përfshirja e shteteve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian dhe zgjerimi i BE sikurse u vendos edhe në Samitin e Selanikut në Greqi 2003. Në Selanik BE u premtoi qartë të gjitha shteteve të Ballkanit pranimin në BE.

Qeveria sllovene është optimiste për mundësinë e pengesës së një ndarjeje të BE në lidhje me njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe se Kosova do të njihet nga të 27 shtetet anëtare të Unionit si shtet i pavarur në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Në gjykimin Tuaj duhet pranuar realiteti që zotëron në Ballkanin Perëndimor. Qipro ngurron pasi kjo mund të shihej në BE si një rast precedent për fatin e veriut të Republikës-ishull

zënë nga turqit. Por Sllovenia do të bëjë ç'është e mundur për të bindur, që Kosova „është një rast krejtësisht më vete“.

Qeveria sllovene ndjek në tërësi katër linja kryesore tematike: të ardhmen e BE, zgjerimin dhe politikën e fqinjësisë (prioritare: Kosova dhe Ballkani Perëndimor), mbrojtja e klimës dhe energjisë dhe dialogu ndërkulturor.

Taktika:

Si përfaqësues/e i një vendi të vogël anëtar si Sllovenia ju jeni mbrojtës i vijimit të praktikës evropiane të zgjerimit, që sipas mendimit Tuaj është pozitive jo vetëm për kandidatët e rinj por edhe për BE aktuale, përsa i përket paqes, lirisë dhe stabilitetit.

Në pikëpamje gjeografike, për Ju stabilizimi i të gjithë Ballkanit ka prioritet absolut. Parashtroni argumentin, që ekzistenca e vazhdueshme e një vatre konflikti dhe krize direkt përpara portave të BE do të kërcënonte shtetet anëtare jo vetëm në sigurinë dhe lirinë e tyre por edhe në besueshmërinë e tyre si aktorë ndërkombëatër. Duke qenë se përvoja ka treguar që hapja e një perspektive evropiane ushtron një forcë të jashtëzakonshme motivuese në përpjekjet e vendeve kandidate për paqe dhe reforma, Ju përkrahni idenë e një mbështetjeje aktive të përafritit të Ballkanit me BE. Apeloni në këtë kontekst përgjegjësinë e BE kundrejt vendeve direkt fqinje dhe sillni në vëmendje objektivin evropian të përhapjes paqësore të vlerave dhe normave të demokracisë dhe lirisë.

Konkretisht kjo do të thotë për Ju që anëtarësimi i vendit më të përparuar të rajonit Kroacisë duhet realizuar sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që t'u dërgohet një sinjal edhe vendeve të tjera të Ballkanit. Në terma afatgjatë Ju mbështesni zgjerimin e BE me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor që synojnë anëtarësimin dhe që tani Ju kërkoni miratimin e një katalogu kriteresh për pranimin e këtyre shteteve.

Si përfaqësues/e i/e një vendi të vogël Ju bëni përpjekje për të fituar mbështetjen e shteteve të tjera anëtare për pozicionin Tuaj. Krahas kësaj Ju përpiqeni të bëni për vete edhe Gjermaninë – e cila ka luajtur një rol drejtues për njohjen e Kroacisë dhe Sllovenisë pas shpërbërjes së Jugosllavisë – në mënyrë që të bëhet i mundur anëtarësimi sa më i shpejtë i Kroacisë.

Sllovenia ishte vendi i parë në Ballkan, që e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Ju punoni për një njohje sa më të shpejtë të Kosovës nga të gjitha shtetet e BE si dhe kërkoni hapjen e bisedimeve rreth antarësimin të këtij vendi në BE.

Edhe pse në vitin 1991 Ju keni vuajtur shumë nën sulmin e Serbisë, e cila kërkonte të pengonte shpalljen e pavarësisë nga Sllovenia, Ju angazhoheni edhe për anëtarësimin e një Serbie moderne dhe të reformuar. Gjithsesi Serbia duhet të pranojë ekzistencën e një Kosove të pavarur.

Me Republikën e Maqedonisë Ju lidh një miqësi e vjetër. Natyrisht që Ju e keni njohur atë me emrin e vet kushtetues dhe kërkoni që këtë gjë ta bëjnë edhe shtetet e tjera anëtare të BE. Duke patur parasysh situatën ekonomike në Bullgari dhe Rumani, në gjykimin Tuaj Republika e Maqedonisë është prej kohësh gati për anëtarësim, dhe – ashtu si vendet e veta fqinje – i plotëson të gjitha kushtet paraprake për anëtarësimin.

Krahas angazhimit Tuaj në nivel Evropian Ju, duke e konsideruar veten si ndërmjetës, kërkoni të vendosni kontakt me vendet kandidate për anëtarësim. Ofroni përvojën Tuaj në rrugën e integritit evropian dhe t'i mbështesni ato me fjalë e me vepra. Kjo ofertë nuk vlen vetëm për Kroacinë po edhe për Turqinë, anëtarësimin e cilës Ju e mbështesni edhe pse vëmendja Juaj kryesore është përqendruar tek fqinjët e drejtpërdrejtë.

Britania e Madhe dhe Irlanda e Veriut (Great Britain)

Kryeqyteti:	Londra (rreth 7,3 mil banorë) (shifrat të 2004)
Forma shtetërore:	Monarki parlamentare me Sistem Dy-Dhomësh
Sipërfaqja:	242.900 km ²
Nr. i banorëve:	60,950 mil. (2003)
PBB/banor:	37.740 US-Dollar
Rritja ekonomike:	2,8 %
Papunësia:	5,3 %
Gjuhët:	anglisht (gjuha zyrtare), krahas kësaj: irlandisht, „scots”, skocezë, dialekt i Uellsit
Besimet fetare:	anglikanë 57 %, protestantë të tjerë 15 %, kaolikë 13 %, muslimanë 2%
Grupe etnike:	81.5 % anglezë; 9.6 % skocezë; 2.4 % irlandezë; 1.9 % uellsezë; 1.8 % ulstezë; 2.8 % indianë, pakistanezë etj.
Anëtar i Kom.Evr./BE:	1973
Kryetar shteti:	Mbretëresha Elisabeth II.
Kryetar qeverie:	Gordon Broën
Informacione të mëtejshme:	www.britischebotschaft.de

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni përfaqësues/e i/e Britanisë së Madhe në Këshillin e Bashkimit Evropian. Në këtë funksion menjëherë pas pranimit të dymbëdhjetë shteteve të reja anëtare nga Evropa qendrore dhe Lindore Ju përballeni sërish me vendimmarrjen për kërkesa të tjera anëtarësimi në BE.

Britania e Madhe në BE

Britania e Madhe u anëtarësua në vitin 1973 në BE-në e atëhershme, pasi me tërheqjen nga politika të Presidentit francez De Gaulle edhe Franca hoqi dorë nga rezistenca e saj e ashpër ndaj anëtarësimit të vendit fqinj. Ky qëndrim bllokues i francezëve bazohej në frikën, se Mbretëria e Bashkuar nuk do të identifikohet sa duhej me bashkimin evropian.

Dhe në fakt interesat e Britanisë së Madhe, duke u nisur nga roli i saj i dikurshëm si fuqi koloniale dhe nga marrëdhëniet me shtetet dikur të kolonializuara prej saj, janë të përmasave globale dhe nuk përqendrohen vetëm në Evropë. Ndaj në të shkuarën Britania e Madhe ka luatur shpesh një rol politik të dyfishtë apo izolacionist përkundrejt BE-së. Ajo e shikonte kuptimin e integritit evropian para së gjithash në fushën ekonomike, ndërsa integritimin e mëtejshëm politik – që lidhej me dorëzimin e sovranitetit shtetëror institucioneve mbikombëtare të BE-së – e gjykonte me skepticizëm. Megjithëse politika e BE-së për Britaninë e Madhe ka marrë ndërkohë një prioritet të lartë, ka edhe interesa të tjera, si p.sh. aleanca e ngushtë me SHBA-të që është gjithashtu një kolonë kryesore e politikës së jashtme britanike.

Me fillimin e qeverisjes së Tony Blair Britania e Madhe shton përpjekjet për tu shndërruar në një partner me rol udhëheqës në BE, i cili duhet të merret seriozisht, si dhe

angazhohet për një Evropë paqësore dhe demokratike të stabilitetit dhe mirëqenies. Ky angazhim i tij pozitiv konsiderohet si rruga më e mirë për mbrojtjen e interesave kombëtare, për rifitim të ndikimit të humbur, për ndërtimin e një të ardhmeje të begatë së bashku me shtetet e tjera anëtare si dhe për përfitimin e më të mirës për vetë vendin. Në BE Britania e Madhe punon dhe angazhohet për realizimin e reformave ekonomike, të cilat përmes liberalizimit të tregut, privatizimit dhe drejtësisë sociale dotë ndihmojnë të krijojnë mundësi të reja punësimi si dhe do të sjellin risi në vend. Britania e Madhe është gjithashtu e interesuar për zgjerimin e Politikës së Përbashkët në Punët e Jashtme dhe Çështjet e Sigurisë si dhe të Politikës së Përbashkët të Mbrojtjes. Por kjo duhet të realizohet në nivel ndërshtetëror duke mos dëmtuar aleancat e tjera, para së gjithash NATO-n.

Britania e Madhe dhe zgjerimi i ardhshëm

Zgjerimet e Bashkimit Evropian Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar i vlerëson si një shans të madh historik dhe mundësi zhvillimi për vendet, që aspirojnë anëtarësimin, dhe po në të njëjtën masë edhe për vendet anëtare të BE-së. Britania e Madhe ka mbështetur edhe zgjerimet e fundit të datës 1 maj 2004 dhe 1 janar 2007.

Britania e Madhe mban një qëndrim përgjithësisht të hapur edhe përkundrejt zgjerimeve të ardhshme dhe propagandon „fair play“ në lidhje me çështjet e zgjerimit, me fjalë të tjera: çdo vend duhet të gjykohet individualisht dhe objektivisht mbi bazën e progresit të bërë në përmbushjen e Kriteve të Kopenhagenit. Britania e Madhe shpreson në mënyrë të veçantë, që përmes anëtarësimeve të reja në BE të vendoset paqja dhe stabiliteti, pra të ketë garanci ndaj trazirave dhe luftrave, sikurse këtij rajoni iu desh të përjetonte në vitet nëntëdhjetë.

Për arsye kryesisht strategjike Britania e Madhe mbështet në parim edhe anëtarësimin e Turqisë. Por sipas vlerësimeve britanike do të duhet të kalojnë edhe të paktën 20 vjet deri në anëtarësimin e vërtetë të këtyre vendeve, pasi ato nuk mund të plotësojnë ende në një pjesë të madhe kushtet paraprake politike, ekonomike dhe ligjore.

Britania e Madhe përshëndet pavarësinë e Kosovës dhe në të njëjtën kohë thekson se edhe për përafrimin e Kosovës me BE-në duhet të vlejnjë të njëjta rregulla sipas Kriteve të Kopenhagenit. Por kështu Serbia nuk duhet izoluar për shkak të politikës së saj të jashtme në lidhje me pavarësinë e Kosovës.

Në mënyrë shumë të qartë, madje më me forcë se Gjermania apo Italia, Britania e Madhe mbështet Republikën e Maqedonisë në përpjekjet e saj për njohjen e emrit të vet kushtetues. Ju nuk keni as mirëkuptimin më të vogël për pozicionin grek në kuadër të debatit për emrin. Por në të njëjtën kohë Ju nuk doni të izoloni Greqinë, pasi për çdo fazë tjetër zgjerimi kërkohet edhe miratimi i Greqisë. Gjithsesi pas skene përpiqeni që të fitoni ndikim nga një pozicion force.

Në përgjithësi duhet patur në konsideratë që Qeveria Laburiste me këtë qëndrim të vetin proevropian nuk e ka gjithmonë të lehtë të vërë pikat mbi „i“ në nivelin e politikës së brendshme. Politika për Evropën (nëse nuk vendoset në një kontekst ekonomik) ka pak vlerë dhe rëndësi për Britaninë e Madhe. Pjesë të konsiderueshme të popullsisë janë skeptikë kundrejt BE-së ose krejtësisht të painteresuar për të. Argumntat e Toveis konservativ kundër futjes në përdorim të euros apo kundër Kushtetutës së BE-së gjejnë tokë pjellore. Kështu qeverisë i duhet t'i demonstrojë popullsisë së vet në mënyrë të besueshme, se cilat janë avantazhet e politikës për Evropën. Kjo do të thotë që nga njëra

anë duhet të shmangë mundësisht ngritjen e kontributit të saj në buxhetin e BE-së, dhe nga ana tjetër bën kujdes të mos krijojë përshtypjen se është duke i lëshuar Brukselit pjesë të sovranitetit të vet shtetëror në sektorë të rëndësishëm për nga pikëpamja strategjike.

Taktika:

Si përfaqësues/e i/e Britanisë së Madhe Ju zini një pozicion pragmatik përkundrejt BE-së. Tek ajo Ju vazhdoni të shihni kryesisht një Komunitet, që i sjell vendit Tuaj përfitime ekonomike dhe nuk jeni i interesuar në procesin e thellimit institucional (pra rritje të përqendrimit të pushtetit në duart e Brukselit). Në lidhje me fazat e ardhshme të zgjerimit Ju jeni gjithashtu pozitiv.

Në të gjitha analizat sillet rrotull, natyrisht, frika e problemeve financiare – edhe pse në shumicën e rasteve nuk thuhet hapur për hir të sensibilitetit diplomatik. Zgjerimet e ardhshme nuk duhet të sjellin ngarkesa shtesë për Ju në këtë drejtim. Ndaj edhe Ju kërkoni reforma të tjera në Politikën e Përbashkët Agrare, për të cilën Ju nuk është se keni simpati, dhe vendosjen e linjave të reja në politikën rajonale (pra fonde, që BE u vë në dispozicion nga fondet e veta rajoneve më të varfra). Tejet i interesuar jeni për vendosjen e rregullareve tranzitive (si nga ana e vendeve kandidatë ashtu edhe nga BE), pasi i konsideroni ato si avantazhe financiare për Ju.

Po kështu do të mirëprisnit një anëtarësim të shpejtë të shteteve të Ballkanit Perëndimor thjeshtë dhe vetëm për motive të sigurisë, por gjithsesi situatën e shikoni në mënyrë të diferencuar. Duke lënë mënjanë problemet serioze ekonomike, e rëndësishme është para së gjithash arritja e paqjtimit etnik pas luftimeve. Në fund të fundit askush nuk kërkon importimin e konflikteve potenciale në BE. Në gjykimin Tuaj premiset më të mira për një anëtarësim të shpejtë i ka Kroacia, që më pas do të ishte një shembull i rëndësishëm për rajonin si vend kandidat për BE-në. Nga pikëpamja ekonomike vendi nuk pozicionohet keq (të paktën në krahasim me Rumaninë), por ajo që Ju shqetëson janë kriteret politike, të cilat gjithashtu duhet të përmbushen 100 përqind. Ndaj ndër të tjera Ju vazhdoni të kërkoni edhe një bashkëpunim aktiv të të gjitha shteteve të Ballkanit perëndimor më Gjykatën e Kombeve të Bashkuara për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi.

Turqia është prej shumë kohësh anëtare e NATO-s dhe si e tillë edhe një partner i rëndësishëm për Ju nga pikëpamja strategjike. Ky vend mund të luajë rolin e një ure mes Lindjes dhe Perëndimit, mes një kulture me tipare kristiane dhe Islamit, dhe do të ishte një shembull i rëndësishëm demonstrativ që edhe një vend në pjesën me shumicë muslimane mund të jetë shtet demokratik. Krahas kësaj Turqia me popullsinë e saj shumë të re zotëron një potencial shumë të madh, si ekonomikisht ashtu edhe demografikisht, për të qenë një treg i rritjes ekonomike në të ardhmen. Por natyrisht Ju nuk doni dhe nuk mund t'i mbyllni sytë përpara problemeve të mëdha që ekzistojnë atje: shkelje të të drejtave të njeriut, dobësi në realizimin e reformave dhe kontroll i pamjaftueshëm civil mbi ushtrinë.

Referojuni reformave të thella politike realizuar në Turqi në vitin 1999 dhe paralajmëroni, se pa një perspektivë të shpejtë dhe konkrete anëtarësimi këto përpjekje për reforma do të dështojnë dhe forcat islamiste në vend do të mund të merrnin më pas epërsinë. Propozoni bisedime graduale për anëtarësim me mbështetjen intensive dhe monitorimn e BE-së. Kjo nga njëra anë do t'i jepte kohë Turqisë për të realizuar reformat, ndërsa nga ana tjetër do t'i jepte BE-së mundësinë të përgatitej për anëtarësimin e Turqisë me reforma të mëtejshme (në vlerësimin Tuaj të pashmangshme) në Politikën e Përbashkët Agrare dhe në Politikën Rajonale.